

Dr. Vehbetu Zuhejli

Ixhmai

V

Pjesë e shkëputur nga “Usuli fikhu islam”

Autori:
Dr. Vehbetu Zuhejli

Përktheu:
Dr. Musli Vërbani

Titulli:
Ixhmai

Korrektura:
Burim Bunjaku

Të drejtën e ribotimit e rezervon autori

Ixhmai

Zanafilla e idesë së ixhmait

Nevoja e vazhdueshme për dispozitim të çështjeve të reja, në kohën e sehabeve, pas vdekjes së Pejgamberit s.a.v.s., ka qenë shkak i zanafillës (lindjes) së idesë për ixhmain, nëpërmjet ixhtihadit shoqëror (kolektiv), si rezervë në fe dhe shpërndarje e përgjegjësisë në një turmë të muxhtehidëve, nga frika që mos të preket ixhtihadi individual, ose që të mos i ndodhë ndonjë sehabeje gabim në ixhtihad, përkundër asaj se në ixhtihadë hiqet mëkati e gabimi dhe si inkurajim për t'u angazhuar për fetva, pas vërtetësimit dhe çështjes së kërkuar. Shkaku i kësaj është shumë i qartë, sepse është rrugë e njohjes së ligjeve të sheriatit në kohën e Pejgamberit s.a.v.s., kur nuk ka pasur pengesa, sepse çdo gjë ka buruar prej Pejgamberit s.a.v.s. dhe mbështetjes së tij nga Allahu. Për këtë arsye, nuk ka qenë lehtë për sehabijun fekijh që të bëjë ixhtihadë, pasi që ai i është frikësuar transmetimit të hadithit të Pejgamberit s.a.v.s. Siç është e njohur, Ebu Bekri Sidiki, Umeri dhe Halifet tjerë të drejtë në pranimin e hadithit të Pejgamberit s.a.v.s kanë qenë rigoroz, nga frika se mos është përgënjeshttrim ndaj Pejgamberit s.a.v.s. Kjo frikë shpie në atë se janë tubuar Halifet dhe sehabet eminent dhe kanë diskutuar për çështjet, të cilat nuk kanë qenë të dispozituara në Kur'an apo sunet. Nga këto kuvendime ka buruar ideja e Ixhmait dhe dispozita e tyre (ixhmait) është konsideruar e detyrueshme për muslimanët e tjerë. Pas kësaj, dijetarët kanë pasur nevojë që ixhmain ta kenë si bazë të sheriatit të kategorisë së Kur'anit dhe sunetit.

Mirëpo, ky burim i tretë edhe sot te të tjerët merret në konsideratë si plotësim apo mbështetje te dy burimet e para. Ixhmai ka nevojë që të ketë argument të qartë ose argument global në Kur'an ose në sunet, ngase në Islam burim i vetëm i sheriatit është Allahu i Lartmadhëruar apo shpallja, e cila shpreh thëniet e Allahut në Kur'anin e lexuar, apo në sqarimet e sunetit të Pejgamberit s.a.v.s. Muxhtehidët e umetit të mëhershëm, edhe të sotmit,

nuk posedojnë pavarësinë e mendimit në ligjësim vetëm të mendjes, siç veprojnë përpiluesit e ligjeve laike, por detyra e tyre është zbulimi i ligjit të Allahut për një çështje nëpërmjet Ixhtihadit. Ixhtihadi nëse është kolektiv, është **Ixhma**, e nëse është individual dhe vetëm personal, është **Kijasë** dhe argumentet tjera të ngjashme.

Epokat historike të Ixhmait

Me të vërtetë ixhmai ka qenë rrugë e forcimit të të kuptuarit të ligjeve të sheriatit në mendjet e muslimanëve, mjet i pasurimit të fikhut islam dhe apel për vazhdimin e zhvillimit dhe të plotësimin të nevojave të kohës. Vetëm se forca (roli) i këtij burimi ka kaluar në katër epoka të ndryshme dhe shumë të rëndësishme.

1. **Koha e sehabeve.** Lindja e mendimit islam ka qenë epoka e sehabeve, e cila ka ndikuar në inspirim të madh në mesin islam. Baza e këtij mendimi është dalluar me një lëvizje ideore me ndikim dhe zhvillim të madh. Çdo herë kur paraqitej ndonjë çështje e re, Ebu Bekri i tubonte sehabet dhe konsultohej me ta; pas tij Umeri i tubonte më të zgjedhurit e njerëzve dhe konsultohej me ta, mësonte me ta se për një çështje prej çështjeve çfarë qëndrimi duhej të merrej dhe si duhej vepruar. **Shembull:** Në zgjedhjen e Halifes, në luftimin i heretikëve, mosndarjen e pronave të çliruara në Irak, Egjipt dhe Siri. etj.

Kur arrihej pajtimi për një dispozitë, qeveritari e zbatonte, ndërsa muslimanët e pasonin. Nëse nuk binin dakord në mendime, diskutimet vazhdonin dhe përpiqeshin për të arritur atë çka është e kënaqshme dhe përfundonte në kulminacion të çështjes për të cilën binte dakord ixhmai; nga këtu ixhmai i sehabeve rritej për shumë çështje.

2. **Epoka e tabiinëve.** Për shkak të shpërndarjes së fukahave në rajone fillon institucioni i ixhmait gjithashtu fillon llojllojshmëria e mendimeve dhe mosrealizimi i politikës së drejtë nga qeveritarët për t'i tubuar fukahatë në një mendim, gjë që vjen deri te zvogëlimi i ixhmait dhe humbja e tij.

3. **Epoka e ixhtihadit.** Në epokën e mesme të ixhtihadit dirigjoi domosdoshmërinë e pasimit të ixhmaëve të mëhershëm, të kohës së sehabeve, dhe secili imam kishte ambicie që t'i përmbahej ixhmait të mëhershëm, që të mos akuzohej për kundërshtim ose për ide të padrejta (të palogjikshme), dhe secili muxhtehidë është i ndikuar nga vendi dhe rajoni i tij.

Imam Maliku i përmbahej banorëve të Medinës.

Ebu Hanifes i ka mjaftuar që të pranojë atë në çka janë pajtuar dijetarët e Kufës.

4. ***Epoka e fukahave (medhhebeve).*** Në këtë epokë është shfaqur ideja e pasimit të medhhebeve të fikhut te nxënësit e muxhtehidëve dhe fukahave dhe është bërë që secili ta mbështetë medhhebin e Imamit të tij, duke aluduar në ixhmain. Këto pretendime u shpeshtuan dhe kanë mbetur nevojë e përbashkët: se është domosdoshmëri e të vepruarit me atë çka janë pajtuar sehabet, pra me ixhmain e sehavebeve, që të mos akuzoheshin për padituri; pastaj është ngulitur në mendje se ixhmai është argument i prerë te dijetarët islam dhe fukahatë e çdo gjenerate; rreptësisht e urrenin çdonjërin i cili kundërshtonte mendimin e muxhtehidëve të mëhershëm¹. Burimi i kësaj ndjenje të përgjithshme ka qenë për t'u barazuar me gjeneratën e parë të sehavebeve dhe me atë që e kanë transmetuar se: ***“Umeti im nuk unifikohet për në humbje”***, dhe,

“Çka e shohin muslimanët të mirë, edhe te Allahu është e mirë” dhe, atë që e transmeton Shafiiu nga Umeri se: ***“E pra; Kush dëshiron të jetë i kënaqur me begatitë e xhenetit, le t'i përmbahet xhematit, sepse shejtani është me të vetmuarin, e më larg prej dy vetëve”***.²

Pretenduesit e Ixhmait

Ajo me çka ballafaqohemi më së shumti në librat e fikhut të medhhebeve është të argumentuarit për termin Ixhmaë, për ndonjë rast, për të cilën nuk janë pajtuar. Për një dispozitë medhhebet shohin se secili medhheb ka pretenduar se për këtë çështje ka rënë dakord ixhmai, ndërsa në realitet ka dhënë mendimin e ixhmait të medhhebit të vet (e jo të të gjitha medhhebeve), saqë ka rezultuar se ixhmai është i shpeshtë apo i shumtë. Profesori Ebu Is'hak el Isfiraniju ka thënë: Ne e dimë se çështjet e ixhmait janë më shumë se njëzet mijë sosh.³ A është ky ixhmai, i cili konsiderohet burimi i tretë prej burimeve të sheriatit islam, i cili dallohet prej umeteve të shkencave tjera, se është i garantuar, se nuk ka të meta?. Po si të pajtohet fjala e fukahave me këtë, pasi që shumica absolute e usulijinëve ka deklaruar se Ixhmai është argument i prerë dhe kush e mohon, është pabesimtar?.

E vërteta është se pajtimi, unifikimi i këtyre çështjeve të fikhut nuk ka mbështetje pa dokumentim e pa analizim dhe, në fund, dhënies përparësi të mendimit prioritar, se:

- ndoshta ka për qëllim pajtimin e shumicës, e jo i të gjithëve,
- ndoshta ka për qëllim pajtimin e katër medhhebeve, e jo të të tjerëve,
- ndoshta vetëm të dijetarëve të një medhhebi, e jo të të tjerëve,
- apo se nuk kanë pasur njohuri, se të tjerët për atë çështje kanë mendim tjetër dhe në të shumtën e rasteve qëllimi ka qenë pajtimi i një medhhebi.

E gjithë kjo dhe çështjet tjera na obligojnë që të studiojmë:

- **të vërtetën e ixhmait gjuhësisht dhe terminologjikisht;**
- **të argumentuarit me ixhmain;**
- **llojet e Ixhmait;**
- **mbështetjen e ixhmait;**
- **mundësinë praktike të pajtueshmërisë dhe ndodhjes së tij,**
- **kushtet e ixhmait.**

Të gjitha këto do t'i sqarojmë në vazhdim.

Tema e parë: Definicioni i Ixhmait

Në etimologji ixhmai ka njërin nga këto dy kuptime:

E para: Vendosmëria për diçka dhe insistimi në të. Thuhet: **“Është tubuar filani për diçka”** që do të thotë: Është i vendosur në të. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

فَأَجْمِعُوا أَمْرَكُمْ وَشُرَكَاءَكُمْ

“Dhe vendosni për çështjet e juaja dhe bashkvepruesit tuaj.” (Junus : 71)

Po ashtu thënia e Pejgamberi s.a.v.s.: **“Kush nuk vendos të agjërojë para mëngjesit, ai nuk ka agjërim”.**⁴

E dyta: Unifikimi. Thuhet: Populli është pajtuar për këtë, që do të thotë është unifikuar për këtë. Ky kuptim, gjithashtu, ka nevojë që të insistojë për atë çështje.

Dallimi në mes të këtij kuptimi dhe kuptimit të parë është se: kuptimi i parë ka nevojë për vendosmërinë e një personi,⁵ ndërsa kuptimi i dytë ka nevojë për vendosmërinë e shumë personave.

Në terminologji dijetarët kanë dhënë shumë mendime:⁶

Dijetari Nidham e definon kështu: **“Ixhmaë është kur secili mendim sjell argumentimin e vet, edhe nëse është në pyetje vetëm një mendim.”**

Unifikimi i Umetit të Muhamedit s.a.v.s. në veçanti për një çështje prej çështjeve të fesë.

Unifikimi i muxhtehidëve të Umetit të Muhamedit s.a.v.s. pas vdekjes së tij, në një epokë prej epokave për një dispozitë të sheriatit.

Sa i përket definicionit të Gazaliut, përket me medhhebin e tij parashikimi se në ixhmaë bëjnë pjesë edhe njerëzit e rëndomtë. Ai parashih domosdoshmërinë e pjesëmarrjes në atë që njihet si domosdoshmëri në fe. E, kjo është që të marrë pjesë çdokush, i cili mund të perceptojë si njerëzit e përgjithshëm, ashtu edhe njerëzit e veçantë (dijetarët), si f.v. në pesë kohët e namazit, obligueshmëria e agjërit, zekatit, haxhit, sepse ata përfshihen në fjalën Umet. Në thënien e Pejgamberit s.a.v.s.: **“Umeti im nuk unifikohet për në humbje ose për në gabim (lajthitje).”**⁷

Ndërsa, sa i përket posaçërisht të kuptuarit të të specializuarve të Umetit, ata janë dijetarët. Ai nuk parasheh ixhmaë, nga shkaku se njeriu i rëndomtë nuk është kompetent (nuk ka imunitet) për të kuptuar të vërtetën e një dispozite të çështjes prej çështjeve, si f.v. i çmenduri dhe mendjelehti. Përpos kësaj, në fillim të Islamit sehabet janë pajtuar se për çështje të Ixhmait në çështje të fikhut nuk konsiderohen të rëndomtit. Kështu pra, edhe nëse e pranojmë se Gazaliu parasheh pjesëmarrjen e të rëndomtëve në Ixhmaë në këto çështje, që do të thotë se ata lënë mendimin e tyre në disponim të kompetentëve, e pastaj pajtohen ashtu siç japin mendimin ata.

Nëse një grup i dijetarëve dhe i projektuesve gjykojnë për të mirën e banuesve të Kështjellës dhe ata pajtohen për diçka, thuhet: Kjo është në pajtueshmëri të të gjithë ushtrisë.

Gjithashtu, shihet se definicioni nuk kushtëzon që ixhmai të jetë pas vdekjes së Pejgamberit s.a.v.s. Nuk kushtëzohet me këtë kusht.⁸

Gazaliun nuk e përkrah për dy aspekte:

Nuk ka vlerë fjala e njerëzve të rëndomtë në atë që është çështje e të specializuarve, studiuesve dhe njohësve të fikhut.

Po ashtu, nuk e shoh të arsyeshme nevojën e ixhmait në kohën e Pejgamberit s.a.v.s., nga shkaku se Pejgamberi s.a.v.s. është burim i drejtpërdrejtë i shariatit në kohën e tij. Argumentim është vetëm fjala e tij dhe nuk merret parasysh mendimi i tjetrit, pa marrë parasysh se a pajtohet dikush apo kundërshton. Për këtë arsye, e përkrah definicionin e shumicës absolute të dijetarëve dhe në këtë punim do të orientohem në këtë drejtim.

Sqarim i definicionit

Nga definicionet shihet se Ixhmai është domosdoshmëri që i plotëson pikat në vijim:

Pika e parë: -Gjuhësisht do të thotë: mendimi i secilit të jetë në pajtim me tjetrin. Me këtë qëllimi është pjesëmarrja ose në bindje, ose me thënie, ose me veprim.⁹ Pjesëmarrja mund të realizohet ose nëpërmjet deklarimeve, ose të veprimeve, ose të heshtjeve, ose të pranimit të çështjeve të diskutuara. Për domosdoshmërinë e pajtimit të shkohet nëpërmjet pesë çështjeve:

1. Patjetër të pajtohen të gjithë muxhtehidët.¹⁰ Nëse njeri nuk pajtohet, nuk mund të realizohet ixhmai, nga shkaku se nuk është plotësuar

shtylla e pajtueshmërisë. Mirëpo, shumica e Usulijinëve argumentohen (se mund të arrihet) me shumicën e muxhtehidëve, siç do ta sqarojmë më vonë.

2. Nuk mjafton ixhmai vetëm nga një muxhtehidë. Nëse në një kohë prej kohërave është i vetëm, nga shkaku se pajtueshmëria patjetër duhet të jetë nga një shumë individësh, e nëse është vetëm prej individi, ai mund të gabojë. Nga kjo, mendimi i tij nuk mund të jetë i prerë, siç është çështja e ixhmait, nga shkaku se gabimi është mohues i ixhmait. **Ky është mendimi i shumicës absolute të usulijinëve**, pra, nuk është as argument, e as ixhmaë, sepse ai është i vetëm dhe është e mundur të gabojë.

Disa thonë: Mendimi i tij është argument i dyshimtë, edhe pse nuk është ixhmaë, nga shkaku se është muxhtehid, e nuk është njeri i rëndomtë. Sido që të jetë, vështirë se mund të ndodhë kjo, sepse në çdo kohë është e pamundur që të mos ketë një shumë të caktuar e muxhtehidinëve.¹¹

3. Të jetë mendimi prej të gjithëve. Nëse nuk ndahen në dy mendime, a do të thotë që pajtohen se nuk është e lejuar që të ndodhë mendimi i tretë. Kjo është ajo që njihet si ixhmai në katror, apo ixhmai i dubluar.

Për këtë dijetarët kanë dhënë shumë mendime.

Shumica thonë: Nuk lejohet që të ndodhë mendimi i tretë.

Dhahirijt thonë: Mund të ndodhë pa kurrfarë dyshimi.

Dijetari Amidij dhe Ibni Haxhibi thonë: Nëse mendimi i tretë e anulon atë për të cilën është pajtuar ixhmai, nuk lejohet, nga shkaku se po e zhvleftëson atë për çka janë unifikuar. Po nëse nuk e anulon, lejohet, për shkak se nuk kundërshton atë për çka janë unifikuar.¹²

Argumenti i shumicës absolute:-Përkufizimi i mospajttimeve në dy mendime tregon se në atë çështje nuk ka më vendim të tretë. E, mendimi i tretë do të ishte shkatërrim i ixhmait, e kjo është e palejueshme.

Argumenti i Dhahirijëve: Atëherë kur ka ndodhur mospajtimi i një çështjeje, nuk ka pasur ixhmaë, për shkak se mospajtimi dhe pajtimi janë kontraste të njëra-tjetrës.

Sqarim i argumentit: -Kur të jetë e mundur të parashikohet ixhmai dhe ndodhja e tij, është e patjetërsueshme të jetë ashtu, e nëse nuk mund të parashikohet se mund të ndodhë, atëherë nuk lejohet të thuhet se ka

ndodhur, e për atë lejohet që të ndodhë mendimi i tretë. Çështja sqarohet me shembuj në vijim:

Sehabet nuk janë pajtuar për trashëgiminë e gjyshit me vëllezër:

Disa kanë thënë: Gjyshi trashëgon tërë pasurinë dhe mbulon vëllezërit.

Disa kanë thënë: Gjyshi trashëgon me vëllezërit.

Që të dy grupet së bashku janë pajtuar se është e patjetërsueshme që gjyshi të trashëgojë. E mendimi i tretë: se nuk ka të drejtë të trashëgojë, e prish ixhmain.

Nuk janë pajtuar sa i përket nijetit për pastërti:

Një grup mendon: Është kusht nijeti në të gjitha llojet e pastërtive, si në abdes, gusël dhe tejemum.

Të tjerët mendojnë se: Kushtëzohet vetëm në tejemum.

E nëse ndodh mendimi i tretë, se absolutisht nuk kushtëzohet nijeti, në çfarëdo pastërtie, konsiderohet prishje e ixhmait të mëparshëm.

Në prishjen e martesës për shkak të të metave, si për shkak të zgjebës, çmendurisë, dëmtimit të organit seksual, të metat në vaginë.

Disa kanë thënë se prishet për të gjitha këto të meta.

Disa kanë thënë: Prishet për diçka prej tyre, se i mjafton e drejta e bashkëshortit për shkurorëzim.

E nëse ndodh që të ketë mendim të tretë, ku thuhet se prishet martesa prej disa prej këtyre të metave, e ato janë çmenduria dëmtimi i organit seksual, të metat në vagjinë, nuk është prishje e ixhmait të mëhershëm.

Për idetin e shtatzënës së cilës i ka vdekur bashkëshorti:

Disa kanë thënë: Maksimumi i afatit të ideteve.

Disa të tjerë kanë thënë: Ideti i saj është derisa të lindë.

Nëse ndonjë thotë: Ideti i saj është me muaj, ky është mendimi i tretë, për të cilën nuk ka thënë askush se refuzohet.

Në trashëgiminë e nënës e të babait dhe të njërit prej dy bashkëshortëve

- **Ibni Abasi thotë:** Ajo e trashëgon një të tretën e tërësisë, e pjesa tjetër i takon babait, nga shkak se Allahu e ka definuar për dy raste të farzit për

nënë: një të tretën dhe një të gjashtën, e nuk lejohet farzi (pjesa e tretë) me anë të analogjisë.

- **Shabet tjerë kanë thënë:** Ajo trashëgon një të tretën e mbetjes.

Nëse vjen ndokush tjetër dhe thotë: ajo trashëgon me burrin dhe babain një të tretën e mbetjes dhe një të tretën e tërësisë me bashkëshorten dhe babain, kjo është thënie e shpikur, për të cilën nuk ka thënë askush.

Sipas mendimit tim, mendimi më prioritar është mendimi i Haxhibit dhe Amidijut, nga shkaku se mendimi i shumicës absolute është i bazuar në iluzion (paramendim), se nëse të parët ndahen në dy medhhebe, kjo do të thotë se ata janë pajtuar që të mos ketë medhheb të tretë.

E, kjo ka ndodhur nga shkaku se moslejimi i mendimit të tretë, nuk do të thotë se nuk ka mendim të tretë. E para është negative, e dyta pozitive.

Gjithashtu, edhe mendimi i Dhahirijëve është i ndërtuar mbi bazën e iluzionit. E, kjo është se, përderisa ka mospajtim në mes të dy grupeve të para, asnjëherë nuk mund të ketë ixhmaë në të ardhmen. E, kjo është e paqëndrueshme, sepse mund të arrihet ixhmai në masën e përbashkësisë, sikurse në shembullin e trashëgimisë së e gjyshit me vëllezërit.

Kjo është mbështetja e mendimeve në detaje. Vërtet, ixhmai mund të ndodhë në dispozitën e disa pjesëve, edhe pse në aspekt të përgjithshëm nuk janë të pajtimit, sikurse në rastin e trashëgimisë së gjyshit me vëllezërit. Pajtimi ka ndodhur në atë se gjyshi trashëgon, por nuk janë pajtuar në detajet tjera.

4. Paraqitet pajtueshmëria në fillim të mendimeve edhe në thënie, edhe në praktikë. Ndërsa, kur disa muxhtehidinë flasin e të tjerët heshtin, në këtë ekziston mospajtimi në mes të dijetarëve, që njihet si ixhmai i heshtur, për të cilin do të flasim në temën *“Llojet e ixhmait”*.

5. Të arrihet ixhmai në një çast, pa marrë parasysh se a e kanë vazhduar nga epoka e dijetarëve, të cilët janë pajtuar apo jo; pa marrë parasysh se a kanë dhënë fetva pas ixhtihadit apo prej tekstit. Këtë temë do ta sqaroj në temën e *“Epoka e Ixhmait”*

Ky studim në këtë pikë apo në këtë kusht nënkupton që duhet të flitet për dy çështje.

E para: Kush është muxhtehidë.

E dyta: Ajo çka rezulton prej fjalës “*El-Muxhtehidinë*” si emër i shquar i llojit.

E para: Muxhtehidi

Këtu do të flas për tri çështje:

- **Kushtet e muxhtehidit,**
- **A konsiderohen të rëndomtit pjesëtarë në ixhmaë, dhe**
- **Fekihu bidatgji.**

Si bëhet dijetari muxhtehidë?

Dijetari arrin titullin e muxhtehidit atëherë kur disponon mundësinë e përpilimit të ligjit.

Muxhtehidë - është ai i cili arrin në nivelin që të ketë mundësi të nxjerrë ligjet nga vendi i vet. Gazaliu e definon kështu: “***Është çdo muxhtehidë prej të cilit pranohen fetvatë***”.¹³ Prej muxhtehidinëve konsiderohet çdonjëri i cili ka cilësi në një lëmi prej lëmive, nëse çështja parashtrohet në kuvendin e ixhmait, si p.sh. nëse ka të bëjë me specializimin e tij. Ndonjëherë muxhtehidi quhet fekijhë. Ndonjëherë muxhtehidët quhen njerëz të logjikës (mendjes) dhe të ixhtihadit ose njerëz të zgjedhjes së problemeve delikate. Pasi që sot jetojmë posaçërisht në kohën e specializimeve shkencore dhe nëse një person flet për diçka që nuk është i specializuar, menjëherë kritikohet dhe nënçmohet; atëherë normalisht se ata, të cilët flasin për çështje të shariatit, kanë kompetencë të caktuar dhe aftësi të domosdoshme, që nxjerrja e ndonjë ligji të shariatit prej tyre të jetë e drejtë e të mos ketë të meta dhe defekte. Kjo kompetencë dhe aftësi e nxjerrjes së ligjit nuk mund të arrihet pa i plotësuar tri kushte:¹⁴ Në

përgjithësi ato kushte janë: njohuria e gjuhës (arabe) dhe njohuri për sheriatin.

Kushtet e muxhtehidit

Kushtëzohet që muxhtehidi t'i plotësojë tri kushte:

Kushti i parë: Njohuri për tri çështje

1.Njohuri për Kur'anin: që personi të njohë kuptimet gjuhësisht dhe terminologjitë e sheriatit.

Njohja e gjuhës (arabe): nënkupton njohuritë e sistemit të fjalëve të Kur'anit veç e veç dhe së bashku, që të ketë nivel të lartë të njohurisë së shkencave të gjuhës arabe, të gramatikës, sintaksës dhe morfologjisë, sa që t'i mundësojë të interpretojë ajetin në mënyrë të saktë. Imam Shafi'iu thotë: ***“Obligohet çdo musliman të mësojë nga gjuha arabe sa të ketë mundësi dhe t'i afrohet atij”.***

Mavrudiju thotë: ***“Njohja e gjuhës arabe është farz për çdo musliman, në është ai muxhtehidë apo jo”***

Njohuria terminologjike e sheriatit –nënkupton njohjen e shprehjeve, të cilat i ka paraqitur Ligjvënësi si tregueshmëri (kuptime) të reja, si f.v. Namazi, sepse gjuhësisht ***“salah”*** do të thotë lutje. Ndërsa, në terminologji do të thotë: ***“shprehje dhe veprime të veçanta”.***

Po ashtu, sikurse është rasti me fjalën ***“Gaiti”*** në thënien e Zotit të Lartmadhëruar: ***“Ose ju vjen ndonjërit nga ju prej Gaiti”*** Qëllimi është nevojë natyrore e njeriut, e nuk është shtresa e ulët e dheut, siç është në bazë të gjuhës.

Po ashtu, patjetër duhet të dihen disa rregulla të sheriatit, si f.v: kuptimet e të përgjithshmes, të veçantës, të papërcaktuarës, të përcaktuarës, të fuqizuarën dhe fuqizuesin në Kur'an dhe ajo çka është e ndërlidhur me atë, që kërkohet të dihet, të arrihet dhe të realizohet.

Nuk kushtëzohet mësimi përmendësh i Kur'anit, por kushtëzohet që të dijë çka përfshihet prej teksteve për një temë të caktuar. Po ashtu, nuk kushtëzohet të dijë të gjitha tekstet e Kur'anit, por t'i dijë tërë ajetet që kanë të bëjnë me ligjet dhe t'i dijë se në cilat vende (faqe) gjenden në Kur'an.

Gazaliu dhe Arabiju thonë: Në Kur'anin Famëlart të tilla janë deri pesëqind ajete.

2. Njohuri për sunetin –është që të njohë zinxhirin dhe tekstin e hadithit. Sa i përket zinxhirit të hadithit: që t'i pushojë zemra në saktësinë e tij dhe të mos ketë ndonjë defekt nëpërmjet mësimit të njerëzve të hadithit. Ndërsa: Njohuri për tekstin: ka të bëjë për njohuri të kuptimit gjuhësor dhe të terminologjisë së shariatit, siç është sqaruar në pjesën “Njohuri për shkencën e Kur'anit”, si dhe vërejtjen apo perceptimin e kundërshtimit, i cili paraqitet në mes të disa haditheve dhe të Kur'anit ose të rregullave të përgjithshme të shariatit, apo vendimeve të bazave të logjikës së shëndoshë.

3. Njohuri për çështjen e ixhmait për të cilat ka qenë ixhmai paraprak, ashtu që të mos ndodhë ndonjë kundërshtim me ixhmain për të cilin veç ka ndodhur, nga shkak se ixhmai është argument i prerë dhe nuk lejohet të kundërshtohet.

Kushti i dytë. Që të jetë i ditur me njohuri të usuli fikhut. Që të njohë rregullat dhe parimet e tij, sepse me to bëhet nxjerrja e ligjeve nga argumentet e tij. Kjo është baza elementare dhe shtylla e ixhtihadit me të cilën mbështeten shtyllat e ndërtimit.

Gazaliu ka thënë: **“Lëmitë më madhështore të ixhtihadit përfshihen në tri shkenca: Hadith, Gjuhë dhe Usul Fikh”.**

Kushti i tretë. Të jetë i përgatitur në lëmitë e gjuhës, nga të cilat varet kuptimi i teksteve të shariatit në kuptim të plotë, nga shkak se prej saj arrihet patjetër kuptimi i drejtë dhe i saktë. Nuk kushtëzohet që të jetë i thelluar në këto lëmi, por mjafton njohuria e asaj çka është e domosdoshme dhe e patjetërsueshme për të kuptuar drejt një lëmi prej lëmive të gjuhës, si f.v: gramatika, morfologjia, sintaksa dhe fikhu i gjuhës.

Ndonjëri mund të parashtojë pyetje: Cili është argument i kushtëzimit të këtyre kushteve, pasi që sehabet nuk i kanë pasur këto dhe nuk kanë kërkuar plotësimin e tyre kur është paraqitur nevoja e realizimit të ixhmait?

Përgjigjja është: Regjistrimi i këtyre lëmive është bërë më vonë, mirëpo kjo nuk do të thotë se këto rregulla të këtyre lëmive nuk kanë ekzistuar për një çështje në mendjet e njerëzve të mëhershëm. Arabët i kanë

kuptuar këto rregulla, posa janë shfaqur, në bazë të natyrshmërisë së pastër dhe shijes së gjuhës së kulluar arabe. Ne sot këto lëmi i mësojmë në bazë të asaj si i kanë nxjerrë nga gjuha arabe dhe mundohemi t'i formulojmë fjalët në bazë të asaj natyrshmërie dhe në bazë të asaj kthjelltësie. Kështu Ibn Mes'udi e ka kuptuar kur dy tekste kanë qenë në kundërshtim mes tyre dhe ka qenë e pamundur të unifikohen, atëherë i mëvonshmi e ka shfuqizuar të mëhershmin. Umeri ka deklaruar dhe njësoj ka vepruar duke thënë: ***“Ideti i shtatzënës, së cilës i ka vdekur burri i saj, është deri sa të lindë foshnja”***. Pastaj, ka thënë: ***“Kush dëshiron, le të përbetohet”***.¹⁵ Sureja e shkurt, pra sureja ***“Talak”***, në të cilën përmendet ideti i shtatzënës ka zbritur pas sures së gjatë, pra suretul Bekare, në të cilën është ideti së cilës i ka vdekur burri.¹⁶ E, kështu është bërë specifikimi i ajetit të Suretul Bekare në ajetin e Suretul Talak. Disa mendojnë se specifikimet e tilla quhen shfuqizim.

Përfundim: Anëtarët e ixhmait janë dijetarët, nga shkaku se ata e kuptojnë hallallin dhe haramin në çështjet të cilat nuk janë të definuara në tekste, pra në librin e Allahut dhe në sunetin e Pejgamberit s.a.v.s. Shafiiju thotë: As unë dhe asnjë prej dijetarëve nuk thotë: Për këtë janë pajtuar të gjithë dijetarët (ixhmai), përpos nëse kurrë nuk ka takuar dijetarë, e që të mos të thotë ty: Këtë e kanë treguar para meje, si f.v: Namazi i drekës i ka katër rekate, alkooli është i ndaluar e të ngjashme.

Njerëzit e rëndomtë dhe ixhmai

Njeri i rëndomtë: quhet njeriu i cili nuk ka arritur nivelin që të ketë mundësi të nxjerrë ligje, pa marrë parasysh a është dijetar ose është dijetar në një lëmi, por jo në lëmin e njohjes së mënyrës së nxjerrjes së ligjeve të sheriatit. *Shembull:* Inxhinieri është i rëndomtë sa i përket lëmisë së fikhut. Njohja e ligjeve të fikhut dhe mënyra e nxjerrjes së ligjeve të sheriatit janë prej burimeve të sheriatit.

Gazaliju ka përmendur çështjen në të cilën ka sqaruar mënyrën se si mund të paramendohet që një njeri i rëndomtë të marrë pjesë në ixhmaë. Sheriati ndahet në atë pjesë ku marrin pjesë në kuptimin e çështjeve të specializuarit dhe të rëndomtë, si f.v: Pesë kohët e namazit, agjërimi i

ramazanit, zekati dhe haxhi. Për këto është arritur ixhmai. Të rëndomtit u janë bashkangjitur (janë pajtuar) ixhmait. Dhe, në pjesën ku janë çështjet që mund t'i kuptojnë vetëm të specializuarit, si detajet e dispozitave të namazit, shitblerjes, qiramarrjes, kompanive të ngjashme, në të cilat janë pajtuar se është e drejta në anën e asaj çka janë pajtuar të specializuarit dhe nuk paraqesin kurrfarë mospajtimi, që do të thotë edhe ata janë pajtuar. Mirë është që të quhet ixhmai i umetit. Kjo i ngjason një ushtrie, kur një grup i specializuar harton planin për të ndërtuar kështjellën dhe marrin vendim, e pastaj ushtria e ndërton atë; e pastaj thuhet: Kjo është bërë në pajtimin e ushtrisë. Pra: për çdo gjë që janë pajtuar muxhtehidinët, për atë janë pajtuar edhe të rëndomtit, me të është plotësuar ixhmai i umetit.¹⁷

Rezultati i ixhmait për atë, që nuk njihet në fe si e patjetërsueshme, është kalimi i dispozitës prej nivelit të dyshimit në nivelin e të padyshimtës. Pas kësaj hyrjeje, po përmendi qëndrimin e dijetarëve në hyrjen e të rëndomtëve në ixhmaë. Për këto çështje ata janë ndarë në dy medhhebe:¹⁸

Disa thonë: Prej tyre Ebu Bekri Bakilaniju, të cilin e ka përkrahur Amediju: Të rëndomtit patjetër duhet të pajtohen, nga shkaku se mendimi i umetit është argument i siguruar nga gabimi (i pagabueshëm), siç do ta tregojmë në nëntemën **“Argumenti i ixhmait”**, dhe nuk ka pengesë që të jetë pagabueshmëria prej cilësive të organizimit të shoqërisë edhe prej të specializuarve, edhe prej të rëndomtëve. Nëse çështja është kështu, nuk është e domosdoshme që pagabueshmëria e vulosur për të gjithë të jetë edhe për një pjesë, nga shkaku se dispozita e marrë në përgjithësi nuk është e domosdoshme të jetë e varur edhe për individë.

Ky medhheb i ngjason sistemit demokratik popullor të drejtpërdrejtë, i cili me kurorëzimin e tij obligon që të gjithë individët e shoqërisë të marrin pjesë në formimin e qeverisë dhe të parlamentit.

Vërehet se bazë e këtij mendimi është argumentimi me fjalën në kuptim të përgjithshëm të fjalës umet, i cili ka ardhur nga hadithet. **Shembull:** **“Umeti im nuk bashkohet në humbje, ose në mëkat”**.¹⁹ Vetëm se në realitet kjo përgjithshmëri nuk është qeshtje që shikohet në shikim të parë, nga shkaku se, siç thotë Gazaliju: I rëndomti nuk ka imunitet që ta kërkojë të vërtetën, sepse ai nuk është person adekuat për këtë çështje, ai është sikurse fëmija dhe i çmenduri, të cilëve u mungon nijeti. Ky, pra, është mendimi i Gazalijut. Nuk mund të kuptohet garancia e umetit në mosgabim, përpos siguria nëse në të janë personat e autorizuar (të zgjedhur). I rëndomti

ka mangësi për dituri dhe nuk ka përgatitje profesionale, e cila i mundëson atij që të ketë mendim (ide) për dispozitë. Çështja e tij se ai i bashkëngjitet Ixhmait në atë që e shohin ata të drejtë, siç është rasti me përfaqësuesit e fiseve në parlamentin e Sirisë, në votim për ndonjë projekt, nuk ka efekt në aspektin se umeti është i mbrojtur të mos gabojë.

Përpos kësaj, sehabet në fillim të Islamit janë pajtuar se të rëndomtë nuk merren parasysh në çështjet e ixhmait, nga shkak se i rëndomti nuk e di çka thotë. Ai nuk ka autorësi për pajtueshmëri dhe për kundërshtim dhe fjala e tij nuk merret parasysh. Kjo në bazë të thënies së Zotit të Lartmadhëruar: **“Ndoshta, ata të janë të cilët përpilojnë (nxjerrin) atë, prej tyre.”**

Duket u bazuar në këtë, shumica absolute e dijetarëve thonë: “Të rëndomtë nuk bëjnë pjesë në ixhmaë dhe koncenzusi arrihet edhe pa ata”.²⁰ Argumenti i tyre është se: Ixhmai në lëmitë shkencore është ixhmai i të specializuarve të të gjitha lëmive; ata janë të profesionalizuar për atë, e jo të tjerët dhe se halifet janë këshilluar me këshilltarët, si me Ibni Abasin, me Umerin, Alijun dhe me muftijt tjerë të ditur si ata, dhe se të rëndomtë nuk janë analistë (studiues) të sheriatit dhe nuk i kuptojnë argumentet.

Përfundim: Ixhmai i cili llogaritet ixhmaë në lëmitë shkencore është ixhmai i asaj lëmie, të cilët e njohin atë lëmi, e jo të tjerët. Sikurse thotë Shevkaniju: “Ixhmai në çështje fikhije quhet mendimi i të gjithë fukahave, në çështjet e usulit mendimi i të gjithë usulistëve, në çështjet e gramatikës mendimi i të gjithë gramatikanëve; kush nuk është i specializuar në atë lëmi, konsiderohet i rëndomtë”.

A mund të marrim në konsideratë mendimin e kundërt të atij fekihi, i cili shikon çështjet sekondare dhe çështjet e përgjithshme të Usulit?²¹

Një grup i dijetarëve thotë, e që në këtë grup bëjnë pjesë shumica e usulijinëve, se: Mendimi i tyre (të rëndomtëve) nuk merret parasysh, sepse ata nuk e kanë titullin e imamëve të umetit si të Shafiit, Malikut dhe të Ebu Hanifes. Zoti i pastë mëshiruar!

Disa thonë: Mendimi i tyre merret parasysh, sepse te ta gjendet niveli arsimor dhe nuk bëjnë pjesë në të rëndomtë, por bëjnë pjesë brenda fjalës *“Umet”*, e cila është theksuar nga Pejgamberi s.a.v.s.: *“Umeti im nuk bashkohet në humbje”*.²²

Disa kanë thënë se duhet analizuar: Në konsideratë merret mendimi i fekihut, i cili i ruan dispozitat dytësore, të cilat janë ngritur në nivel të lartë, ndërsa nuk merret në konsideratë mendimi i usulistit, i cili nuk është fekih, **Disa e thonë** të kundërtën.

Unë shoh se është e domosdoshme që në ixhmaë të marrë pjesë edhe Usulisti, nga shkaku se është i nevojshëm specializimi i Usulistit për çështjet bazike për ixhmaë.

Kadiju Bakilaniju thotë: Kundërshtimi i Usulistit merret parasysh. **Gazaliju thotë**: Kjo është e vërtetë. **Kadiu** është argumentuar në atë se ai person i cili merret me çështjet e sheriatit, ndriçon me mendimin e tij, udhëzon me këshillat e tij dhe prezanton në tubimet e këshillimit.

Nëse çështja është kështu, atëherë kundërshtimi i tij është mendim i cili merret parasysh; kur të merret parasysh mendimi i tij i kundërt, merret edhe mendimi i tij në pajtueshmëri.²³

Usulist – Është ai i cili i di rregullat e nxjerrjes së ligjeve, i cili qëndron në rrugën e argumentimit. Shkenca e usulit është shkenca tek e cila kthehet argumenti, me argumentin me të cilin është arritur dispozita e re. Ndërsa, sa i përket fekihut, i cili është ruajtës i çështjeve sekondare, si f.v. kushtet e namazit, shitblerjes, dispozitat e menstruacionit dhe lehonisë,

unë nuk e shoh të arsyeshme që të bëjë pjesë në ixhmaë, pasi që ai nuk e ka nivelin e specializimit të nxjerrjes së dispozitave. Njohuria e tij për çështje sekondare të dispozitave nuk ka vlerë në lëminë e ixhtihadit. Siç thotë Gazaliju, këtyre fekihëve dhe usulistëve u mungon elementi në të kuptuarit (perceptuarit) e dispozitave.

Sa i përket dijetarëve të akaidit, gramatikës, tefsirit, hadithit, për ta vlen dispozita e fukahave që merren me çështje sekondare. Me një fjalë: Nëse ixhmai ka të bëjë me një çështje, e cila ka të bëjë me atë specializim, si f.v. ndërtimi i fjalës apo fjalisë në gramatikë, atëherë ata duhet të marrin pjesë në ixhmaë.²⁴ Zerkashiju në librin **“Bahr”** thotë: “Nuk ka mospajtim në atë se duhet të merret parasysh mendimi i akaidistit në akaid, usulistit në usul. Merret parasysh mendimi i çdonjërit, nëse ixhtihadi ka të bëjë në lëmin e tij”.²⁵

Fekihu bidatqi dhe muxhtehidi mëkatar

Fekihu bidatqi – Është çdo bidatgji, i cili mohon atë që është përcjellë e sigurt dhe që është e domosdoshme në shariatë. Ky me bidatin e tij është pabesimtar. Nuk konsiderohet se është i mbrojtur prej mëkatit, kështu që as pajtimi, e as kundërshtimi i tij nuk kanë vlerë; ixhmai realizohet edhe pa të, edhe nëse ai vet nuk e di për pabesimin e tij. Këta janë njësoj sikurse **muxhesiminët**, pra ata të cilët të adhuruarin e tyre e ngjasojnë me njeriun, i cili është i përkufizuar me shtatë pjesët e trupit të tij, apo **“Gulatu Shiatsu”**, pra ata të cilët e kanë shenjtëruar Alijën dhe e kanë bërë Zot. Nëse ndonjëri nga këta kundërshton në çështjet sekondare dhe vazhdon të insistojë, të kundërshtojë deri sa të pendohet nga bidati i tij, kundërshtimi i tij nuk ndikon në asgjë, pasi që ixhmai është realizuar para se të rikthehet në islam dhe konsiderohet sikurse të pranojë islamin dhe të kundërshtojë, përpos një mendim i cili thotë se kusht i ixhmait është që të jetë ixhmai i një gjenerate të caktuar.

Mirëpo, nëse bidatqia nuk konsiderohet pabesimtar me bidatin e tij, por është i humbur, si f.v: Kaderijt, të cilët thonë; **“Njeriu vet i krijon veprat e tij dhe sa i përket mëkateve, nuk i ka prej Allahut”**²⁶, apo sikurse **“Havarixhët”**, të cilët e kanë kundërshtuar Imam Alijun dhe të tjerët i kanë shpallur besimtarë – si Uthmanin dhe Abdurrahman bin Avfini, apo si **Rafidijët**, të cilët e kanë pasuar Alijën dhe nuk janë pajtuar me imametin e Ebu Bekrit dhe Umerit; për këta ka ndodhur mospajtimi.

Imam Evzaiju, Muhamed bin Hasani, është transmetuar nga Ehlu Suneti se këta nuk bëjnë pjesë në ixhmaë, për shkak se nuk kanë ndonjë bazë në ixhmaë, nga se nuk kanë ndonjë bazë ku mund të bëhet mbështetja në to, ngaqë i kanë shpallur pabesimtarë të parët tanë, prej të cilëve i kemi marrë bazat e fesë; ata janë njerëz të epsheve dhe janë të humbur.

Ebu Bekri Sajrafiju thotë: Këta bëjnë pjesë në ixhmaë dhe ixhmai nuk institucionalizohet pa to. Këtë mendim e kanë pranuar Gazaliju, Amediju dhe një pjesë e Usulistëve, nga shkaku se këta janë komision zgjedhor dhe bëjnë pjesë në kuptim të fjalës Umet, të cilët janë të mbrojtur nga gabimi, meqë me bidatin e tyre nuk kanë kaluar në pabesim. Çdo gjë çka është te këta, është se ndonjëri prej tyre është mëkatar, e mëkati i madh nuk e zhvesh njeriun nga ixhtihadi.

Për ta vërtetuar gjendjen e tij, shikohet ajo çka vlerësohet prej ixhtihadit të tij dhe vërtetësisë së tij, si f.v. të tjerët muxhtehidë ta vlerësojnë atë, nga shkaku se vërtetësia e mëkatarit kuptohet prej rrethanave dhe faktorëve tjerë, të fjalëve dhe mendimeve të tij.²⁷

Vërehet se nuk pranohet argumentimi për zhvleftësimin e bidatit, që thuhet se shpie në pabesim, dhe shpalljen e pabesimit të tyre me ixhmain, i cili është në kundërshtim me to (bidate), nga shkaku se Ehli Suneti që e kundërshton bidatin është umeti bidatit i cili përjashton nga radhët e tij. Përjashtimi prej umetit varet prej argumentimit për pabesimin e tyre. Kështu pra, nuk lejohet që argumenti i pabesimit të tyre të jetë peng për mosrealizimin e ixhmait. Por, vërteton se nuk është pjesë e ixhmait.

Sa i përket muxhtehidi fasik, ai është prej anëtarëve të ixhmait; pa të nuk realizohet ixhmai, nga shkaku se fasiku është muxhtehidë dhe nuk është e patjetërsueshme t'i pasojë të tjerët, por e vepron atë çka rezulton prej ixhtihadit të tij. Ai është pjesë e umetit. Mospranimi i lajmit të fasikut bëhet në fushat ku nuk bëhet interpretimi dhe ixhtihadi, nëse njihet si fasik, sepse mëkati i madh nuk çrrënjos cilësinë e besimit.²⁸

E dyta: Çka përfshihet në fjalën “pajtueshmëri” e muxhtehidinëve

Fjala “**muxhtehidinë**” në definicionin e ixhmait është fjalë e përgjithshme, sepse thuhet me “**lamin**” shques. E shumësi i shquar, me “**lamin**” shques të llojit, tregon për përgjithësimin, siç është e njohur në formulën e përgjithësorit. Kështu, për t'u realizuar ixhmai, duhet pajtueshmëria e të gjithë muxhtehidinëve.²⁹

Nëse ndodh unifikimi i muxhtehidinëve të një grupi të caktuar prej tyre, te shumica absolute e dijetarëve nuk konsiderohet ixhmaë.

Gjithashtu, ixhmaë nuk konsiderohet ixhmai i vetëm i banorëve të Medinës,

apo ixhmai i banorëve të dy haremave (Qabës dhe Xhamisë se Pejgamberit s.a.v.s.)

dhe as ixhmai i banorëve të Basrës, apo i Kufës,

dhe as ixhmai i Ebu Bekrit dhe Umerit,

dhe as ixhmai i vetëm katër halifeve,

dhe as ixhmai i Ehli Bejtit.

Në këtë punim do t'i paraqes këto ixhmaë dhe mendimet më të njohura të dijetarëve për ta.

Ixhmai i banorëve të Medinës

Imam Maliku, Zoti e pastë mëshiruar, ka thënë: **“Ixhmai i banorëve të Medinës është argument”** që do të thotë nëse janë prej sehabeve, ose tabiinëve, ndërsa prej të tjerëve, përpos tyre, nuk konsiderohet argument, kështu ka sinjalizua edhe Ibni Haxhibi.

Në librin Muteva (të Malikut) kjo është paraqitur më përafërsisht në katërdhjetë e tetë çështje

Dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme në atë se ixhmai i tyre a konsiderohet argument?

Disa kanë thënë: Qëllimi është se transmetimi (mendimi) i tyre ka përparësi ndaj transmetimeve (mendimeve) të tjera, nga shkakut se kanë qenë më të pranishëm me Pejgamberin s.a.v.s.

Disa kanë thënë: Qëllimi është se ixhmai i tyre është argument për çështjet e njohura, të transmetuara prej tyre, që do të thotë çështjet të cilat nëpërmjet rrugës së tyre janë transmetuar, si f.v: Ezani, ikameti, saa (masë peshe) dhe mudi (masë), e jo në çështje tjera.³⁰

Karafiu dhe Ibni Haxhibi kanë thënë:³¹ E vërteta është se ixhmai i tyre vlen edhe në këto, edhe në çështje tjera, nga shkakut se natyra (tradita) shpie në atë. Njerëzit si këta nuk pajtohen përpos në argumentin më të mirë.

Bazuar në këtë, ixhmai i banorëve të Medinës është dy llojesh:

Lloji i parë: rruga e transmetimit dhe e tregimit dhe

Lloji i dytë: rruga e ixhtihadit.³²

Lloji i parë: Ixhmai i transmetuar

Ky ndahet me sa vijon:

1. Transmetues është ixhmai për transmetimin e ligjit nga **Pejgamberi s.a.v.s.**, pa marrë parasysh se a ka qenë fjalë, vepër apo pranim në heshtje, ose e ka lënë një çështje ashtu siç ka qenë, për shkak se ajo ashtu ka ekzistuar, por që nuk e ka vepruar.

Për këtë lloj të ixhmailt disa muhadithinë kanë thënë: Transmetimit të tyre i jepet përparësi ndaj transmetimeve të tjerëve, nëse kundërshtohet transmetimi i tyre dhe nuk ka pajtueshmëri në transmetimin e tyre, si f.v.; Duaja e kunutit në namazin e sabahut. Shihet se Buhariju ka pasur këtë mendim³³, pasi që është vërejtur se i ka dhënë përparësi hadithit të banorëve të Medinës në çdo temë, e pastaj ka shkruar hadithet e tjerëve.

Shumica absolute e dijetarëve dhe shumica e muhadithinëve kanë thënë: Nuk ka transmetim të Medinës si transmetim i Medinës me veçori të veçanta ndaj transmetimeve të tjera të muhadithinëve, nga shkak se dallimi bëhet në bazë të drejtësisë dhe të saktësisë, e jo në bazë të qyteteve.

2. Ixhmai në transmetimin e masave të caktuara dhe përcaktimin e vendeve, si f.v.; transmetimi i caktimit të **“Mudit” “Saas”**, përcaktimi i vendit të mimberit, përcaktimi i vendi të tij për namaz, pastaj varri, dhoma dhe mesxhidi, Kuba, përcaktimi i Revdatu Xhenetit; Bekijes, vendfaljet tjera. **Disa prej Malikijëve kanë thënë:** Imam Maliku ka pasur për qëllim këtë lloj të ixhmailt.

3. Ixhmai për transmetimin e veprimeve prej kohës së Pejgamberi s.a.v.s. e deri te koha e Imam Malikut, si f.v: transmetimi i përsëritjes së fjalëve të tekstit të ezanit dhe mospërsëritja në ikamet që ezani të bëhet nga një vend i ngritur dhe se kjo ka qenë para agimit në namazin e sabahut, transmetimi i tyre për **bujqësi**, mosdhënia e zekatit për perime dhe veprimet tjera. Në librin Muvetaë të Malikut shihet qartë se ai ka pasur për qëllim këtë lloj të veprimeve të banorëve të Medinës. Ibn Kajimi thotë: Këto transmetime dhe këto veprime janë argument dhe e kemi obligim t'i pasojmë, janë sunet që duhet t'i pranojmë dhe t'i ruajmë si sytë e ballit.

Dijetari kur të arrijë këtë, e deklaron ashtu siç është dhe me të bindet dhe qetëson veten e tij.³⁴

Lloji i dytë: Çështjet të cilat janë nëpërmjet rrugës së ixhtihadit dhe argumentimit

Në lidhje me këtë, nxënësit e Malikut janë ndarë në tri grupe:

E para. –Nuk është ixhmaë dhe nuk i jepet përparësi ixhtihadit të tyre ndaj të tjerëve.³⁵

E dyta. –Nuk është argument, por ixhtihadit të tyre i jepet përparësi ndaj të tjerëve.

E treta. –Është argument, por nuk është i ndaluar kundërshtimi ndaj tyre.

Kadiu Abdul Vehab el Malikiju ka thënë: Ky lloj i argumentimit, nëse është në kundërshtim me haberin (lloj hadithi), haberi ka përparësi te shumica absolute e dijetarëve tonë.

Një grup i dijetarëve ka thënë: Ka përparësi ndaj haberit, nga shkak se llogaritet si mëkat.

Kjo nuk është e vërtetë, nga shkak se pagabueshmëri është pagabueshmëria e tërë umetit, e jo një pjesëze të saj.

Ebu Abas Kurtubiju ka thënë: Sa i përket llojit të parë (ajo çka ka ardhur nëpërmjet transmetimit) duhet që të mos ketë kundërshtime, nga shkak se është transmetim i sigurt dhe nuk ka dallim a është foljor, vepror, apo miratues, sepse i tërë ai transmetim është arritur nëpërmjet diturisë së kategorisë së prerë; për shkak se ato janë një numër i madh dhe një turmë e madhe, që normalisht ai zë vendin e të kundërtës së të vërtetës. Nuk ka dyshim se kjo është rruga më prioritare nga lajmet e vetmuara, Kijaset, dhe pamjet e jashtme të çështjeve.

Përderisa, sa i përket llojit të dytë (ajo çka përfitohet prej rrugës së ixhtihadit) ka përparësi nëse është mendim i vetmuar dhe prioritar, nëse ndodhen dy mendime të kundërta.³⁷

Bazuar në këto mendime, Ixhmai i banorëve të Medinës, nëpërmjet **rrugës transmetuese**, nuk është argument nga shkaku i ixhmait të tyre, por për shkak të transmetimit të sigurt prej tyre, ose nëpërmjet formës së çështjeve, të cilat i kanë prezantuar, dhe rrethanave, të cilat tregojnë për qëllimet e sheriatit.

Sa i përket llojit të dytë, ixhmait argumentues, hadithi ka përparësi ndaj tij, nga shkaku se nuk është ixhmaë, as argument: këtë e ka thënë Kerafiju dhe Ibni Kajimi.

Profesori Muhamed Ebu Zehra ka thënë: Duke përcjellur në vazhdimësi fjalimet e Malikut me të vepruarit e banorëve të Medinës, shihet se ai ka vepruar me veprimet e tyre në bazë të asaj se ato vepra patjetër duhet të kenë qenë të transmetuara. Ai e ka paraparë që veprimet e tyre gjithmonë kanë qenë transmetime dhe nuk e ka paraparë se mendimi i tyre bazohet në mendimin e tyre.

Përfundojmë se: Ixhmai i banorëve të Medinës është i transmetuar si hadith mutevatir, ndërsa ixhmai i ixhtihadit është vetëm argument te ai, e jo ixhmaë.

Argumentet

Disa Malikij, si f.v. Kurtubiju, për argumentimin se ixhmai i banorëve të Medinës me llojet e tij është argument janë argumentuar edhe në bazë të logjikës, edhe në bazë të transmetimit ma sa vijon:³⁸

Sa i përketë argumentimit transmetues. –është thënia e Pejgamberit s.a.v.s.; **“Banorët e Medinës janë të mirë, e largojnë të keqen, ashtu siç e largon vaji ndryshkun e hekurit”**.³⁹ Thonë: Gabimi është i keq, kështu që gabimi është i huaj (larguar) për banorët e Medinës, sepse po të ishte në banorët e saj, do të ishte në të, e pasi që gabimi është i larguar nga ta, atëherë ixhmai i tyre është argument.

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: ***“Imani ngjitet në banorët e Medinës, ashtu siç ngjitet gjarpri në birucën e tij”***⁴⁰

Po ashtu ka thënë: ***“Nuk mund t’i tradhtojë askush banorët e Medinës, përpos që ai vet tradhtari shkrihet, ashtu siç shkrihet kripa në ujë”***⁴¹

Sa i përket tekstit të parë, kundërpërgjigja është kështu: Nuk është tekst i cili mohon gabimin e ixhtihadit për atë që pajtohen banorët e Medinës, sepse është e mundur që qëllimi i tekstit është të humburit në vepra dhe fisku (mëkatet e mëdha).⁴² E, kjo ka ndodhur.

Ndoshta qëllimi është se ajo është më e mirë se tjetra, mirëpo kjo nuk tregon se ato janë të mbrojtur prej mëkateve. E, argument është se nëse i humb mundësia, i bie edhe argumenti; por ne nuk jemi duke thënë se gabimi është gjë e keqe, nga shkakut se mëkati falet. Ndërsa e keqja është e ndaluar prej hadithit të Muhamedit s.a.v.s.: **Qeni është i keq, e i keq është edhe fitimi i të hollave prej tij.** Pastaj, thënia e Pejgamberit s.a.v.s.: ***“Paratë e prostitutës janë të këqija”***.⁴³

Kundërpërgjigja në dy tekstet tjera është se qëllimi prej tyre është që të tregohet nderi i Medinës dhe rëndësia e saj, pasi që në të janë të përmbledhura cilësitë në bazë të asaj se është vendi ku janë vendosur emigrantët (muhaxhirët), në të është vendi i varrit të Pejgamberit s.a.v.s., strofull i shpalljes, epiqendër Islame, vendtubim i sehabeve; mirëpo kjo nuk ka të bëjë me atë se është i mbrojtur umeti prej gabimit nëse bën ixhtihad, siç kemi sqaruar më parë.

Sa i përket argumentit logjik, përgjigjemi në dy aspekte:

E para: Natyrshmëria tregon se ai numër i madh që qëndron në Medinë, i cili është vend i shpalljes, dhe të cilët kanë dëshmuar në zbritjen e Kur’anit, kanë dëgjuar komentimin e tij dhe kanë qenë më të diturit për gjendjen e të Dërguarit s.a.v.s. nga të tjerët, nuk është e drejtë që të pajtohen përpos se në argumentin më të mirin. E vërteta është e pandashme prej tyre. Ky është argumentimi më i fuqishëm, në të cilin është mbështetur Ibni Haxhibi.⁴⁴

E dyta: Vërtet, ixhtihadi i tyre, i cili ka rezultuar deri te ixhmai i tyre, është njësoj sikurse transmetimi i tyre, e transmetimi i tyre ka përparësi ndaj transmetimeve të të tjerëve, e për këtë janë të pajtimit që të gjithë. Për këtë arsye, ixhmai i tyre është argumentim për të tjerët.

Kundërpërgjigjja e pjesës së parë. Do të kishte qenë e drejtë, po mos të ishin shpërndarë sehabet në rajone dhe po mos të ishin shpërndarë në vende të ndryshme.⁴⁵ Disa prej sehavebe janë larguar nga Medina, si p.sh. Ali bin Ebi Talibi, Ibni Mes'udi, Ebu Musa esh-Shariju, dhe është e lejuar dhe e mundshme që këta të japin mendim më prioritar se sa ndonjë prej sehavebe që kanë qëndruar në Medine. Ne Ether është transmetuar se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: ***“Sehabet e mi janë sikurse yjet; në çdonjërin prej tyre nëse mbështeteni jeni të udhëzuar”***.⁴⁶ Nuk i ka specifikuar të cilësuarit (sehabet) të një vendi, nga ndonjë vend tjetër për këtë çështje, por duhet shikuar vetëm argumentin në tërësi.

Sa i përket pjesës së dytë: është një pasqyrim i një shembulli, i cili nuk argumenton bashkimin e transmetimeve dhe transmetuesve, nga shkaku se transmetimi është i ndërtuar në dëgjimin dhe ndodhjen e ngjarjeve të transmetuara në kohën e Pejgamberit s.a.v.s.

Përderisa njerëzit transmetues dhe ixhtihadi janë rrugë e analizës dhe e hulumtimit të dispozitës. E, kjo nuk ndryshon me ndryshimin e vendeve. Përpos kësaj, dhënia e përparësisë transmetimit të banorëve të Medinës bëhet atëherë kur nuk e kundërshtojnë transmetimet e shumicës së transmetuesve; ndërsa nëse e kundërshtojnë transmetimet e shumicës së transmetuesve, atëherë i jepet përparësi atyre, për shkak se janë më shumë transmetues.

E, dihet se është marrë vendim që nëse transmetuesit janë të barabartë në precizitet dhe në vërtetësi, i jepet përparësi atij transmetimi që ka më shumë transmetues.

Sa i përket pretendimit se i duhet dhënë përparësi transmetimit të Medinasve, është e papranuar gjithashtu, nga shkaku se shumica absolute e fukahave dhe muhadithinëve nuk e kanë këtë mendim, siç e sqarova në rastin e sqarimit të llojit të parë të ixhmait të banorëve të Medinës. Por, masë nivelizuese është dhënia përparësi në bazë të vërtetësisë dhe

precizitetit, ndërsa nuk është logjike që vendet të jenë peshojë e vërtetësisë dhe e precizitetit.

Pas gjithë këtij debati, nuk më mbetet gjë tjetër pos që ta përkrah mendimin e shumicës absolute të dijetarëve, të cilët thonë se ixhmai i banorëve të Medinës nuk është argument se është ixhmaë. Këtë mendim e kanë analitikët, prej nxënësve të Malikut, sikurse e ka përmendur Kadiju Abdul Vehabi. Të njëjtën vërejtje e ka dhënë edhe Enbariju, nga shkaku se argumentimet të cilët tregojnë se ixhmai është argument përfshin banorët e Medinës dhe të tjerëve, e nuk janë banorët e Medinës i tërë umeti dhe të gjithë besimtarët e botës. E, kjo do të thotë se ixhmai i banorëve të Medinës nuk është argument, pa marrë parasysh se ai ixhmaë a është realizuar prej transmetimit apo ixhtihadit të tyre.

Shafiiju e ka kundërshtuar ixhmain e banorëve të Medinës në dy aspekte.

E para prej tyre është se çështja për të cilën janë pajtuar nuk është pajtimi i të gjithë qytetit, por pajtimi i dijetarëve të çdo qyteti.

E dyta: Çështjet për të cilat pretendohet se është ixhmaë i banorëve të Medinës,

Ka prej banorëve të Medinës që mendojnë ndryshe për atë çështje.

Ka prej banorëve të qyteteve të cilët e shohin ndryshe,⁴⁸ siç e ka treguar Ibn Kajimi, duke replikuar Malikijt, të cilët thonë se duhet vepruar sipas mendimit të banorëve të Medinës.⁴⁹

Ixhmai i dy qyteteve të shenjta dhe i banorëve të dy rajoneve

Gjithashtu Ixhmai i dy qyteteve të shenjta (Mekës dhe Medinës) dhe banorëve të dy rajoneve (Basrës dhe Kufës) nuk llogaritet argument,⁵⁰ nga shkaku se ata janë një pjesë e umetit, siç kemi cekur më lartë të ixhmai i banorëve të Medinës, dhe se për argumentet e sheriatit nuk ka dallim të një vendi nga ndonjë vend tjetër

Disa prej dijetarëve të Usulit pretendojnë se ixhmai i dy qyteteve të shenjta dhe i banorëve të dy rajoneve është argument pasi që ixhmai i tyre është i specifikuar me sehabet. Këto qytete kanë qenë të banuara me sehabe dhe vetëm një numër i vogël është larguar nga aty. Mirëpo, unë nuk shoh ndonjë arsye për këtë, nga se sehabet kanë qenë të shpërndarë edhe në

vendet tjera, si në Jemen, Siri dhe Irak. Përpos kësaj, kjo të bën të ndiesh që ixhmai ka të bëjë posaçërisht me sehabet, mirëpo fjala është për ixhmain në përgjithësi.

Ixhmai i dy shejhave dhe ixhmai i halifeve të drejtë

Disa dijetarë kanë thënë: Ixhmai i dy shejhave, pra ixhmai i Ebu Bekrit dhe Umerit, është argument, duke u bazuar në thënien e Pejgamberit s.a.v.s.: ***“Mbështetuni në ata që vijnë pas meje, në Ebu Bekrin dhe Umerin”***.⁵¹ Këtë hadith e ka transmetuar Tirmidhiu. Ai thotë: është hadith i mirë.

Disa dijetarë, e prej tyre Kadju Ebu Hazim i Hanefijëve, dhe sipas një transmetimi nga Ahmed bin Hanbeli, **kanë thënë:** Ixhmai i katër halifëve të drejtë, pra ixhmai i Ebu Bekrit, Umerit, Uthmanit dhe Alijut r.a, është argument pos të tjerëve. Këtë e arsyetojnë me hadithin e Pejgamberit s.a.v.s.: ***“Përmbahuni në sunetin tim dhe në sunetin e Halifëve të drejtë që vijnë pas meje dhe shtrëngohuni fort për to”***. Këtë hadith e ka transmetuar Ebu Davudi, Ibn Maxhe, Darumiju, Ahmedi, Ibni Habani, e po ashtu e ka vërtetuar Tirmidhiu. Pastaj Hakimi ka thënë: Është e vërtetë në bazë të kushtit të dy shejhave. Hadithi tregon se Pejgamberi s.a.v.s. ka urdhëruar të pasohet suneti i katër halifeve të drejtë, siç ka urdhëruar të pasohet suneti i tij. Halifet e drejtë janë halifet e sipërpërmendur se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: ***“Hilafeti pas meje është tridhjet vite, pastaj do të ndodhë sundimi i padrejtë”***.⁵² Hilafeti i tyre ka qenë njëzet e nëntë vite e gjashtë muaj, e gjashtë muaj tjerë janë epoka e hilafetit të Hasan bin Alijut. Kështu thotë pretenduesi.

Ndaj haditheve kundërpërgjigjja është kështu: Qëllimi në to është mbështetja në to, e jo siç thonë ata se është argument ndaj të tjerëve, sepse muxhtehidi e ka për detyrë të hulumtojë argumentet deri sa të dalë në shesh ajo që ai e mendon se është e vërtetë. Këto dy hadithe janë në kundërshtim me hadithin tjetër. Nëse këto hadithe tregojnë argumentim për halifet apo për disa prej tyre, atëherë edhe hadithi: ***“Jam i kënaqur me umetin tim, ashtu siç është i kënaqur për ta biri i nënës së robit”***.⁵³ do të tregonte argumentim për të.

Po ashtu, edhe hadithi: *“Ebu Abidete bin Xherah është besniku i këtij umeti”*⁵⁴ do të tregonte argumentim për të; që të dy këto hadithe janë autentike.

Po ashtu, edhe hadithi: *“Sehabet e mi janë sikurse yjet; nëse mbështeteni në çdonjërin prej tyre do të jeni të udhëzuar”*, do të tregonte argumentim të mendimit të çdonjërit prej tyre. Siç kanë deklarua dijetarët e hadithit, ky është hadith tepër i dobët.

Po ashtu edhe hadithi: *“Gjysmën e fesë suaj mësoni nga kjo bardhoke”*,⁵⁵ ka për qëllim Aishen r.a., edhe pse mendimi i saj nuk është argument. Ky hadith është kritikuar. E, kur dy lajme (habere-hadithe) kundërshtohen në mes vete, atëherë bie poshtë argumentimi prej tyre.

Bazuar në këtë, përkrah mendimin e shumicës absolute të dijetarëve se ixhmai i katër halifeve të drejtë nuk është argument, nga shkakut se ato janë vetëm një pjesë e umetit,⁵⁶ por, sa i përket kësaj teme, unë kam një analizë tjetër, e ajo është se: Nëse ixhmai i katër halifeve ka ndodhur në kohën e tyre dhe nuk ka pasur asnjë njeri i cili i ka kundërshtuar, unë e llogarit në rangun e ixhmait të heshtur.⁵⁷ Mirëpo, nëse gjendet ndonjëri që i ka kundërshtuar, mendimi i tyre nuk është ixhmaë. Vetëm se larg mendjes është të ketë ndodhur që ndonjëri t’i kundërshtojë ata, sepse si është e mundur të imagjinohet që të jetë ndonjë mendim që e kundërshton mendimin e gjithë atyre halifeve, edhe pse kalojnë shume gjenerata, ashtu siç nuk dihet që ndonjëri është paraqitur kundër ndonjërit prej halifeve, pasi që është vendosur ndonjë vendim, është vërtetuar dhe është vepruar me të, nga shkakut se shumë ngjarje kanë treguar se ata e kanë kthyer vendimin, nëse është paraqitur ndonjë argument i fuqishëm kundrejt vendimit të tyre, siç është çështja e trashëgimisë së gjyshes⁵⁸ dhe çështja e Ebi Musa el Esharijut për të kërkuar leje tri herë, kundrejt mendimit të Umerit.⁵⁹

Imam Gazaliu thotë: Një grup thotë: Argument është pajtueshmëria e katër halifeve është dispozita kur merret mendimi dhe nuk ka argument kundrejt atij mendimi. Kjo është kështu, përveç të një grupi i cili thotë se mendimi i sehabës është argument.

Ixhmai i Utres (Familjes së ngushtë të Muhamedit s.a.v.s.)⁶⁰

Shiitët Imamije dhe Zejdije thonë se ixhmai i **Utres** është argument. Me këtë fjalë ata kanë për qëllim Alijun, Fatimen dhe dy fëmijët e tyre Hasanin e Hysejnin. Këta janë argumentuar me Kur'an, sunet dhe me argument logjik.⁶¹

Sa i përket Kur'anit: Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

إِنَّمَا يُرِيدُ اللَّهُ لِيُذْهِبَ عَنْكُمُ الرِّجْسَ أَهْلَ الْبَيْتِ وَيُطَهِّرَكُمْ تَطْهِيرًا

“Vërtet, Allahu dëshiron që nga ju të largojë papastërtinë, o ju ehlul bejt, dhe që t’ju pastroj juve me një pastrim të veçantë.” (El Ahzab, 33)

Ana argumentuese nga ky ajet është se Zoti i Lartmadhëruar ka informuar largimin e papastërtisë nga ehlul bejti me pjesëzën **“inema”** që do të thotë përkufizimi bëhet posaçërisht për ta. Kështu që atyre nuk mund t’u ndodhë gabimi dhe papastërtia. E, pasi që janë kursyer nga gabimi, atëherë ixhmai i tyre është argument. E **“ehlul bejt”** janë Aliu, Fatimja dhe dy fëmijët e tyre, Hasani dhe Hysejni, nga shkakut se kur ka zbritur ky ajet Pejgamberi s.a.v.s. i ka mbështjellur me një rrobë dhe ka thënë: **“Këta janë ehlul bejt”** (Këta janë familja ime).⁶²

Gjithashtu, janë argumentuar me thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

قُلْ لَا أَسْأَلُكُمْ عَلَيْهِ أَجْرًا إِلَّا الْمَوَدَّةَ فِي الْقُرْبَىٰ

“Thuaj (O Muhamed): Nuk kërkoj nga ju kurrfarë shpërblimi, përpos dashuri dhe respekt familjes.” (Esh-Shura, 23)

Kundërpërgjigjja për këto dy argumente: Ajeti i parë ka zbritur për gratë e të Dërguarit s.a.v.s. me qëllim që të mënjanojë akuzimet e tyre” dhe që të shikohen ato. Këtë qëllim e udhëzon ajeti i parë në vijim, ku Zoti i Lartmadhëruar thotë:

نِسَاءَ النَّبِيِّ لَسْتُنَّ كَأَحَدٍ مِّنَ النِّسَاءِ ۚ إِنَّ اتَّقِيْنَ فَلَا تَخْضَعْنَ بِالْقَوْلِ
فَيَطْمَعَ الَّذِي فِي قَلْبِهِ مَرَضٌ وَقُلْنَ قَوْلًا مَّعْرُوفًا ﴿٣٢﴾ وَقَرْنَ فِي بُيُوتِكُنَّ وَلَا
تَبَرَّجْنَ تَبَرُّجَ الْجَاهِلِيَّةِ الْأُولَىٰ ۚ وَأَقِمْنَ الصَّلَاةَ وَآتِينَ الزَّكَاةَ وَأَطِعْنَ اللَّهَ
وَرَسُولَهُ ۚ إِنَّمَا يُرِيدُ اللَّهُ لِيُذْهِبَ عَنْكُمُ الرِّجْسَ أَهْلَ الْبَيْتِ وَيُطَهِّرَكُمْ تَطْهِيرًا

﴿٣٣﴾

“O gratë e Pejgamberit! Ju, nuk jeni si gratë e tjera. Nëse i frikësoheni Allahut, mos flisni përkëdhelshëm, e që t’ju dëshirojë ai i cili në zemrën e tij ka sëmundje, dhe flisni ndershëm e mirë. Dhe qëndroni në shtëpitë tuaja, e mos u zbuloni, ashtu siç janë zbuluar në kohën e injorancës. Falni namazin, jepni zekatin, dëgjojeni Allahun dhe të dërguarin e Tij. Allahu do që të asgjësojë mëkatet nga ju, o familje (e pejgamberit) dhe t’ju pastrojë plotësisht.” (Ahzab : 32-33)

Ndërsa, ajeti në vijim thotë:

وَاذْكُرْنَ مَا يُتْلَىٰ فِي بُيُوتِكُنَّ

“Dhe përkujtoni çka ju lexohet në shtëpitë tuaja.” (el-Ahzab, 34)

E, ajeti nuk tregon se vetëm ixhmai i utres (familjes së Muhamedit s.a.v.s.) është argument.

Edhe po të pranoni një gjë të tillë, se qëllimi i ajetit është **“ehlul bejti”** (familja e Muhamedit s.a.v.s.), atëherë pse shiitët këtë term e përkufizojnë vetëm në Alijun, Fatimen dhe dy djemtë e tyre. Ehlul bejti (familja e Muhamedit s.a.v.s.) përfshin gratë e të dërguarit dhe fëmijët e tij. Përpos kësaj, pjesa përkufizuese e ligjëratës **“inema”** tregon për përkufizimin, i cili ka për qëllim largimin e papastërtisë, që do të thotë: **“O ju familja e Muhamedit s.a.v.s., Allahu dëshiron vetëm të largojë papastërtinë nga ju”**, sepse, siç dihet, në gramatikën e gjuhës arabe kur të vijë pjesa përkufizuese **“inema”** tregon për përkufizimin e asaj çka vjen pas

kësaj fjale. E, kjo është në kundërshtim me atë që e kanë kuptuar shiitët se përkufizimi i largimit të papastërtisë është posaçërisht për ta (ehlul bejt), e jo për të tjerët.⁶³ Por, edhe poqëse do të pranohet, siç i jep përparësi këtij mendimi Shefkaniju⁶⁴, se përkufizimi është për Alijun, Fatimen dhe dy fëmijët e tyre, është e papranueshme, sepse këtë nuk e thotë as gjuha arabe, e as sheriat.

Sepse: gjuhësisht fjala **“rixhs”** ka kuptimin e ndotësirës, e në sheriatë qëllimi është dënimi për në botën tjetër. Siç thotë Zoti i Lartmadhëruar:

قَدْ وَقَعَ عَلَيْكُمْ مِّن رَّبِّكُمْ رِجْسٌ وَغَضَبٌ

“Vërtet, ka ra mbi ju, nga Zoti i juaj dënimi (në botën tjetër) dhe hidhërimi (i Tij).” (el-Earaf, 71)

dhe po ashtu thënia e Zotit të Lartmadhëruar **“prej dënimit të dhembshëm”** e kuptimi i fjalës **“rixhs”** është **“dënim”**

Sa i përket përgjigjes në ajetin e dytë është shumë e qartë, sepse dashuria dhe respekti ndaj familjes së Pejgamberit s.a.v.s. është diçka tjetër, e ixhtihadi është diçka tjetër.

Sa i përket argumentit të tyre nga suneti, është thënia e Pejgamberit s.a.v.s.: **“Unë në mesin tuaj kam lënë dy baza; nëse mbaheni me to, kurrë nuk do të humbni, e ato janë: libri i Allahut dhe familja ime.”**⁶⁵ Përkufizimi i përmbajtjes në të nuk lë hapësirë që argument të jenë të tjetrës, s pos tyre.

Kundërpërgjigjia është se ky hadith është lajm i vetëm, i cili nuk është argument për ta. Edhe po ta llogarisim si argument, nuk pranohet se fjala **“thekalejn”** (bazat) libri dhe **utre** ka për qëllim librin dhe familjen e Muhamedit s.a.v.s., por ka për qëllim Kur’anin dhe sunetin. Argument për këtë kemi hadithin e transmetimit tjetër: **“librin e Allahut dhe sunetin tim”**⁶⁶. Bashkimi i transmetimeve jep këtë kuptim. Mirëpo, e ka përmendur posaçërisht fjalën **“utre”**, sipas transmetimit të tyre, sepse është informim për gjendjen e Pejgamberit s.a.v.s., prej fjalëve dhe veprave të tij. E, shprehja në atë mënyrë është alegori e sunetit.

Sa i përket argumentit logjik: është se ehlul bejti janë të veçuar edhe nga aspekti i nderit, edhe nga aspekti i afërsisë së gjakut (gjenit). Ata janë shtëpia e shpalljes dhe vendi i Pejgamberit s.a.v.s., baza (epiqendra) shkaqeve të zbritjes së ajeteve dhe njohjes së interpretimit, dituri për veprat e të Dërguarit s.a.v.s. e të thënieve të tij, nga shkaku se vazhdimisht kanë

qëndruar me Pejgamberin s.a.v.s. dhe se ato kanë qenë të siguruar dhe të mbrojtur prej gabimeve, e argument janë ajetet e sipërpërmendura. Për këtë arsye, thëniet dhe veprat e tyre janë argument, e thëniet e të tjerëve nuk janë argument.

Kundërpërgjigjja ndaj tyre është se: specifikimi me ato attribute nuk ka të bëjë me ixhtihadin dhe me nxjerrjen e ligjeve nga korniza e vet. Ndërsa, për të arritur nivelin e lartë duhet pasur aftësi të hulumtimit dhe argumentimit.

Sa i përket asaj se kanë qenë vazhdimisht në prani të Pejgamberit s.a.v.s., ato çka në vazhdimësi kanë qenë në prani të Pejgamberit s.a.v.s. kanë qenë gratë e Pejgamberit s.a.v.s. dhe sehabet tjera.

Sa i përket mbrojtjes dhe sigurimit të tyre nga gabimi nuk është argument i argumenteve të pranuar, nga shkaku se në ajetin e *“largimit të papastërtisë”* është largimi i dyshimeve dhe akuzimeve ndaj grave të Pejgamberit s.a.v.s., e që është e zhveshur nga gabimi në ixhtihad, dhe pasi që pagabueshmëria ekskluzivisht ka qenë për shpalljen, e nuk ka shpallje përpos Pejgamberit s.a.v.s.

Për këtë arsye, i jap përparësi mendimit të shumicës absolute të dijetarëve se ixhmai i utres (familjes së ngushtë të Muhamedit s.a.v.s.) nuk është argument.⁶⁷

Pajtueshmëria e shumicës së muxhtehidinëve

Dijetarët nuk janë pajtuar rreth ixhmait të shumicës së muxhtehidinëve.

Shumica absolute e dijetarëve thonë se është i pavlefshëm.

Ebu Husejn dhe Ebu Bekri Rraziju thonë se edhe nëse një apo dy dijetarë kundërshtojnë, ixhmai i të tjerëve është i plotfuqishëm.

Ibn Haxhibi thotë: Nëse paraqitet ndonjë kundërshtues, ai ixhmaë nuk është ixhmaë i prerë, por nga aspekti i jashtëm llogaritet argument, nga shkaku se më larg mendjes është që t'i jepet përparësi mendimit të pakicës (e jo të shumicës së dijetarëve)

Disa mendojnë kështu: Nëse pakica kundërshtuese arrin në numrin e minimumit (Tevatur), llogaritet ixhmaë, e nëse është më pak se kjo nuk llogaritet ixhmaë.⁶⁸

Gazaliu thotë: Bazë për pagabueshmërinë është pajtimi i umetit në tërësi, e jo kjo (ixhmai i shumicës), sepse ka mospajtim në mes të ixhmait të shumicës dhe mendimit të pakicës. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

وَمَا اخْتَلَفْتُمْ فِيهِ مِنْ شَيْءٍ فَحُكْمُهُ إِلَى اللَّهِ

“Dhe për çka keni rënë në mospajtim mes vete për diçka, vendimi përfundimtar është te Allahu.”⁶⁹ (esh-Shura, 10)

Shumica absolute mendimin e tyre e mbështesin me dy argumente:

E para: Argumentet e argumentimit të ixhmait prej Kur'anit dhe sunetit, të cilat tregojnë për pagabueshmërinë e umetit.

Prej argumenteve të Kur'anit:

وَمَنْ يُشَاقِقِ الرَّسُولَ مِنْ بَعْدِ مَا تَبَيَّنَ لَهُ الْهُدَىٰ وَيَتَّبِعْ غَيْرَ سَبِيلِ
الْمُؤْمِنِينَ نُوَلِّهِ مَا تَوَلَّىٰ وَنُصْلِهِ جَهَنَّمَ

“Dhe kush kundërshton të dërguarin pasi që iu është sqaruar udhëzimi dhe pason rrugë tjetër pos rrugës së besimtarëve, do t'a orientojmë andej ka dëshirojnë ata.” (En-Nisa : 115)

Argument prej sunetit: *“Umeti im nuk unifikohet në humbje”*. Duke u bazuar në kuptimin e drejtë të fjalës, fjala umet ka për qëllim umetin në tërësi, por ka mundësi të ketë për qëllim shumicën e umetit, sikurse kur thuhet: *“Fisi benu Teminë i ruan fqinjët dhe i repsekon mysafirët”*. Këtu qëllimi është: shumica prej tyre. Mirëpo, kuptimi i parë ka përparësi ndaj kuptimit të dytë, nga shkaku se ndihmon të veprohet ashtu siç ka dashur Pejgamberi s.a.v.s., në mënyrë të prerë, nga shkaku se numri i shumicës bën pjesë në tërësinë. E, dhënia e kuptimit të umetit shumicës së umetit është më favorite. E, ka përparësi të vepruarit me atë çka është më favorite. E, atëherë ixhmai llogaritet argument i prerë.

E dyta: Po të kishte qenë mendimi i shumicës argument, sehabet do ta kishin urrejtur pakicën, e cila i ka kundërshtuar, mirëpo sehabet nuk i kanë urrejtur ata. Prej shembujve të tillë kemi:

- Pajtimin e shumicës së sehaveve për të penguar luftën kundër penguesve të zekatit; megjithëkëtë Ebu Bekri i ka kundërshtuar ata.

- Pastaj, kundërshtimi i sehaveve ndaj mendimit të vetëm të Ibni Abasit në çështjen e **“Avlit”** në trashëgimi.

- Pastaj, lejimi i martesës së përkohshme (Mut’a).

- Pastaj, çështja se nuk është kamatë përpos llojit të kamatës **Nesie**.

- Pastaj, pajtimi i shumicës së tyre në pjesën farz të trashëgimisë, ndërsa Ibn Mes’udi ka dhënë mendim ndryshe ndaj tyre. Po të kishte qenë argument mendimi i shumicës, ata do ta urrenin dhe do t’i thoshin se e ka gabim.

Në këto raste nuk është paraqitur asnjëri prej tyre që ta urrejë pakicën. Nuk ka qenë urrejtje negative për gabueshmëri, por ka qenë debat i paraqitjes së mendimit ndryshe, duke u bazuar në ixhtihad, siç është traditë e debatit të muxhtehidinëve ndërmjet tyre. Kjo vërtetohet se mendimi ndryshe ekziston deri në ditët e sotme.

Përpos Ibn Haxhibit, të tjerët, pos shumicës absolute, janë argumentuar me sa vijon:

E para: Me argumentet tekstuale, e ajo është se fjala **“umet”** në hadithe ka për qëllim shumicën. Thuhet: Umeti arab refuzon DIMIN. Qëllimi është: shumica prej tyre.

Po ashtu, thënia e Pejgamberit s.a.v.s.: **“Përmbajuni udhëheqësve të mëdhenj”⁷⁰,**

“Përmbajuni xhematit”⁷¹

“Ndihma e Allahut është në xhemat”⁷²

“Mos u veçoni”⁷³

Këto tekste tregojnë se ne jemi të urdhëruar që të pasojmë udhëheqësit e mëdhenj dhe të mënjanohe mi nga vetizolimi, sepse shejtani rri bashkë me të vetmuarin, e kur të bëhen dy veta largohet më shumë.⁷⁴ Kjo tregon se ixhmai i shumicës është argument, sepse këtë e tregojnë tekstet.

Kundërpërgjigja në këtë është se me fjalën umet mund të kuptohet se ka për qëllim shumicën jo në kuptim të drejtë të fjalës, por në kuptim alegorik. Atëherë fjalës duhet t’i jepet kuptim të **“tërësisë”**, sepse në të është argumentimi i prerë. Duhet që fjalës së Pejgamberit s.a.v.s., **“përmbajuni**

udhëheqësve të mëdhenj” t’i jepet kuptimi: ***“të gjithë banorët e asaj epoqe”***, sepse nuk ka ***“udhëheqës të mëdhenj”*** prej të gjithë muxhtehidinëve në asnjë epokë prej epokave.

Sa i përket ***“ndalimit nga vetizolimi”***, ka të bëjë me kundërshtimin dhe vetizolimimin pas legjitimitimit dhe pajtimit të ixhmait, e jo për atë i cili kundërshton para pajtimit (themelimit) të ixhmait. Përmbajtja e xhematit nënkupton përmbajtjen në atë çështje që është arritur legjitimimi i ixhmait dhe pajtimi i umetit.

E dyta: Ixhmai.

Sehabet janë bazuar për hilafetin e Ebu Bekri Sidikit, edhe pse shumica ishin pajtuar, ndërsa Aliju dhe Sead bin Ibadetu nuk ishin pajtuar. Po mos të kishte qenë argument pajtimi i shumicës, edhe pse një pakicë kundërshton atë shumicë, të zgjedhurit e Ebu Bekrit Imam (Halife) nuk do t’kishte qenë emërim në bazë të xhematit.

Për këtë replikohet se emërimi i Ebu Bekrit Imam (Halife) nuk ka nevojë që të aprovohet me ixhmaë. Po ashtu, edhe kundërshtimi i Alijut nuk ka qenë kundërshtim ndaj ixhmait, mirëpo ai ka kundërshtuar duke tërheq vërejtjen dhe duke paraqitur ndjenjat e tij emocionale për shkak të vdekjes së Muhamedit s.a.v.s. Sa i përket kundërshtimit të Sead bin Ibadës, pra kundërshtimi i tij për ta besatuar Ebu Bekrin, nuk ka qenë me ixhtihadë. Por, ai ka kaluar në anën e atyre të cilët kanë thënë: ***“Ju kenë udhëheqës, edhe ne kemi udhëheqës”***.⁷⁵ Kundërshtimi i tij ka qenë burim i appetiteve për udhëheqje, sepse ai ka menduar se të drejtë ka pasur tjetërkush, e jo siç është pajtuar ixhmai, ndërsa kundërshtimi i ixhmait pa ixhtihadë nuk konsiderohet prishje e ixhmait. Këtë e thonë shumica absolute e dijetarëve dhe nuk merret për bazë mendimi i kundërshtarëve të tij.

E treta: Argumentimi logjik. Kjo paraqitet në dy aspekte:

1. –Shumica arrihet kur anohet në lajmin e transmetuar, e animi në anën e shumicës arrihet nëpërmjet ixhtihadit.

Replika në këtë është se është analogji e pabazuar, pasi që për transmetimin e lajmit nevojitet peshimi i mendimit, e jo mendim i sigurt. Përderisa te ixhmai kërkohet të jetë i sigurt dhe i prerë dhe kur të kundërshtohet ajo çka është pjesë e saj, kundërshtohet çështja që të bëhet peshimi dhe krahasimi, për t’i dhënë njëres anë përparësi.

2. –Lajmi i një grupi të madh tregon informatë të sigurt, e lë që të tregojë edhe për ixhmain dhe ixhtihadin.

Ky mendim replikohet me atë se çdo informatë e cila informohet prej shumicës nuk tregon njohuri të sigurt. Ajo çka ka të bëjë për çështjet e prekshme, nuk është e domosdoshme që edhe çështja e ixhmait, e cila rezulton nga ixhtihadi, të jetë e njëjtë si ajo.

Po ashtu, nuk është e vërtetë se gjithmonë shumica e merr dispozitën e tërësisë. Por, kjo është një çështje e cila plotësohet në tërësi, ashtu si një çështje e cila plotësohet me shumicë, si f.v.- informata për paraqitjen e hënës së re, sepse ajo mund të arrihet edhe me informacionin e një pakice. Përderisa çështjen të cilën e realizon shumica nuk mund ta realizojë atë që e realizon tërësia në të shumtën e rasteve; nuk lejohet që ajo shumicë ta zëvendësojë tërësinë. Si p.sh.: nëse premton se do ta agjërosh një muaj, nuk e ke kryer borxhin nëse ke agjëruar shumicën e muajit. Ai i cili agjëron shumicën e ditës nuk llogaritet se e ka agjëruar ditën në tërësi. Ixhmai është i po të këtij lloji, nga shkak se pakica mund të ketë argumente që nuk mund t'i bindin shumicën e ixhmait.

Përpos kësaj, nëse çdo informatë tregon njohuri të sigurt, ajo informatë do të kishte qenë ixhmaë për të cilën është e nevojshme dhe atëherë ixhmai i çdo qyteti do të kishte treguar njohuri të sigurt.

Sa i përket argumentit të Ibn Haxhibit, i cili e llogarit pajtimin e shumicës si argument, por jo edhe ixhmaë, është se pajtimi i shumicës nga aspekti i jashtëm tregon se ekziston një dëshmi prioritare ose e prerë, në të cilën të dakorduarit janë pajtuar. Larg mendjes është që mendimi i kundërt prej tyre të jetë prioritare. Po ashtu, larg mendjes dhe larg realitetit është që shumica të paraqetë një argument, e pastaj ta kundërshtojë atë me qëllim ose pa qëllim. Të gjitha mundësitë janë larg realitetit. Kështu, duke e pasur parasysh ato mundësi, mendimi i shumicës është argument, i cili tregon siguri në atë dispozitë, e nuk është ixhmaë.

Mosdija se ka mospajtime

Shafiiju, Ahmedi, Serafiju dhe Ibn Hazmi thonë: Deklarimi i dikujt: Nuk di se ndonjë dijetar ka kundërshtuar, nuk është ixhmaë, nga shkak se është e mundur që ndonjëri ka kundërshtuar. Unë mendoj se ky është mendim i drejtë.

Mirëpo Ibn Katani thotë: Deklarimi i dikujt: Nuk di se ndokush ka kundërshtuar, nëse është dijetar, ai ixhmaë është argument, mirëpo nëse nuk është prej atyre që ka marrë pjesë në miratimin e ixhmait ose ka kundërshtuar, atëherë nuk është argument.

Po ashtu, Kadiju Mavrudi këtij mendimi ia ka shtuar edhe këtë fjali: Nëse dikush deklaron: Nuk di se në mesin e tyre ka pasur mospajtim, atëherë nuk miratohet ixhmai duhet hequr pika Nëse deklaruesi është muxhtehidë. Dijetarët Shafii kanë dhënë dy mendime:

Disa kanë thënë: Llogaritet ixhmaë,

Disa kanë thënë se nuk llogaritet ixhmaë.

Këtë mendim e ka kundërshtuar Muhamed bin Nasr el Mervuziju duke thënë: Disa pretendojnë se kur ndonjë dijetar nuk di se ndonjë ka kundërshtuar dhe për këtë është ixhmaë, mirëpo ky mendim është i pavlefshëm nga shkak se mbi çdo të ditur ka më të ditur.

Ajo që tregon se ky mendim është i pavlefshëm është mendimi i Shafiiut, i cili në lidhje me zekatin e lopëve ka thënë: Nuk e di se ndonjëri ka kundërshtuar se në më pak se tridhjetë lopë, e në mesin e tyre një mështjerrë⁷⁶ vaxhib është zekati. Ndërsa, në lidhje me këtë ekziston kundërshtimi i njohur: sepse një grup kanë thënë se zekati i lopëve është në pesë lopë njësoj, siç është edhe te zekati i deveve.

Maliku në librin e tij **“Muvetaë”** thotë: Është përmendur dispozita për kryerjen e përbetimit. Në këtë nuk ka mospajtim ndaj askujt, e as prej ndonjë vendi. Mirëpo, në lidhje me këtë është i njohur mospajtimi: Uthmani r.a. i cili nuk ka lejuar thyerjen e përbetimit, por e kompenson. Kështu mendojnë edhe Ibni Abasi, disa tabiinë, Ibn Ebi Lejla dhe Ebu Hanife me nxënësit e tij. Ata kanë qenë prokurorë në atë kohë. Përderisa ai (Shafiiju) nuk ka mundur të dijë mendimin e kundërt për rastin e përmendur, e çka të flasim për të tjerët.⁷⁷

Përfundim: Ajo çështje për të cilën nuk dihet se ka ndonjë mospajtim, bën pjesë brenda kornizës së ixhmait, e kjo sipas shumicës absolute të dijetarëve.

A duhet të jetë i mjaftueshëm numri i ixhmait (numri TEVATUR)

Për kushtëzimin e numrit të ixhmait, dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme:

Imami i dy haremeve dhe të tjerët, të cilët janë argumentuar për argumentin e ixhmait me argument logjik, thonë: Kushtëzohet numri i mjaftueshëm (Tevatur), nga shkaku se një grup i madh është e paimagjinueshme të unifikohet për gabim, përderisa numri i mjaftueshëm (Tevatur) është e mundur që të gabojë. Po ashtu, këtë mendim e kanë edhe disa, të cilët argumentohen për argumentin e ixhmait me argumente tekstuale të Kur'anit dhe sunetit.

Ndërsa, shumica absolute e dijetarëve thonë: Në ixhmaë nuk kushtëzohet numri i mjaftueshëm (Tevatur). Sipas mendimit tim, ky është mendim i drejtë, nga shkaku se legjitimimi i ixhmait me argument logjik është i paimagjinueshëm, për arsye se argumenti logjik, në të cilin janë mbështetur, ajo mbështetje është se nëse një grumbull njerëzish pajtohen për dispozitën e një çështjeje dhe e fiksojnë me fiksime të prerë, zakonisht është e pamundur që atyre t'u ndodhë gabimi. Është argument i paarsyeshëm, nga shkaku se zakonisht nuk ndodh gabimi prej një shumice të njerëzve me paragjykimet e tyre, se nuk është kategorikisht e prerë. Jehuditë dhe të krishterët, edhe pse janë të shumtë, ata janë pajtuar për idhujtari dhe për mospranimin e pejgamerisë së të dërguarit tonë Muhamedit s.a.v.s., të cilën do ta elaboroj kur do të flas për argumentimin e ixhmait.⁷⁸

Sa i përket argumentimit logjik, është i papranueshëm, sepse legjitimimi i ixhmait është bërë nëpërmjet argumenteve tekstuale të Kur'anit dhe sunetit. Siç do ta elaboroj më vonë me temën e argumentimit të ixhmait, përmendet fjala **“besimtarë”** dhe fjala **“umet”** dhe çfarëdo numri i muxhtehidinëve meriton titullin **“besimtarë”** dhe **“Umet”**, edhe nëse nuk e arrin numrin e mjaftueshëm (Tevatur). Mjafton që numri të jetë dy e më

shumë, nga shkaku se fjala **“muxhtehidinë”** është shumë dhe minimumi i shumësit është tre, dhe se për këtë kanë ardhur hadithet, të cilët kritikojnë kundërshtimin e xhematit si p.sh: Kush del jashtë kornizës së xhematit për një qime floku, ai është zhveshur rrënjësisht nga veshja islame.⁷⁹

Parimi i tretë: Që pjesëmarrësit e ixhmait të jenë nga umeti i Muhamedit s.a.v.s.

Kusht është që anëtarët e ixhmait, i cili është boshti i hulumtuesve, të jenë prej muslimanëve. E, ata janë: të gjithë ata të cilët i janë përgjigjur thirrjes së Muhamedit s.a.v.s. dhe që besojnë çka i ka zbritur atij.

Dijetarët janë pajtuar se pabesimtari nuk ka lidhje me këtë çështje,

Po ashtu, janë pajtuar se nuk merren parasysh popujt e mëhershëm, nga shkaku se në fenë tonë thënie e pabesimtarit janë të papranuara, ai akuzohet për shkak të kundërshtimit të fesë; pos kësaj, argumentet e vërtetimit të ixhmait, të cilat janë tekstuale, tregojnë se qëllimi i ixhmait ka të bëjë me umetin e Muhamedit s.a.v.s., ata janë pjesëtarët, të cilët janë siguruar që të mos gabojnë; janë ata të cilët nuk lejohen të kundërshtohen dhe duhet të pasohet mendimi i tyre.

Ne e kemi bërë të ditur më herët se muxhtehidi mëkatar dhe fekihi që sjell risi janë prej pjesëtarëve të ixhmait, pasi që ata bëjnë pjesë në termin **“umeti islam”**. Kjo është kështu deri sa ai, i cili sjell risi, nuk kalon në pabesim me risinë e tij.

Parimi i katërt: Që pajtimi i muxhtehidinëve të jetë tek pas vdekjes së Muhamedit s.a.v.s.

Ne edhe më herët kemi treguar për domosdoshmërinë e këtij kushti. Këtu do t'i përmendi mospajtimet e dijetarëve në lidhje me këtë:

Shumica absolute e dijetarëve thonë se: Nuk merret parasysh ixhmai në kohën e Muhamedit s.a.v.s., sepse nëse Pejgamberi s.a.v.s. pajtohet me mendimin e ixhmait, atëherë argument është vetë mendimi i Pejgamberit

s.a.v.s; nëse i kundërshton në atë çka janë pajtuar, nuk merret parasysh, nga shkaku se Pejgamberi s.a.v.s. është pjesëtar i shariatit, e nga ky shkak nuk mund të rezultojë ixhmai në kohën e Pejgamberit s.a.v.s.

Disa thonë: Ixhmai mund të rezultojë në kohën e Pejgamberit s.a.v.s., ashtu siç mund të rezultojë pas vdekjes së tij dhe ixhmai të llogaritet argument, ndërsa mendimi i Muhamedit s.a.v.s. të jetë argument tjetër. Nuk ka kurrfarë pengese që dy argumente të bashkohen për një çështje.⁸⁰

Kjo është e paarsyeshme, nga shkaku se nëse Pejgamberi s.a.v.s. pajtohet me sehabet për ndonjë dispozitë, ajo dispozitë aprovohet me sunet e jo me ixhmaë, e nëse kundërshton, atëherë dështon pajtimi dhe nuk mund të jetë dispozitë e shariatit dhe argumentimi me ixhmaë do të ishte atëherë i panevojshëm në kohën e Pejgamberit s.a.v.s. Pretendimi për bashkëngjitjen e argumenteve në mes vete nuk sjell diçka të re dhe është e palogjikshme, sepse kjo është joparimore dhe nuk ka bazë për t'u mbështetur në të.

Parimi i pestë: Pajtimi i muxhtehidinëve të bëhet në një gjeneratë prej gjeneratave

Thjesht: Qëllimi nuk është që të pajtohen të gjithë muxhtehidinët e umetit në të gjitha gjeneratat deri në ditën e kijametit, sepse kjo do të shpinte që kurrë të mos realizohet ixhmai, nga shkaku se nuk ka ixhmaë para ditës së kijametit, e pas ditës së kijametit nuk ka nevojë për ixhmaë. Dhe pasi që nuk është e vlefshme që të çmendurit dhe fëmijët të jenë umet, ashtu nuk lejohet që në umet të bëjnë pjesë të vdekurit apo ata të cilët nuk janë krijuar. Por, fjala umet ka për qëllim ata të cilët mund të paramendohet që të pajtohen ose të kundërshtojnë gjatë debatimit të një çështjeje prej çështjeve. E, këta janë ata të cilët prezantojnë në çdo gjeneratë. Me fjalën gjeneratë kemi për qëllim gjeneratën në të cilën janë pjesëtarët e ixhtihadit, në kohën në të cilën është paraqitur një çështje e re, e cila kërkon dispozitë të shariatit për të, dhe për atë çështje nuk themelohet ixhmaë me ata të cilët bëhen muxhtehid, pas përfundimit të asaj çështje, edhe në qoftë se muxhtehidët, të cilët e kanë aprovuar atë dispozitë, ende janë gjallë. Por, nëse muxhtehidët, në një kohë prej kohërave, pajtohen për dispozitën që

është paraqitur, ixhmai është themeluar dhe është vaxhib të pasohet që në çastin kur është aprovuar dispozita.

Skadimi i afatit të gjeneratës së muxhtehidinëve

Kjo është një çështje të cilën e kanë iniciuar dijetarët dhe për të cilën kanë dhënë mendime të ndryshme. Çështja është e skadimit të afatit të gjeneratës së pjesëtarëve të ixhmail. Kjo do të thotë: vdekja e pjesëmarrësve, e aty bëjnë pjesë të gjithë muxhtehidët, të cilët janë pajtuar dhe kanë marrë vendim për dispozitën e një çështjeje.⁸¹

A është kusht skadimi i themeluesve të ixhmail? Me fjalë tjera: A është kusht vdekja e të gjithë themeluesve të ixhmail dhe a është kusht për vlefshmërinë dhe plotësimin e tij?

Dijetarët kanë dhënë katër mendime:⁸²

Shumica absolute e dijetarëve, ku bëjnë pjesë nxënësit e Shafiijut, Ebu Hanifes, pastaj Esharitë dhe Muëtezilët thonë: Nuk është kusht skadimi i afatit të gjeneratës për t'u themeluar dhe për t'u realizuar ixhmai. Por, ixhmai themelohet që nga momenti i pajtimit të umetit dhe umeti pastaj e ka vaxhib të veprojë me të; dhe pastaj askush nuk ka të drejtë të kundërshtojë ose të tërhiqet; pastaj dispozita kalon prej kornizës së debatit dhe, nëse ndonjë muxhtehidë i ri i të njëjtës kohë, kur është themeluar ixhmai, jep mendimin ndryshe, atëherë dispozita, për të cilën janë pajtuar ixhmai i mëhershëm, është e plotfuqishme, ndërsa mendimi i atij muxhtehidi nuk merret parasysh.

Ahmed bin Hanbeli, Ebu Hasan el esh-Shariju dhe Ebu Bekri bin Fevrik thonë: Kushtëzohet skadimi i afatit të gjeneratës dhe vdekja e të gjithë kuvendarëve të ixhmail dhe, kur të skadojë afati, merr vendimin përfundimtar (final) ixhmai, të cilin pastaj nuk lejohet të kundërshtohet.

Një grup i dijetarëve thotë: Duhet bërë dallimin. Kur është fjala te ixhmai i heshtur, kushtëzohet skadimi i afatit të gjeneratës. Ky ixhmaë është kur njeri prej muxhtehidinëve e jep mendimin për dispozitën një çështje, ndërsa të tjerët heshtin dhe nuk e refuzojnë, edhe pse është bërë publike në

mes tyre. Por, nuk kushtëzohet skadimi i afatit të ixhmait deklarativ, Është ixhmai kur muxhtehidët janë pajtuar deklarativisht dhe me vepra së bashku). Të këtij mendimi janë disa Muëtizilë, Ebi Is'haku el Isfirajiniju nga Shafiijt, e po ashtu e ka përzgjedhur edhe Ahmediju.

Imami i dy Haremeve El Xhuvëniju thotë: Nëse muxhtehidët janë të prerë në dispozitën e tyre (që do të thotë mbështeten në argument të prerë), nuk kushtëzohet skadimi i afatit të gjeneratës, por nëse nuk është dispozita e prerë, pra janë mbështetur në argument të dyshimtë (mbështetja e ixhmait të Kijasit), duhet patjetër që afati kohor të zgjatet, pa marrë parasysh a kanë vdekur apo jo.

Argumentet – Shumica absolute e dijetarëve janë argumentuar me argumente, të cilët tregojnë formën e ixhmait, i argumentuar prej ajeteve dhe informatës (hadithit), e cila e ka bërë obligim ixhmain që nga momenti i pajtueshmërisë në mes të muxhtehidinëve të një gjenerate, e në të (argumentin) nuk ka diçka që paraqet kushtëzimin e skadimit të kuvendarëve të ixhmait. Kështu që, argumentet mbeten absolute (të papërcaktuara), nga shkaku se esenciale është pakushtëzimi ndërsa kushtëzimi i skadimit të afatit është argument shtesë i paarsyetuar (argumentuar).

Autori i librit “**Muslimi Thubut**” thotë: Skadimi i afatit nuk bën pjesë në të qëlluarit dhe as të domosdoshmërisë së analizës.

Gazaliu thotë: Argumentimi është në pajtueshmërinë e tyre, e jo në vdekshmërinë e tyre. Pajtueshmëria është arritur para vdekjes, e nuk e bën më të sigurt nëse i shtohet vdekja. Për këtë arsye, skadimi i afatit të një gjenerate nuk është argument për të plotëfuqizuar dispozitën e ixhmait.

Kushtëzuesit e skadimit të afatit janë të argumentuar me sa vijon:
1. –Moskushtëzimi shpie deri te moslejimi i kthimit të muxhtehidi nga ixhtihadi i tij, nëse i paraqitet atij argumenti, i cili është në kundërshtim me mendimin e ixhmait. E, pengimi i tij nuk është i drejtë.

Replika për këtë: -Neglizhimi i kuvendarëve për atë argument pas elaborimit, analizimit, hulumtimit dhe ndalimit për diçka të hamendur

vështirë se mund të ndodhë. Por, edhe po të pranohet një gjë të tillë, do të thuhet se nuk mund të ndodhë ixhmai asses, nga shkaku se do të lejohej largimi nga ixhmai pas skadimit të afatit të gjeneratës nga kuvendarët, pasi që t'u bëhet e qartë atyre çka e zhvleftëson dispozitën e mëparme, përderisa ne veç e kemi lejuar largimin nga ixhmai, edhe para se të skadojë afati i gjeneratës.

2. – Ixhmai nuk legjitimohet, përpos me përqendrimin e mendimeve, ndërsa përqendrimi i tyre nuk mund të realizohet, përpos se me skadimin e afatit të gjeneratës, përderisa para kësaj njerëzit ende janë në fazën e hulumtimit dhe analizës, dhe është e mundur që të largohet një pjesë, apo që të gjithë të tërhiqen për atë çka janë pajtuar. Argument për këtë kemi se praktikisht disa sehabë janë tërhequr pasi që veç ka ndodhur ixhmai. Kemi rastin i cili transmetohet nga Aliju, Zoti e fënikëroftë fytyrën e tij, i cili është tërhequr nga dispozita e ndalimit të blerjes së nënave të fëmijëve, kur ka thënë: Unë dhe Umeri jemi pajtuar që të mos blihen nënat e fëmijëve, mirëpo tani kam mendim tjetër. Mendoj se lejohet blerja e tyre. Ky, pra, është Aliu r.a., i cili është pajtuar me sehabet r.a. se është e ndaluar blerja e nënave të fëmijës, e pastaj është tërhequr nga ai mendim, saqë Abidetet es-Selmaniju⁸³ i ka thënë: Mendimi yt, i cili ishte sikur i xhematit, është më i pëlqyer tek ne, se sa mendimi yt i vetëm (kundrejt xhematit).

Po ashtu, Umeri është tërhequr dhe ka kundërshtuar, pasi që është pajtuar me Ebu Bekrin dhe sehabet për barazinë e ndarjes së pasurisë së luftës. Ai pastaj ka thënë: “Patjetër duhet që të bëhet dallimi në mes të luftëtarëve të parë të cilët kanë luftuar me Pejgamberin s.a.v.s. dhe atyre që më vonë e kanë pranuar islamin”. Ai po ashtu i ka vlerësuar të diturit, ata që kanë reputacion dhe që kanë qenë besimtarë të hershëm.

Gjithashtu. Umeri ka kundërshtuar ligjin për dënim të pirjes së alkoolit në katërdhjetë shkopinj, të cilin e kanë aprovuar Ebu Bekri me sehabet, duke thënë se duhet të gjykohet në tetëdhjetë.

Në lidhje me këtë replikohet se finalizimi i mendimeve arrihet pasi që të kalojë një afat i analizimeve dhe umeti të vijë në përfundim me pajtueshmëri dhe lajmërojnë se ata kanë arritur në fund pajtueshmërinë për atë çështje; kështu, kushtëzimi i skadimit të afatit është i panevojshëm.

Gazaliu thotë: Nuk lejohet të bëhet tërheqja e mendimit nga gjithë spektri i ixhmait, nga shkaku se nëse tërhiqet nga ixhmai i Umetit, atëherë ai ixhmaë është garantuar në pagabueshmëri; po mund të ndodhë tërheqja e disave prej tyre. Mirëpo, me këtë ata janë gabimtarë të mëdhenj, e gabimi mund të ndodhë prej disa njerëzve të Umetit, porse nuk lejohet prej të gjithëve.

Ndërsa, sa i përket disa fakteve të gjurmuara se tërheqja ka ndodhur, ky nuk është boshti i debatit, nga shkaku se blerja e nënave të fëmijëve nuk ka qenë në kohën e kontraktimit të ixhmait, ngaqë një pjesë e sehaveve, e prej tyre Xhabir bin Abdullahu, e edhe të tjerë, kanë pasur mendimin se lejohet blerja e tyre.

Sa i përket mendimit të Selmanijut: **“Mendimi me xhematin... deri në fund të tekstit”**, është argument se ka qenë mendim i shumicës, e jo pajtim i gjithë Umetit, nga shkaku se një pjesë e sehaveve e kanë lejuar atë.

Sa i përket mënyrës së ndarjes së pasurisë së luftës në pjesë të barabarta apo disa të dallohen, Umeri r.a. e ka kundërshtuar Ebu Bekrin në kohën e tij dhe e ka dhënë mendimin e vet, duke thënë: A po e bën të njëjtë atë i cili ka luftuar në rrugë të Allahut me veten e tij dhe me pasurinë e tij, me vullnet dhe dëshirë, me atë i cili e ka pranuar Islamin i detyruar? Atëherë Ebu Bekri r.a. iu është kundërpërgjigjur: Vërtet, ata kanë punuar për Allah dhe shpërblimi i tyre do të jetë tek Allahu; kjo botë është vetëm një pjesë e jetës, që do të thotë pjesë e jetës për të cilën të gjithë i kanë nevojat e njëjta dhe nuk ka ndonjë argument se edhe pas kësaj Umeri r.a. është tërhequr nga mendimi i tij dhe është pajtuar me mendimin e Ebu Bekrit. E, pa pajtimin e tij veç nuk ka ndodhur realizimi i ixhmait. E, kur ka ardhur çështja në dorën e tij, ai ka vepruar me mendimin e tij. Gjithashtu, për dënimin për alkool, nuk ka ndodhur realizimi (konstituimi) i ixhmait, nga shkaku se Uthmani r.a. ka ekzekutuar dënimin për alkool edhe tetëdhjetë, edhe katërdhjetë. Për këtë Aliu r.a. ka thënë: Që të dyja janë të pranueshme (sunet).⁸⁴ Kjo dëshmon se ixhmai nuk është pajtuar në katërdhjetë.

Kështu, pra, Ibn Hazmi në librin e tij **“El-ihram fi Usulit Ahkam”** e ka përkrahur mendimin e shumicës absolute nga aspekti historik. Koha e sehaveve ka zgjatur deri në vitin 103 hixhrij. Koha e tabiinëve ka zgjatur deri në vitin 180 hixhrij. Kështu që, koha e tabiinëve ka marrë pjesë edhe në

kohën e sehabeve. E, kush mund të përkufizojë ixhmain e çdo gjenerate ose që të saktësojë rrethanat për pajtimin apo për mospajtimin e tyre, pasi që dy gjeneratat përzihen në një kohë. Shumica e tabiinëve ka dhënë fetva së bashku me sehabet, si f.v: Ahkame me Mesrukun, me Shrehjin, Sulejmain, Rebian dhe me të tjerët, ata kanë vdekur në kohën e sehabeve.

Tri çështje që kanë të bëjnë me etapën e ixhmait

Këtu do t'i sqaroj tri Tema:

E para: A konsiderohet i aprovuar ixhmai i sehabeve, nëse ka kundërshtuar Tabiiju?

E dyta: A është i specifikuar Ixhmai vetëm me etapën e sehabeve? dhe

E treta: A aprovohet ixhmai nëse më herët ka pasur kundërshtime?

Tema e parë: Ixhmai i sehabeve edhe nëse kundërshton Tabiiju

Kjo temë ka të bëjë me çështjen e kushtëzimit të skadimit të kohës. **Shumica absolute**, të cilët kanë kushtëzuar skadimin e kohës, thonë: Nëse tabiiju është prej pjesëtarëve të ixhtihadit, pranohet dhe aprovohet ixhmai i sehabeve, e nëse ai kundërshton, nuk aprovohet ai ixhmaë. Por, nëse arrin gradën e ixhtihadit, pas aprovimit të ixhmait, atëherë kundërshtimi i tij nuk merret parasysh.

Disa kanë thënë: Kundërshtimi i tabiijut nuk merret parasysh në kohën (etapën) e sehabeve, pa marrë parasysh a është prej pjesëtarëve të ixhtihadit apo jo. Këtë mendim e kanë disa mutekeliminë, disa mohues të Kijasit dhe, sipas një transmetimi, nga Ahmed bin Hanbeli.⁸⁵

Unë e përkrah mendimin e shumicës absolute, nga shkaku se argumentet, të cilat dëshmojnë për ixhmain janë terme, të cilat tregojnë për garantimin e Umetit për pagabueshmëri, e ixhmai i tyre, pa tabiijun, nuk është ixhmaë i tërë Umetit, por ixhmaë i disa prej tyre; e, atëherë nuk do të ishte ixhmai i tyre argument, nga shkaku se argumentimi bazohet në ixhmain e tërësisë, e jo të pjesës.

Përpos kësaj, sehabet, së bashku me tabi'inët e kohës së tyre, kanë bërë ixhtihadë të përbashkët për ngjarjet që kanë ndodhur në kohën e tyre, si f.v: Said bin Musajebi, Sherijh el Kadi, Hasan el Basriju, Mesruku, Shaëbiju, Said bin Xhibejri e të tjerë. Po të kishte qenë mendimi i Tabiijut i pavlerë, sehabet nuk do të kishin lejuar mendimin dhe tërheqjen e mendimit të tyre. Për këtë arsye, edhe kundërshtimi i tyre merret parasysh, nga shkaku se ata janë pjesëtarët e ixhtihadit. Në fushën e ixhtihadit, sehabet nuk kanë ndonjë specifikë me të cilën dallohen. Kështu, pra, që ixhmai nuk mund të përkufizohet vetëm me sehabet. Po të kishte pasur ndikim specifika e sehabeve në këtë përkufizim, atëherë do të kishte qenë dashur të pranohet mendimi i atyre, që kanë pasur vlerë më të madhe ndaj atyre që kanë pasur vlerë më të vogël, dhe nuk do të merrej parasysh mendimi i cili ka vlerë më të vogël, nga shkaku se në mes tyre ka pasur dallime në vlera. P.sh: Do të

merrej parasysh mendimi i muhaxhirëve, e jo i sehabeve, ose do të merrej parasysh mendimi i dhjetë sehabeve të përgëzuar me xhenet,⁸⁶ e nuk do të pranohej mendimi i muhaxhirëve të tjerë, e kështu me radhë. Mirëpo, askush nuk e ka pranuar këtë mendim.

Mendimi i shumicës absolute është kundërshtuar me argumentet se: Po të merrej për bazë kundërshtimi i Tabiijut, disa sehabe nuk do të kundërshtonin mendimin e disa Tabiinëve. *Shembull:* Ajo çka rezulton prej zonjës Aishe r.a. se ajo ka nënçmuar Ali bin Selmete bin Abdurrahman bin Avfin për luftimin e sehabeve dhe diskutimet në mes tyre, ajo kritikon duke i thënë: “*Zogëzat këndojnë me gjelat*”.

Kundërpërgjigjia për këtë është se nënçmimi i saj nuk ka qenë mendim i tabiinëve, nuk merret parasysh, por është e mundur se ajo ka kritikuar, sepse e ka kundërshtuar ixhmain e mëhershëm të sehabeve, ose nga shkaku se ai nuk ka arritur nivelin e ixhtihadit, ose që ai të jetë i kujdesshëm kur të flasë për sehabet.

Tema e dytë: A përkufizohet ixhmai vetëm në kohën e sehabeve?

Shumica absolute e dijetarëve mendojnë se ixhmai i muxhtehidinëve të secilës epokë konsiderohet argument, e nuk përkufizohet vetëm me etapën e sehabeve.

Disa dijetarë, e prej tyre Dhahiriju Ibn Hazmi, Ibn Habani, dhe sipas një transmetimi nga Ahmed bin Hanbeli, mendojnë se nuk ka ixhmaë përpos ixhmait të sehabeve. Për këtë ata janë argumentuar se ixhmai është i varur në kohë, e sehabet janë ata të cilët kanë qëndruar pranë Pejgamberit s.a.v.s.

Ata, po ashtu, janë argumentuar me librat bazë të gjurmuara nga thënia e Muhamedit s.a.v.s.: *“Sehabet e mi janë si yjet; nëse mbështeteni në çdonjërin prej tyre, do të jeni të udhëzuar.”*

Sa i përket argumenti të parë, replikohet në këtë mënyrë: Edhe pse sehabet kanë qëndruar me Pejgamberin s.a.v.s., ai prezentim ka kaluar te të tjerët pas tyre, kështu që në dispozitë edhe ata të tjerët janë sikurse të kishin prezantuar.⁸⁷

Sa i përket argumentit të dytë, replikohet në atë se ka dobësi të madhe nga aspekti i transmetimit, këtë e kanë deklaruar dijetarët e hadithit, si: Buhariju, Ibli Muijni dhe Ibni Adiju.⁸⁸ Po edhe nëse supozojmë se hadithi është autentik, hadithi nuk tregon se nuk bëhet mbështetja te të tjerët, pos tyre, përpos nëse e kemi parasysh të kuptuarit e kundërt të cilësisë; mirëpo as të kuptuarit e kundërt nuk është argument, e mos të flasim për të kuptuarin e kundërt të cilësisë. Hadithi dëshmon vërtetësinë dhe saktësinë e sehabeve, mirëpo nuk mohon vërtetësinë dhe saktësinë e të tjerëve. E, ku ekziston, pra, ai argument që përkufizon vetëm ixhmain e sehabeve.

Gazaliu thotë: Argumentet të cilët dëshmojnë për ixhmain si argument nga Kur’ani, suneti dhe nga argumenti logjik nuk bëjnë dallimin e ixhmait të një etape nga një etapë tjetër. Nëse tabi’inët unifikohen, ai unifikim është

ixhmaë i tërë umetit dhe kush i kundërshton, ai është lakuar nga rruga e besimit.

Zotin i Lartmadhëruar thotë: **“Ai veç ka pasuar rrugën e pabesimtarëve.”** (en-Nisa, 115), po ashtu, **“Ju jeni umeti më i zgjedhur.”**(Ali Imran : 110), i nxjerrë për njerëzimin janë ata që kanë qenë në kohën e Pejgamberit s.a.v.s., e ligjërimi nuk përfshin të tjerët; dhe lajmërimi në sunet për pagabueshmërinë e umetit është posaçërisht për sehabet që kanë qenë në kohën e Pejgamberit s.a.v.s.

Kundërpërgjigjia në këtë është se ata të cilët thonë se nuk themelohet (konstituohet) ixhmai i sehaveve pas vdekjes së atyre që kanë qenë në momentet kur kanë zbritur ajete, nga shkaku se ixhmai i tyre nuk është ixhmaë i të gjithëve, të cilëve iu orientohet në momentet kur kanë zbritur këto ajete. Po ashtu, nuk llogaritet mospajtimi i atyre të cilët e kanë pranuar islamin, pasi që veç kanë zbritur këto ajete, nga shkaku se këta nuk i përfshin ligjërimi i këtyre ajeteve, por është ixhmaë kush ka mbetur prej sehaveve pas Pejgamberit s.a.v.s., e ky ixhmaë është argument për të cilin të gjithë janë pajtuar. Sa e sa sehave kanë rënë dëshmorë në kohën e Pejgamberit s.a.v.s., pas zbritjes së këtyre ajeteve dhe kush ka vdekur ose ka rënë dëshmor, bën pjesë në titullimin e **“besimtarëve dhe të umetit”** në këto ajete.

Bazuar në këtë: Vërtet, ata të cilët kanë kaluar dhe kanë vdekur, vdekja e tyre nuk është pengesë për t’u arritur ixhmai (edhe me mendimin) edhe me ta, po ashtu, edhe ata që vijnë pas tyre nuk janë pengesë, që edhe me ata të arrihet ixhmai, nga shkaku se atributi **“Umet”**, me të gjitha njësitë, arrihet me të gjithë ata që gjenden në çdo kohë.

Pretendimi se **“ixhmai”** është i përkufizuar vetëm me sehabet, është specifikimi i pavend, nga shkaku se argumente, të cilat tregojnë për ixhmain si argument, siç thotë Gazaliu, nuk bëjnë dallimin e një gjenerate ndaj ndonjë gjenerate tjetër, por që, kur të thuhet, përfshin pjesëtarët e çdo gjenerate, ashtu si i përfshin pjesëtarët e gjeneratës së sehaveve.⁸⁹ Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: **“Gjithmonë do të ketë prej umetit tim që do ta mbrojnë të vërtetën, nuk i dëmton kundërshtimi i atyre që i kundërshtojnë deri sa mos të vijë urdhëri i Allahut që të realizohet dhe të zbatohet”.**⁹⁰

Tema e tretë: A kushtëzohet ixhmai, që paraprakisht të mos ketë pasur kundërshtim?

Kjo çështje mund të paramendohet kështu: Nëse dijetarët e një gjenerate ndahen në dy mendime dhe ajo gjeneratë përfundon në ato dy mendime dhe askush nuk i kritikon ata për ato dy mendime, a mundet pastaj të pretendohet që pas tyre të themelohet ixhmai në njërin prej atyre dy mendimeve, ashtu që muxhtehidi të mos shkojë në mendimin e tjetrit apo jo.

Muëtezilët, shumica e Hanefijve, shumica e nxënësve të Shafiiut mendojnë se: Lejohet ixhmai në njërin prej atyre dy mendimeve, nga shkaku se argumentet që dëshmojnë se ixhmai është argument i sheriatit, nuk bëjnë dallimin në mes të asaj se a ka ndodhur ixhmai më parë për atë çështje apo nuk ka ndodhur.

Ebu Bekri Sajrafiju, Gazaliu prej drejtimit Shafii, Ebu Hasen esh-Shariju, Ahmed bin Hanbeli, Imami i dy Haremeve, Ahmediju dhe një grup i Usulijinëve mendojnë se: Nuk lejohet të themelohet ixhmai në njërin prej atyre dy mendimeve dhe thonë se kushtëzohet që të ixhmai të mos ketë pasur kundërshtim paraprak (në të kaluarën).⁹¹

Në rend të parë, ata janë argumentuar kështu: Ai i cili prej gjeneratës vdes, mendimi i tij mbetet, sepse mendimi i tij nuk vdes me vdekjen e tij, se mendimi qëndron në momentin e gjeneratës së mëvonshme: atëherë nëse mendimi i tij është në kundërshtim me atë që janë dakorduar gjenerata e mëvonshme, ai ixhmai nuk mund të themelohet (institucionalizohet), nga shkaku se ajo që kërkohet është ixhmai i tërë umetit.

Ky argument është replikuar kështu: Nuk merret parasysh mendimi i gjeneratës së mëparshme, nëse muxhtehidët e mëvonshëm dakordohen në kundërshtim me mendimin e një të vdekuri të mëparshëm, nga shkaku se qëllimi i ixhmail të umetit është ixhmai i muxhtehidinëve, të cilët janë gjallë. Ndërsa, mendimi i atij i cili ka vdekur e nuk është në pajtim me ixhmain, nuk e dëmton ixhmain, nga shkaku se ekzistimi i ixhmail pas tij konsiderohet fuqizim i mendimit të tij, pasi që mendimi i tij ekziston si

element në të cilën bazohet ixhmai, e ndoshta ajo bazë si element në tavolinë, e po t'i shihte i vdekuri në atë tavolinë, do të ndryshonte nga mendimi i tij para vdekjes: e atëherë llogaritet sikurse ai e ka vlerësuar mendimin e tij dhe nuk do kishte ndikim në themelimin e ixhmait të të gjallëve.

Në rend të dytë argumentohen me atë se: Zakonisht ixhmai i muxhtehidinëve nuk arrihet me kundërshtimin e të mëparshmëve, nga shkaku se natyrshmëria kërkon që të mbahet në mendimet fetare, e posaçërisht pas gjeneratës së tabiinëve, dhe atëherë nuk mund të bëhet përputhshmëria e të mëvonshmëve dhe e rastit që e përmendëm.

Po ashtu, edhe ky mendim është replikuar kështu: Sehabet nuk janë pajtuar për blerjen e nënave të fëmijëve, mirëpo tabi'inët janë dakorduar për atë se nuk lejohet blerja e tyre.⁹² Mirëpo, shihet se nuk është arritur ixhmai i tabiinëve, sepse Sarhasiu në librin e tij **“Mebsut”** përmend se për blerjen e nënave nuk është arritur, përpos kësaj: Shiitët dhe Dhahirijët⁹³ thonë mendimin e Alijut, Zoti e fisnikëroftë atë, se lejohet blerja e tyre. Duke pasur parasysh se ky debat nuk ka rezultuar diçka të veçantë, atëherë padyshim se ixhmai i realizuar nga Umeti, e nëse para atij ixhmai gjenerata e mëhershme ka pasur mendim ndryshe, konsiderohet rrugë e besimtarëve, e cila është vaxhib të pasohet. Për këtë arsye, preferoj mendimin se: lejohet ixhmai, përkundër asaj se para atij ixhmai ka pasur mendim ndryshe në ndonjë çështje. Argument për këtë është se: Sehabet janë dakorduar se është i ndaluar kurorëzimi i përkohshëm, pasi që më herët për atë çështje kanë dhënë mendime të ndryshme. Ibn Abasi ka dhënë fetva se lejohet, mirëpo më vonë është tërhequr nga ai mendim dhe ka dhënë mendim për ndalimin e atij lloji të kurorëzimit, pra sikurse kanë dhënë mendim shumica absolute e sehabeve.⁹⁴ Mirëpo, nëse kurorëzimi i përkohshëm (mut'a) ende vazhdon të jetë i lejuar te Shiijtët, e ato janë pjesë e ixhmait, se si mund të jetë ixhmaë për të, për këtë arsye pa marrë parasysh a sjellin shembuj për të cilët shembuj ka ndodhur ixhmai, pasi që veç më herët ka ndodhur mospajtimi apo veç nuk ka qenë ixhmaë i vlefshëm. Unë për këtë mënyrë takoj argumente të cilat tregojnë argumentimin e ixhmait pa qenë i kushtëzuar në atë se ka pasur apo nuk ka pasur mospajtim të mëhershëm. Në të takoj argumentimin më të fuqishëm, i cili dëshmon dhe vërteton mendimin e atyre, të cilët deklarojnë për lejimin e themelimit të ixhmait për çështje për të cilat ka ndodhur mospajtimi.

Parimi i gjashtë: Dakordimi për dispozitë të sheriatit

Fusha analitike e ixhmati është posaçërisht për çështje fetare ose të çështjeve të sheriatit, si f.v. lejimi i shitblerjes. Ndërsa, sa i përket dakordimit për rregullat gjuhësore, si f.v: pjesëza “fau” e pasimit, apo çështjeve logjike, si f.v: gjithësia është krijuar, apo çështjeve të jetës, si f.v: idetë për luftë, planifikimi i çështjeve të kujdestarisë e të ngjashme, si f.v: çështjet zakonore (tradicionale), të cilat nuk kanë të bëjnë me obligimet e njeriut, nga aspekti e ata janë të obliguar: dakordimi për këto çështje nuk është ixhmai i sheriatit.⁹⁵

Në librin “Burhan” Imam Haremejni thotë: Ixhmai në çështje logjike nuk ka ndonjë ndikim, sepse pajtimi i atyre çështjeve është me argument logjik.

Disa dijetarë, si Raziu, Amediu, Esneviju, Kemal bin Hemami, dhe Shefkaniju mendojnë se: Ixhmai themelohet në të gjitha çështjet e mëparme, saqë është obligative të pasohet mendimi i muxhtehidinëve në çështje të luftës e të tjera. Nëse dakordimi është bërë prej ekspertëve të ixhtihadit dhe të drejtëve,⁹⁶ unë nuk mendoj kështu, nga shkaku se fjala është për ixhmain, i cili llogaritet argument i sheriatit dhe ai, i cili nuk e pason, bën mëkat. E, ky është kuptimi: Obligimi i pasimit të ixhmait.

Shtylla e Ixhmait

Nga sqarimi i definicionit të ixhmait bëhet e qartë se shtylla e ixhmait është dakordimi i muxhtehidinëve dhe nëse dakordimi nuk arrihet prej tyre, nuk ka ixhmaë. Ndërsa, sa i përket çështjes së dakordimit, i cili arrihet pas vdekjes së Muhamedit s.a.v.s. dhe në një gjeneratë prej gjeneratave për një dispozitë të sheriatit, është kusht i domosdoshëm për të ardhur deri te pajtimi.

Po ashtu, çështja, që muxhtehidinët të jenë prej umetit të Muhamedit s.a.v.s., është kusht i muxhtehidinëve, e nuk është shtyllë në vete.

Disa shkrimtarë⁹⁷ kanë përmendur katër shtylla të ixhmait, e ato janë:

E para: Që pajtimi i cili ndodh, të jetë prej një numri të caktuar të muxhtehidinëve për atë çështje.

Ixhmai nuk mund të konstituohet vetëm prej një muxhtehidi.

E dyta: Që pajtimi të jetë i të gjithë muxhtehidinëve për atë dispozitë; nëse pajtohen shumica prej tyre, nuk mund të realizohet ixhmai, sado që të jetë shumë i paktë numri i kundërshtarëve, ndërsa numër shumë i madh i dakorduesve.

E treta: Që të realizohet dakordimi i të gjithë muxhtehidinëve muslimanë nga të gjitha vendet islame në momentin e ndodhisë. Nuk mund të themelohet ixhmai vetëm nga një vend apo rajon, si p.sh: vetëm nga dy vendet e shenjta (Meka dhe Medina) ose vetëm prej hixhazit, ose vetëm prej Irakut, ose vetëm prej familjes së Muhamedit s.a.v.s., ose vetëm prej Ehli sunetit, e jo të muxhtehidinëve shiit.

E katërta: Që dakordimi të jetë kur secili prej muxhtehidëve të paraqesë mendimin e tij qartë në praktikë, pa marrë parasysh se atë mendim a e paraqet me fjalë, me vepër apo e paraqet mendimin e pajtueshmërisë së të gjithëve.

Disa prej shkrimtarëve (autorëve të librave) në vend të shtyllës së tretë përmendin që dakordimi të jetë për dispozitë të sheriatit, përderisa sa i përket dakordimit gjuhësor apo historik, nuk është burim prej burimeve të sheriatit. Vërehet se këto shtylla nuk janë asgjë tjetër, përveçse kushte dhe parime në realizimin e dakordimit, i cili në realitet është shtylla e ixhmait.

Tema e dytë: Argumentimi i ixhmait, apo dispozita e ixhmait

Dispozita e një çështjeje është gjurmë permanente. Dispozita dispozitohet pasi që t'i plotësojë shtyllat dhe kushtet. Ky është qëllimi për argumentimin e ixhmait. Kur të themelohet ixhmai për një ngjarje për të ditur dispozitat e saj në shariat, atëherë ajo dispozitë është argument i prerë dhe bëhet obligueshmëri të veprohet me të dhe ndalohej (bëhet haram) të kundërshtohet dhe gjykohej si pabesimtar ai i cili e kundërshton bazën e ixhmait. Pra, nëse supozohet që dikush të thotë: Ixhmai nuk është argument dhe çështja e muxhtehidit është dispozitë e prerë, pas kësaj nuk ka nevojë të polemizohet për atë çështje dhe nuk lejohet që muxhtehidët e gjeneratave të tjera që atë çështje ta ridebatojnë, nga shkaku se dispozita e dispozituar prej ixhmait është dispozitë e shariatit e prerë dhe nuk lë hapësirë të kundërshtohet, e as të shfuqizohet; dhe nuk i lë vend asnjë çështjeje ta kontestojë prej argumenteve jo të prera,⁹⁸ nga shkaku se ixhmai zë vendin e tretë pas Kur'anit dhe sunetit. Rezultati i ixhmait është ngritja e dispozitës nga niveli i dyshimtë në nivelin e sigurt. Për këtë nuk pranohet kundërshtimi, nga shkaku se nuk ka ndikim në ixhmain, nëse gjendet ndonjë mbështetje, sepse argumentimi është në mbështetje, e jo në ixhmaë. E, ixhmai është argument i përforcuar; e, atëherë do të ndodhte që grada e dyshimtë të zbrësë gradën e sigurt.

Nëse argumenti është i mbështetur në hadithin e vetmuar e të dyshimtë, çështja është se ajo kalon nëpërmjet ixhmait, se ajo merr kuptimin e sigurt.

Kështu pra: **Dispozita e ixhmait është:** vërtetimi i qëllimit në mënyrë të sigurt, që të jetë obligative ajo dispozitë sikurse Kur'ani dhe suneti. Ky është deklarimi i përgjithshëm i muslimanëve dhe i shumicës absolute të dijetarëve.⁹⁹ Mirëpo, pasi që argumenti i ixhmait është i prerë, ixhmai nuk është argument i pavarur, por i përforcuar me argument. E, nëse argumenti i ixhmait është i dyshimtë, ai argument është i pavarur, që do të thotë mjafton argumentimi me të dhe nuk ka nevojë që të kthehet në argumentin e mbështetur, nga shkaku se është themeluar në vetvete dispozitë e shariatit, ngaqë ligjvënja ë të vërtetës është burim i shariatit, siç është e ditur.

Nidhamijt,¹⁰⁰ Shiitët dhe Havarixhët mendojnë se ixhmai nuk është argument.¹⁰¹

Sa i përketë Nidhamijëve, siç kemi cekur më herët, nuk e komentojnë ixhmain si dakordim të muxhtehidinëve, por ata thonë: Ixhmaë është çdo mendim i cili jepet me argumentim. Kjo do të thotë se ixhmai për të cilën mendojnë shumica absolute e dijetarëve është e mundur, por shumë vështirë mund të arrihet deri aty.

Sa i përket Shiitëve,¹⁰² ata mendojnë se ixhmai është argument jo nga forma e saj se është ixhmaë, por nga shkaku se brenda ixhmait është mendimi i Imamit të pagabueshëm. Dhe kur ta shohin se imami veç nuk është, atëherë në esencë nuk ka ixhmaë.

Sa i përket Havarixhëve, ata mendojnë se Ixhmai i Sehaveve është argument deri sa ka ndodhur përçarja në mes tyre, ndërsa për pas përçarjes së tyre; ixhmaë është ixhmai i grupit të tyre, e jo i tjerëve, nga shkaku se çështja është thënia (mendimi) e besimtarëve, ndërsa te ta besimtar është vetëm ai i cili i takon medhhebit të tyre.

Argumentet e shumicës absolute: Shumica absolute e dijetarëve paraqesin argumentet e tyre për ixhmain nga Kur'ani dhe suneti, ndërsa ai i cili është argumentuar logjikisht për argumentimin e tij, argumentimi i tij është i dobët. Ata thonë: Numri i shumtë, të cilët janë të çdo gjenerate që, kur të dakordohen për dispozitën e një çështjeje dhe marrin vendim të prerë, natyrshmëria parasheh që të ngjashëm të kenë qëllim për rrenë, dhe që të marrin vendim të prerë për rrenë, pa pasur mbështetje në argument të prerë, ashtu që asnjërit prej tyre mos ta hetojë gabimin për të prerë në atë që nuk është e prerë. Dobësia e këtij argumenti është se shkaku se numër i shumtë, edhe pse logjikisht është larg mendjes, që të dakordohen për rrenë, ndërsa nuk është larg mendjes që të dakordohen për gabim, siç është rasti kur pabesimtarët janë dakorduar që të mos e pranojnë Muhamedin s.a.v.s. për pejgamber.

Po ashtu, nuk është e drejtë të argumentohet për themelimin e ixhmait me ixhmaë, si f.v: thënia: Ata janë dakorduar që të shpallin gabim mendimin e kundërt të ixhmait, sepse kjo do të na sillte në rotacion. E, vendosmëria e diçkaje për veten e tij është e papranueshme.

Po ashtu, për ixhmaë nuk lejohet të argumentohet as me Kijasë, sepse, siç e dimë, kijasi është argument i dyshimtë, ndërsa e dyshimta nuk mund të argumenton për të sigurtën.

Atëherë nuk na mbetet me asgjë tjetër për të argumentuarit për ixhmaë pos me Kur'an dhe me sunet.¹⁰³

Argumentimi me Kur'an:

Janë argumentuar me pesë ajete:

Ajeti i parë:

وَكَذَلِكَ جَعَلْنَاكُمْ أُمَّةً وَسَطًا

“Dhe kështu, Ne juve ju kemi bërë popull mesatar, që të jeni dëshmitarë para njerëzve.” (el-Bekare, 143)

“E mesmja e çdo çështjeje janë të zgjedhurit” (më të mirët). Kështu, pra, Zoti i Lartmadhëruar ka lajmëruar për më të zgjedhurit e këtij umeti. Dhe, nëse tregojnë diçka të ndaluar, ata janë cilësuar si më të zgjedhurit dhe kështu mendimi i tyre është argument.

Ajeti i dytë:

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

كُنْتُمْ خَيْرَ أُمَّةٍ أُخْرِجَتْ لِلنَّاسِ

“Ju jeni populli më i zgjedhur, i nxjerrë për njerëzit.” (Ali Imran, 110)

Ajeti i tretë:

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

وَمِمَّنْ خَلَقْنَا أُمَّةً يَهْدُونَ بِالْحَقِّ وَبِهِ يَعْدِلُونَ

“Dhe ka prej tyre që i kemi krijuar umet, të cilët udhëzojnë për drejtësi dhe nga padrejtësia largojnë.” (El-Earaf, 181)

Ajeti i katërt:

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

وَاَعْتَصِمُوا بِحَبْلِ اللَّهِ جَمِيعًا وَلَا تَفَرَّقُوا

“Dhe mbahuni për litarin (librin) e Allahut të gjithë së bashku dhe mos u përçani.” (Ali Imran : 103)

Ajeti i pestë:

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

وَمَا اخْتَلَفْتُمْ فِيهِ مِنْ شَيْءٍ فَحُكْمُهُ إِلَى اللَّهِ

“Dhe në atë për të cilën diçka keni kundërshtuar mes vete, vendimi i asaj çështjeje është tek Allahu.” (esh-Shura, 10)

Kjo nënkupton se në atë çka jemi pajtuar është e drejtë. Mirëpo, në këto ajete ka alternativa, të cilat nuk i japin tekstit kuptim të dakordimit të muxhtehidinëve për dispozita, e kur ka shumë alternativa, atëherë argumentimi nuk është i plotë.

Gazaliu thotë: Të gjitha këto janë çështje të cilat nuk nënvizojnë për qëllimin, bile nuk tregojnë as për argumentimin e atyre çështjeve për ixhmaë. Dhe, më e fuqishmja është thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

وَمَنْ يُشَاقِقِ الرَّسُولَ مِنْ بَعْدِ مَا تَبَيَّنَ لَهُ الْهُدَىٰ وَيَتَّبِعْ غَيْرَ سَبِيلِ
الْمُؤْمِنِينَ نُوَلِّهِ مَا تَوَلَّىٰ وَنُصْلِهِ جَهَنَّمَ ۖ وَسَاءَتْ مَصِيرًا

“Kush kundërshton Allahun, pasi që i është sqaruar udhëzimi, dhe ndjek rrugën e jobesimtarëve, ne e orientojmë andej kah është nisur, dhe do ta përcëllojmë me zjarrin e xhehenemit. E, sa vendbanim i keq është ai”¹⁰⁴ (En-Nisa : 115)

Në librin risale, Shafiiu me këtë ajet argumentohet për argumentin e ixhmait. Ajeti tregon se: Allahu ka bërë që pasimi i rrugës së jobesimtarëve është njësoj si mosdëgjueshmëria ndaj Allahut dhe të dërguarit të Tij, pasi që për të dy rastet ka paraparë dënim të njëjlojtë. E, ai dënim është kërcënim i ashpër, pasi që Allahu ka thënë: **“Do ta bashkojmë me atë që ka pasuar**

(është bashkuar) dhe do ta hedhim atë në xhehenem.” E, pasi që mosdëgjueshmëria ndaj Allahut dhe të dërguarit të tij është haram, atëherë pasimi i rrugës së jobesimtarëve është haram, sepse, poqëse nuk do të kishte qenë haram, nuk do të kishte qenë kërcënimi i njëjtë për haram në të dy rastet, nga shkaku se nuk është mirë që kërcënimi të jetë i njëjtë edhe për hallallin, edhe për haramin. Që, p.sh, të thuhet: Nëse bën prostitucion dhe pi ujë, do të të dënojë. E, kur të ndalohet pasimi i jorrugës së tyre, atëherë pasimi i rrugës së tyre është obligative, nga shkaku se nuk ka asgjë në mes tyre; nga shkaku se pasimi i tyre është obligativ atëherë vjen në pyetje se ixhmai është argument. Dhe se: rruga e një individi është ajo që ai e zgjedh ose me fjalë, ose me vepër, ose me bindje.

Ky argumentim i shumicës absolute të dijetarëve me këtë ajet është replikuar prej këndeve të ndryshme:

Sa i përket kuptimit të ajetit: ajeti ka të bëjë me atë se kush armiqëson të dërguarin dhe lufton kundër tij, si dhe pason rrugën e jobesimtarëve, duke ecur paralel me pabesimtarët, duke iu ndihmuar atyre dhe duke i mënjeluar armiqtë prej tyre, do ta shoqërojmë me atë që është shoqëruar. Kjo do të thotë se muslimanit nuk i mjafton që, sa i përket asaj, të veprojë me muslimanët, e në anën tjetër të ketë qëndrim negativ, duke kundërshtuar të dërguarin, por ai patjetër duhet të jetë pozitiv; që angazhimi i tij t'i bashkëngjitet angazhimit të besimtarëve dhe të pasojë rrugën e tyre, duke ndihmuar pejgamberin, dhe të ecën rrugën që ai ka lënë, duke iu ndaluar çështjeve që ai ndalon dhe duke vepruar atë që ai urdhëron.

Gazaliu thotë: Kjo është çështje që qartë kuptohet prej ajetit. Edhe po mos të kishte kuptim të qartë, është e mundur të ketë po këtë kuptim.¹⁰⁵ E, kur argumenti në vete ka dy alternativa, bie argumentimi me të. Nuk lejohet që ajeti të jetë argument për ixhmain, nga shkaku se të gjithë janë të pajtimit se argumentet që nuk janë të sigurta, me ato argumente nuk merret vendim, sepse ixhmai është argument i prerë, nga shkaku se nuk përcaktohet se “rruga e besimtarëve” në ajet ka për qëllim ixhmain e tyre, nga shkaku se: ka mundësi që qëllimi me fjalën **“rrugën e tyre”** është pasimi i Pejgamberit s.a.v.s, ose ndihma ndaj tij, ose mbështetja në të, ose në atë që shkojnë besimtarët, pra besimi i tyre. E, kur të ketë alternativa, nuk plotësohet argumentimi.

Kështu, pra, disa usulijinë, kur janë argumentuar për ixhmain me ajetin **“O ju, të cilët keni besuar, dëgjoni Allahun dhe të dërguarin dhe**

udhëheqësit e zgjedhur prej juve.” (en-Nisa : 59) ata janë argumentuar në atë mënyrë duke thënë se: Siç ka urdhëruar Allahu për dëgjimin ndaj Tij, dhe për dëgjimin ndaj të dërguarit të Tij, ka urdhëruar për dëgjimin e udhëheqësve të zgjedhur prej umetit. E, udhëheqësit në politikë dhe qeverisje janë qeveritarët, ndërsa udhëheqësit me ixhtihadë dhe fetva janë muxhtehidinët. Ibn Abasi, fjalën “ulul emri” prijësit i ka interpretuar se janë dijetarët. Ai udhëheqësit dhe qeveritarët i ka interpretuar në rend të dytë. Pjesa sipërfaqësore e interpretimit përfshin të gjithë ata të cilët duhet të dëgjohen, çdo grup, i cili përfshihet në dëgjueshmëri. Këtë e pohon ajeti, ku Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Dhe nëse kthehen te i dërguari dhe udhëheqësit prej tyre, do t’i mësonte ata, të cilët aprovojnë prej tyre.” (en-Nisa : 83)** Sipas përcaktimit tim, ende është i hapur opcioni dhe i qëndrueshëm në ajetin e lartpërmendur se “ulul emri” janë muxhtehidët, sepse lejohet alternativa që qëllimi të jetë për udhëheqësit, edhe nëse nuk janë dijetarë, e jo të jetë qëllimi vetëm për muxhtehidët.

Argumentimi me sunet:

Siç tregon Gazaliu:¹⁰⁶Suneti është argument prej argumentimeve më të fuqishme për ixhmain, nga shkaku se ekzistojnë shumë hadithe të Pejgamberit s.a.v.s., të cilët tregojnë pagabueshmërinë e umetit. Kjo është përhapur shumë prej një grupi shumë të besueshëm dhe të njohur të sehaveve, si f.v. prej Umerit, Ibn Mes’sudit, Ebi Seid Hudrijut, Enes bin Malikut Ibni Umerit, Ebi Hurejres, Hudhejfete bin Jemanës e të tjerë me radhë, e që, nëse i përmendim, numri i tyre është shumë i madh në hadithe të shumënumrta, me tekste të ndryshme, edhe pse aty këtu ka hadithe të vetmuara, të cilët nuk e kanë arritur shkallën e lartë (mutevatir). Mirëpo, në mes të atyre haditheve të shumënumërta ka një çështje të përbashkët, e ajo çështje është pagabueshmëria e umetit. E, kjo është mutevatir, pasi që ekzistojnë informata të shumta të njëjta. Kësaj i thuhet mutevatir kuptimor, e mutevatiri kuptimor është i njëjtë me mutevatirin tekstual, pasi që të dyja tregojnë për të njëjtën çështje.

Këto hadithe janë:

“Umeti im nuk unifikohet në gabim”.¹⁰⁷

“Umeti im nuk unifikohet në humbje”.¹⁰⁸

“Kam kërkuar nga Zoti i Lartmadhëruar që umeti im të mos unifikohet në humbje dhe më është përgjigjur pozitivisht.”¹⁰⁹

“Allahu nuk e bashkon umetin tim për në humbje.” E në një transmetim tjetër ***“dhe as në gabim”.***

“Dora (ndihma) e Allahut është në xhematë”.¹¹⁰

“Allahu nuk brengoset për atë që ndodhet dhe mbetet i vetmuar”.¹¹¹

“Ai i cili një pëllëmbë largohet nga xhemati, ai është zhveshur nga petku i Islamit”.¹¹²

“Kush dëshiron të jetë në mes të xhenetit, le t’i përmbahet xhematit, sepse lutja e tyre është lutje edhe për të.”¹¹³

“Shejtani është më afër me njeriun e vetmuar, e nga dy njerëz të vetmuar është më larg.”¹¹⁴

“Vazhdimisht do të jetë një grup i umetit tim në drejtësi, do të jenë të ndihmuar dhe nuk mund t’i dëmtojë kush i kundërshton”.¹¹⁵ E ka rexhistruar Buhariu, Muslimi dhe Ibni Abasi.

“Kush i largohet xhematit një pëllëmbë dhe vdes, ai ka vdekur si në kohën e injorancës”.

“Atë që muslimanët e shohin të mirë, tek Allahu është e mirë.”¹¹⁶

Ka edhe shumë hadithe të tjera të cilat përputhen në këtë kuptim,¹¹⁷ e ai kuptim është ***“pagabueshmëria e umetit”.*** E, klasifikimi se janë hadithe të

një transmetimi, nuk është pengesë që të sistemohen në tregueshmëri të sigurt në përgjithësi. Ne veç dimë pastërtinë e Hatem Taijut, trimërinë e Aliut, autetincitetin e katër imamëve, animin e Aishes r.a. për të Dërguarin s.a.v.s, e hadithet njëtransmetuese, e që ato pastaj janë ngritur në gradën e haditheve mutevatir.

Sa i përket argumentimit me këto hadithe, kundërpërgjigja është se: “Është e mundur që fjala “gabim” dhe “humbje” ka për qëllim sigurimin e umetit nga mëkati i pabesimit. Ky interpretim është i dyshimtë. Sa i përket transmetimit “në gabim”, nuk ka arritur gradën e mutevatirit, por edhe rangohet në atë shkallë. Kjo fjalë ka kuptim të përgjithshëm, e që mund të ketë kuptimin e pabesimit dhe është e mundur të ketë kuptimin e sigurimit të umetit që të mos gabojë në dëshminë e shehadetit në botën tjetër, ose ajo çka është e përshtatshme me tekstin mutevatir, ose me argumentin logjik, pa hyrë në ixhtihadë.

Kundërpërgjigja ndaj kësaj replike është se “humbja” gjuhësisht nuk është në përputhshmëri me pabesimin. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **“Dhe të ka gjetur ty në humbje dhe të ka udhëzuar.”**(ed-Duha : 7) Zoti i Lartmadhëruar, duke treguar ngjarjen e Musa a.s., thotë se Musa a.s. ka thënë: **“Unë kam vepruar ashtu atëherë dhe unë kam qenë prej të humburve.”** (esh-Shuara, 20) do të thotë prej mëkatarëve, e jo prej pabesimtarëve. Thuhet: “E ka humbur njeriu rrugën dhe ka humbur aktiviteti i filanit”, që do të thotë ka gabuar.

Këtë e vërteton edhe ajo se sehabet dhe të tjerët prej këtyre haditheve thjesht e kanë kuptuar se qëllimi dhe pikësynimi është “ngritja e vlerës së muslimanëve dhe siguri i tyre për të mos gabuar.”¹¹⁸ Pasi që këto hadithe janë transmetuar për të treguar madhështinë e këtij umeti në fushën, në të cilën janë dhënë të gjitha begatitë, dhe për këtë arsye duhet t’i jepet kuptimi në çka janë të specifikuar dhe që dallohet nga umetet tjera të njerëzimit. E, kuptimi i vërtetë është se siguri i umetit në krahasim me ndonjë umet tjetër që të mos gabojë, të mos harrojë, të mos rrejë e të ngjashme, e nuk është e drejtë t’i jepet kuptimi se umeti është i mbrojtur nga pabesimi, nga shkaku se shumë prej muslimanëve kanë vdekur dhe kanë qenë të siguruar nga pabesimi; kështu që nuk kemi të bëjmë me specifikimin e këtij umeti me këtë çështje. Po të kishte qenë specifikimi i umetit vetëm për çështjen e pabesimit, posaçërisht nga vetë fakti se këto hadithe janë thënë për t’iu

përgjigjur thirrjes dhe për të pasuar këtë umet, dhe kërcënimin për ata që e kundërshtojnë. E mundet që qëllimi të përkufizohet edhe për të gjitha llojet e gabimeve tjera.

Përfundimi i kundërpërgjigjes së kësaj kundërpërgjigje: Vetë gjuha arabe jep mundësinë që të kuptohet qëllimi i lartësimit të umetit me këto hadithe dhe domosdoshmëria që t'i jepet kuptim shtesë dhe specifika se individët (rastet e izoluara) nuk mund të marrin pjesë në formimin e umetit si të tillë dhe kur të shikohet me kujdes, sepse janë thënë të gjitha këto hadithe. Të gjitha këto na bëjnë të qartë se qëllimi është: sigurimi i umetit që të mos gabojë në ixhtihadë dhe në çështje të fesë.

Me një fjalë: Dijetarët e umetit Islam, shekuj me radhë, kanë deklaruar se ixhmai është argument i prerë, saqë fukahatë e çdo gjenerate kanë mohuar tërësisht ata të cilët kanë kundërshtuar muxhtehidët e gjeneratës së mëhershme. Zakonisht është e pamundur, edhe pse ndryshojnë dëshirat dhe ekzistojnë llojlloj mendimesh për të pranuar dhe refuzuar. Pajtureshmëria bazohet me argument jo të sigurt, mirëpo patjetër te ta duhet të ekzistojë argumenti i prerë për t'u mbështetur në të. Këto hadithe të Pejgamberit s.a.v.s. konsiderohen argumente të prera, për t'u argumentuar me to se ixhmai me të cilin gjykohet është ixhmai i bazuar në librin e Allahut dhe sunetet mutevatir.

Argumentet e mohuesve të ixhmait

Mohuesit e ixhmait, ku bëjnë pjesë Ibrahim Nidhami,¹¹⁹ Kashashiju prej Muëtezilëve, Havarixhët dhe shumica e Rafidëve, deklarojnë se:

Ixhmai është i pamundur, edhe po ta pranoni, njohuria për ndodhjen e ixhmait është i pamundur, edhe po të ndodhte, transmetimi deri tek ne do të ishte i pamundur. Këta argumentohen si në vijim:¹²⁰

E para. Kur'ani: Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ وَأُولِي الْأَمْرِ مِنْكُمْ ۖ
فَإِنْ تَنَازَعْتُمْ فِي شَيْءٍ فَرُدُّوهُ إِلَى اللَّهِ وَالرَّسُولِ إِنْ كُنْتُمْ تُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ
الْآخِرِ ۚ ذَٰلِكَ خَيْرٌ وَأَحْسَنُ تَأْوِيلًا

“O ju, të cilët keni besuar, dëgjonie Allahun dhe dëgjonie të dërguarin dhe prijësit e zgjedhur nga ju, dhe nëse konfrontoheni në diçka, ktheheni atë (çështje) te Allahu dhe i dërguari nëse besoni Allahun dhe ditën e gjykimit.” (en-Nisa, 59). Zoti i Lartmadhëruar ka urdhëruar që çështja polemizuese të kthehet te Allahu dhe i dërguari ti Tij, që do të thotë në Kur'an dhe sunet. E, nuk ka urdhëruar që të kthehet te umeti. Kjo tregon se mendimi i umetit është i pabazë dhe nuk ka nevojë për ixhmain.

Kundërpërgjigja në këtë është se ajeti thotë që kthimi të bëhet te ta, sepse argument i ixhmait është për çështjen debatuese dhe për t'u kthyer te Allahu dhe i dërguari i Tij. E kjo siç sqaruam, tregon se ixhmai është argument.

E dyta: Argumentimi me Sunet: Është hadithi i Muadhrit, ku e ka pyetur për argumentet me të cilat duhet vepruar. I ka treguar për mënyrën e ixhtihadit dhe marrjen e vendimeve.¹²¹ E, në atë sqarim Pejgamberi s.a.v.s. nuk e ka përmendur ixhmain. Po të kishte qenë argument, nuk e kishte lënë pa e përmendur, pasi që edhe nevoja e kërkon një gjë të tillë.

Po ashtu, janë transmetuar hadithe nga Pejgamberi s.a.v.s., të cilat tregojnë se do të ketë epokë ku nuk do të ketë njerëz të ditur për të

argumentuar. E, po të kishte qenë ixhmai argument, nuk do të kishte qenë e lejuar të ndodhte një gjë e tillë.

Kjo është dëshmi me thënien e Pejgamberit s.a.v.s. ku thotë: ***“Islami ka filluar i vetmuar dhe do të kthehet i vetmuar, ashtu siç ka filluar. Lum për të vetmuarit.”***¹²²

Po ashtu, thënia e Pejgamberit s.a.v.s.: ***“Zoti nuk e merr diturinë duke tërhequr atë prej njerëzve, por e merr diturinë duke bërë që të vdesin dijetarët, saqë nuk mbetet dijetarë, e pastaj njerëzit do t’i caktojnë udhëheqës të paditur. Pastaj do t’i pyesin, e ato do të japin përgjigje pa kurrfarë diturie, e ashtu edhe vet do të humbin, e edhe tjerët do t’i humbin”***.¹²³

Kundërpërgjigja është se: Hadithi, të cilin e kemi përmendur si argument, ka mundur të jetë argument, i cili është vepruar në kohën e Pejgamberit s.a.v.s., e nuk ka pasur nevojë të përmendet ixhami, sepse ixhmai nuk është argument në kohën e Pejgamberit s.a.v.s. E, nuk është sqaruar për më vonë, edhe pse do të kishte pasur nevojë.

Ndërkaq, sa i përket informatave të cilat tregojnë për epokën e zbrazët prej dijetarëve, si f.v. hadithi: ***“Ka filluar Islami...”*** nuk tregon se nuk do të ketë dijetarë fare, nuk do të sjellë argumente. Por, qëllimi i ajetit është se dijetarët Islamë do të jenë të paktë.

Sa i përket hadithit ***“humbja e dijetarëve”*** ose ***“humbja e diturisë”***, qëllimi është se është e mundur të humbin dijetarët dhe askush nuk mund ta mohojë se nuk mund të ketë ixhmaë, edhe pse do të humbin dijetarët, sepse fjala është që të jetë ixhami prej atyre dijetarëve të paktë, të cilët do të jenë në atë kohë.

Po ashtu, këto hadithe nuk janë në përputhshmëri me hadithet tjera, të cilët tregojnë se nuk do të ketë epokë pa dijetarë, të cilët nuk do të sjellin argumente. Shembull: ***Gjithmonë do të jetë një grup i Umetit tim në rrugë të drejtë, do të ndihmohen deri sa Allahu do të thotë urdhrin e Tij (për kiamet) dhe deri sa do të triumfojë Mesihu ndaj Dexhallit.***¹²⁴

Në rend të tretë, ata sjellin argumentin logjik se ixhmai është i pamundur. Dhe, kjo supozohet se ajo çka pretendonjë të gjykohej, siç pretendon shumica absolute. Ata mohojnë se mund të ndodhë, dhe thonë se një gjë e tillë është absurde. Ata deklarojnë: Vështirë se mund të ndodhë

ixhmai dhe është e pamundur, nga shkak se, nëse është prej argumentit të prerë, zakonisht është vështirë që të informohemi për të. Kjo nga shkak dhe rrethanat janë plotësuar për transmetimin e tij, dhe që ka të bëjë me bazat e ligjit.

Po ashtu, është e pamundur që të gjithë të pajtohen që ta mbajnë sekret atë. Dhe, përderisa nuk na transmetohet dhe nuk informohemi kjo tregon sikurse të mos ketë qenë fare. Kundërpërgjigja në këtë është se nuk mund të na transmetohet atëherë kur e kërkon nevoja të mos transmetohet, e nuk ka nevojë të transmetohet, sepse mjafton që vetë ixhmai është argument në vete.

Pastaj ata deklarojnë se: Nëse është për argument jo të prerë, nuk mund të ndodhë unifikimi (pajtueshmëria), për shkak të numrit të madh të umetit dhe të botëkuptimeve të ndryshme të tyre, për shkak të polemikave dhe për shkak të apetiteve të ndryshme, ashtu siç është e pamundur që të gjithë të pajtohen që të hanë vetëm një ushqim në të njëjtën ditë.

Kundërpërgjigja është se: Kjo analogji është e pabazë, sepse pajtueshmëria e një lloji të ushqimit në të njëjtën ditë është e pamundur, nga shkak se ajo që shpie në papajtueshmëri është natyrshmëria, apetitet dhe nevojat e ndryshme fizike, e njerëzit fizikisht ndryshojnë në mes vete. Përderisa, në çështjet e ixhmail është ndryshe se mbështetja (baza) e ixhmail është ajo që unifikon mendimet e njerëzve dhe i tubon që të gjithë në një pikë dhe në një program të përbashkët, sepse nevoja për këtë është ixhmai. Këtë do ta sqarojmë më vonë në temë të veçantë “*Mundësia e ixhmail dhe njohja e tij*”.

Bazuar në këtë, vërehet se ky është argument që mohuesit e ixhmail mohojnë mundësinë e realizimit të ixhmail, edhe pse deklarojnë se është argument. E kjo, pra, konsiderohet argument i mohuesve të ixhmail se është argument, por që nuk mund të realizohet (jetësohet).

Ata po ashtu deklarojnë se: Po të pranohet mundësinë e ixhmail, nuk mund të kuptohet në praktikë dhe nuk mund të dalë në pah, për shkak se muxhthidët janë të shpërndarë në vende të ndryshme të botës, që nga lindja e deri në perëndim.

Kundërpërgjigja në këtë është se njohuria për mendimet e muxhtehidëve mund të arrihet nëpërmjet transmetimeve dhe popullaritetit të atyre mendimeve. Siç dimë, p.sh. medhhebi Shafii ndalon ekzekutimin (vrasjen) e muslimanit për Dhimijin (minoritetin jo islam).

Po ashtu, edhe vendimi se shpallet i pavlefshëm kurorëzimi pa kujdestarë (të vajzës). Ndërsa, medhhebi Hanefij kanë mendim krejtësisht të kundërt në lidhje me këtë.

Mendimi i tyre (mohuesve) ndoshta do të kishte qenë i arsyeshëm për kohërat e vjetra, përderisa në kohën e sotme është lehtë të kuptohen mendimet e dijetarëve, pa vështirësi, nëpërmjet mjeteve elektronike dhe mjeteve të tjera informatike moderne. Po ashtu, mjetet e qarkullimit na mundësojnë që muxhtehidët t'i tubojnë në një kuvend në një kohë, për një interval kohor shumë të shkurtër. Këtë mund ta bëjmë nëpërmjet kongreseve e seminareve, ku u japim vullnet dhe kurajo për të prezantuar dijetarët e dalluar.

Kështu, pra, na bëhet e qartë dhe ne i japim prioritet mendimit të shumicës absolute të dijetarëve se ixhmai është argument dhe se argumentet e mohuesve të ixhmait janë të dobëta.

Lloji i argumentimit të ixhmait

Deklaruesit se ixhmai është argument nuk janë dakorduar në atë se ixhmai a është argument i prerë apo jo i prerë?.

Më e sakta është se shumica deklarojnë se ixhmai është argument i prerë, saqë mohuesi (kundërshtuesi) shpallet pabesimtar ose i humbur, ose risibërës.¹²⁵ Kjo është kështu, nëse neve na transmetohet ixhmai në mënyrë të besueshme. Mirëpo, nëse neve na transmetohet nga një rrugë e vetme ose është ixhmai i heshtur, atëherë kategorizohet si argument jo i prerë.

Amediju, Esneviju dhe Ibn Haxhibi e kanë përkrahur mendimin se: Nëse ixhmai është i prerë dhe bëhet i ditur në mesin e njerëzve në përgjithësi, si f.v. falja e pesë kohëve të namazit, mohuesi konsiderohet pabesimtar, e në të kundërtën jo.¹²⁶

Një shumicë e dijetarëve, e prej tyre Raziu mendojnë se: Ixhmai nuk tregon asgjë tjetër përpos se argument jo të sigurt.¹²⁷

Disa e bëjnë dallimin: ixhmai është i prerë, nëse miratuesit janë unanimit, ndërsa nuk është i prerë nëse miratuesit nuk janë unanimit, si f.v. rasti i ixhmait të heshtur dhe të ixhmai ku ka ndonjë mospajtim të rrallë.

Një pjesë e dijetarëve Hanefijë, e prej tyre Bezdaviju, mendojnë se: Ixhmai është shumë kategorish, e ato janë:.

-Ixhmai i shabeve është sikurse Kur'ani dhe suneti mutevahir.

-Ixhmai i tabiinëve dhe i gjeneratës së tretë është i nivelit të sunetit meshhurë.

-Ixhmai në të cilin ka pasur ndonjë mospajtim, në tri rastet e sipërpërmendura është i nivelit të informatës së vetme (Haberul Vahid).

Përfundim: Thënia se mohuesi i dispozitës së ixhmait është pabesimtar nuk është e vërtetë,¹²⁸ por shikohet: nëse është në pyetje Ixhmai i Shabeve, i cili ka arritur tek ne në formë të sigurt, gjykohet si pabesimtar mohuesi të i cili konsiderohet se ixhmai i tillë është argument i prerë, sikurse të teksti i prerë dhe hadithi i sigurt (mutevahir). Pa dyshim se në të dy rastet gjykohet si pabesimtar. Nuk gjykohet si pabesimtar të ata të cilët konsiderojnë se ixhmai është argument jo i prerë. Mohuesi të këta në këtë rast konsiderohet sikurse ata të cilët e mohojnë informatën e vetme ose Kijasin.

Amediu thotë: Nëse dispozita e ixhmait ka të bëjë me simbolet e Islamit, si f.v. pesë kohët e namazit, obligueshmëria e Tevhidit dhe e shpalljes, atëherë mohuesi konsiderohet pabesimtar. Po nëse nuk ka të bëjë me çështjet e tilla, si f.v. dispozita e lejimit të një lloji të shitblerjes, ose vlefshmëria e qiradhënies e të ngjashme, mohuesi nuk konsiderohet pabesimtar.¹²⁹

Imam Haremejni thotë: Është përhapur në deklaratat e fukahave se mohuesi i ixhmait është pabesimtar, gjë që nuk është e sigurt dhe e prerë, nga se: “Mohuesi i bazës së ixhmait nuk është pabesimtar”, se dëbimi nga pabesimi është çështje tejet serioze. Pastaj, ai thotë: Po, kjo është e vërtetë, për ata të cilët e pranojnë ixhmain dhe e pranon vërtetësinë e rezultimit të ixhmait, e pastaj prapë e mohon atë për çka janë unifikuar. Kjo do të thotë gënjeshtëri e kulluar në Ligjvënësin, e kush përgënjeshtrohet Ligjvënësin ka mohuar, e thënia është për atë se: kush e mohon rrugën deri të rezultimi i

ligjit, ai nuk ka mohuar, dhe kush pranon diçka çka ligjëson, pastaj kundërshton atë, ai është mohues i Ligjvënësit. Mohimi i një pjese të ligjit është i njëjtë sikurse mohimi i ligjit në tërësi.

Esneviju thotë: Mospranuesi i dispozitës së rezultuar prej ixhmait nuk shpallet pabesimtar, përpos disa fukahave të cilët e kundërshtojnë këtë mendim.

Ibni Haxhibi thotë: Mospranuesi i ixhmait jo të prerë nuk shpallet pabesimtar, e sa i përket ixhmait të prerë, për të ekzistojnë tri drejtime (medhhebe). Por, më i zgjedhuri prej tyre është se: nëse bëhet i njohur në përgjithësi, si f.v. për faljen e pesë kohëve të namazit e të ngjashme, siç janë çështjet e domosdoshme të fesë, ai konsiderohet pabesimtar, në të kundërtën jo.¹³⁰

Tema e tretë: Llojet e ixhmait

Varësisht prej mënyrës se si aprovohet ixhmai, ixhmai është dy llojesh:

1. **Ixhmai deklarativ, dhe**
2. **Ixhmai jodeklarativ (i heshtur).**¹³¹

1. Ixhmai deklarativ. është ixhmai në të cilën pajtohen mendimet, deklaratat dhe veprimet e tyre rreth një dispozite të një çështjeje, si f.v.: dijetarët dakordohen në një kuvend: secili prej tyre deklarativisht paraqet mendimin e tij për një çështje dhe pastaj mendimet e tyre përputhen për një dispozitë. Ose: secili dijetar jep mendimin e tij për një çështje dhe fetvatë (mendimet) përputhen për një çështje. Kështu, pra, siç kemi cekur, ky është argument te shumica absolute e dijetarëve.

2. Ixhmai i heshtur. është Ixhmai kur disa dijetarë japin mendimin në një kohë për një çështje, ndërsa të tjerët, pasi që dëgjojnë atë mendim, heshtin dhe nuk e mohojnë. Në lidhje me këtë lloj të ixhmait dijetarët kanë dhënë pesë mendime.¹³²

E para: Drejtimi i Shafijut, Isa bin Ebanit, Bakilanijut, Malikijut, është se kjo nuk është as argument, as ixhmaë.

E dyta: Drejtimi i shumicës se Hanefijëve dhe Imam Ahmedit. Këta e konsiderojnë ixhmaë dhe argument i prerë.

E treta: Drejtimi i Ebi Alij El Xhebaijut: Konsiderohet ixhmaë vetëm pas kalimit (skadimit) të asaj gjenerate, nga shkaku se vazhdimësia e tyre me heshtje deri në vdekje lë hapësirë shtesë se ato mund të kenë (të japin) mendim tjetër.

E katërta: Drejtimi i Ebi Hashimi bin Ebi Alijut është se: Nuk është ixhmaë, por argument. Këtë mendim e ka zgjedhur Amediu duke thënë se është ixhmaë jo i sigurt me të cilin lejohet të argumentohet. Ky është mendim i përafërt me këtë medhheb. Në librin “Muhtesarul Kebirë” këtë mendim e ka përkrahur Ibn Haxhibi. E, po ashtu, edhe Kerhiju prej dijetarëve Hanefij.

E pesta: Drejtimi i Ibni Ebi Hurejres: Nëse deklaruesi është hakim (gjykues) (jo dijetar ekspert), nuk është as ixhmaë, e as argument. Në të kundërtën konsiderohet edhe ixhmaë, edhe argument.

Sa i përket atyre që thonë se ixhmai i heshtur është argument, e ata janë Hanefijtë, dhe Hanbelijtë, thonë se për t'u aprovuar ixhmai i tillë duhet të plotësohen këto kushte:

1. Që heshtja të jetë pa shenja të pajtimit e as të urrejtjes (mospajtimit)
2. Që ai mendim të jetë i përhapur te të gjithë Muxhtehidët e asaj gjenerate.
3. Që të jetë kohë e mjaftueshme për të studiuar, hulumtuar dhe analizuar çështjen e shtruar.
4. Që çështja të jetë prej çështjeve ixhtihadije
5. Që të asgjësohen pengesat që shkaktojnë heshtjen, si f.v. frika nga udhëheqësi kriminel, ose koha e pamjaftueshme për të analizuar çështjen, ose që heshtësi të jetë prej atyre që mendojnë se çdo muxhtehidë ka të drejtë dhe prej atyre i cili nuk i kundërshton të tjerët, nga shkak se çështja është çështje e ixhtihadit, ose mendon se nëse kundërshton, nuk e marrin parasysh e të ngjashme.

Me një fjalë, kjo është plotësisht e kundërta e atyre që thonë (Malikijtë dhe Shafijjt) se ixhmai është argument.

Argumentet e vërtetuesve të ixhmait

Hanefijtë dhe Hanbelijtë, të cilët thonë se ixhmai i heshtur është argument, argumentohen me sa vijon:¹³³

Argumenti i parë: dijetarët janë pajtuar se ixhmai i heshtur është argument i prerë në çështje të besimit. E njëjta analogohet në çështjet praktike sekondare.

Kjo që u tha replikohet se kundërshtimi ka ndodhur në çështje të ixhtihadit, e jo në çështje të besimit. Përpos kësaj, Kijasi (analogjia) është argument jo i sigurt, e nuk mund të jetë argument për të vërtetuar ixhmain e sigurt (të prerë).

Argumenti i dytë: Nëse bëhet kusht deklarimi i secilit për të paraqitur pajtueshmërinë e tij, do të vinte deri te çështja për mosekzistimin e ixhmait për dy arsye:

E para: Zakonisht të dëgjuarit e çdo mendimi është i pamundur. Është çështje e zakonshme që të përhapet mendimi (feta) prej disa dijetarëve dhe heshtja e të tjerëve.

Ky argument replikohet me atë se: Kjo është ajo që vjen prej atyre që nuk e pranojnë ixhmain e heshtur, nga shkaku se pamundësia e të dëgjuarit nga çdo muxhtehidë, për t'u aprovuar ixhmai deklarativ, është largësia në mes të vendeve. E, kjo gjithashtu pamundëson edhe aprovimin e ixhmait të heshtur. Kjo, ngase është e mundur që të mos arrijë mendimi te ndonjë muxhtehid, sepse ai ndodhet në ndonjë vend të largët.

Sipas mendimit tim, baza e argumentit dhe replikimi i tij, në kohën e sotme nuk pranohet që të ketë mbështetje në të, pasi që informacionet shumë lehtë mund të shpërndahen nëpërmjet mediave publike bashkëkohore e të ngjashme, por edhe duke pasur parasysh, siç është treguar, se ka ndodhur ixhmai në kohën e shahabeve, ku nuk ka qenë vështirë të dëgjohen që të gjithë muxhtehidët, nga shkaku se ata kanë qenë të përqëndruar në vende të caktuara dhe të afërt me njëri-tjetrin.

Çështja e dytë: Nga shkaku se zakonisht në çdo gjeneratë, për një çështje japin fetva dijetarët eminent, ndërsa dijetarët e kategorisë së ulët heshtin, si pranim dhe pajtim në mendimin e tyre. Heshtja është pajtueshmëri.

Kjo replikohet me atë se: nuk mund të llogaritet heshtja pajtueshmëri, pa pasur shenja të tjera se pajtohet apo është i kënaqur. Mund të jetë heshtja ose për shkak të turpit, ose frikës prej udhëheqësit kriminel, ose për shkak të meditim, analizimit dhe hulumtimit e rasteve të ngjashme. Dijetarët e vegjël, ose disa prej tyre, kanë nevojë për një hulumtim më të gjatë, e nuk mund të përkufizohet me ndonjë afat. E, thënia e mospërkufizimit, nuk pranohet që ixhmai të jetë i sigurtë dhe i prerë.

Unë personalisht nuk kam parë dhe nuk kam dëgjuar në ndonjë kuvend apo parlament në botë që për çështje të rëndësishme të votohet në këso mënyre, që disa të paraqesin mendimet, e të tjerët të heshtin. Siç thotë Imam Shafiiu, praktika e cila zbatohet është se: **“Heshtja nuk llogaritet fjalim”**.

Argumentet e mohuesve të ixhmait

Mospranuesi i ixhmait të heshtur argumentohet me sa vijon:¹³⁴

E para: Argumenti logjik. Në ixhmaë kushtëzohet që secili në botë të paraqesë mendimin e tij. Për këtë çështje të gjithë janë të pajtimt. Nuk pranohet që disa të flasin, e të tjerët të heshtin, nga shkaku se heshtësit nuk mund t’i afrohet se ka folur, nga shkaku se heshtësi me heshtjen e tij është e mundur që është i pajtimt, ose ai nuk është përpjekur për çështjen e paraqitur, ose është përpjekur, mirëpo përpjekja e tij nuk ka rezultuar asgjë. Nëse ixhtihadi i tij ka rezultuar diçka, është e mundur se ka rezultuar diçka që është në kundërshtim me atë që është thënë, mirëpo ai atë kundërshtim nuk e ka paraqitur, ose për shkak të analizës më të thellë deri sa ta thotë mendimin definitiv dhe për ta shfrytëzuar kohën deri në momentin e fundit, ose për shkak të bindjes së tij, se sqaruesi është muxhtehidë dhe nuk e sheh të arsyeshme që të kundërshtojë muxhtehidin, nga shkaku se ai mendon se çdo muxhtehidë ka të drejtë dhe ia ka qëlluar; ose ai ka heshtur nga shkaku se ai është frikësuar se mos po shkakton përçarje. Siç është tregua rasti me

Ibni Abasin, ai është pajtuar me Umerin në çështjen e trashëgimisë së quajtur “AULI”. Kur është rasti se trashëgimtarë janë: burri, nëna dhe motra prej babait, atëherë trashëgimia është kështu: Burrit i takon një e dyta, nënës një e treta dhe motrës prej babait një e dyta. Çështja është se prej 6 pjesëve duhet të ngritet në 8 pjesë. Kjo veprohet kështu te pjesa më e madhe e sehaveve. Përderisa, Ibni Abasi e ka vepruar të kundërtën: ai e ka zbritur të dyfishtë, e në këtë rast është motra, e ajo merr vetëm një pjesë. Ai nuk e ka kundërshtuar veprimin e Umerit, por pastaj, pas vdekjes së Umerit, e ka paraqitur këtë mendim të vetin. Kur është pyetur për shkakun e heshtjes së tij është përgjigjur: **“Ashpërsia e tij, ai ka qenë njeri i fortë”**. Në një transmetim tjetër **“Më ka frikësuar forca e tij”**.¹³⁵

Edhe pse Gazaliu i ka përmendur të gjitha këto alternativa të cilat janë shtatë alternativa. Pasi të përhapet mendimi i muxhtehidit në mes të muxhtehidëve, nuk ka heshtje më; heshtësi me heshtjen e tij është i rrethuar me kushte dhe me preokupime të vetes së tij dhe jashtë vetes së tij, siç kemi sqaruar më parë. Autori i librit “Subules-Selam” thotë: Heshtja e ndonjërit prej dijetarëve për ndonjë çështje aktuale ose për diçka tjetër prej veprave të ndaluara, ose për mosveprimin e vaxhibit, nuk tregon se ka lejuar atë që ka ndodhur, por as mosjelimin e veprimit. Pra, nuk mund të vërtetohet se heshtësi i është bashkangjitur ixhmait, vetëm nëse dihet se ai në fakt është dakorduar. E, këtë nuk e di askush tjetër përpos Allahut të Gjithditur dhe që di të fshehtat.¹³⁶

Ky argument është replikuar me atë se nëse muxhtehidi nuk do të pajtohet, ai atë mospajtim do ta paraqiste deri në momentin kur t'i jepte fetvanë dhe do të sqaronte ligjësimin. Mirëpo, edhe kjo, gjithashtu, do të replikohej me atë se po të ekzistonte pajtueshmëria, do ta paraqiste, dhe ai pajtim do të na ishte përcjellur neve.

Pas këtyre alternativave bie poshtë mendimi i Xhebaijut, ashtu siç e ka kushtëzuar skadimin e gjeneratës në ixhmain e heshtur, nga shkakun se disa prej këtyre alternativave mund të vazhdojnë deri në çastin e vdekjes së muxhtehidëve të asaj gjenerate. Po ashtu, bie poshtë mendimi i atyre që thonë: Është argument edhe nëse nuk quhet ixhma, nga shkakun se kështu gjykohet me mendimin e një pjese të umetit, përderisa pagabueshmëria është e tërë umetit në përgjithësi.

Po ashtu, ky argument replikohet me atë se: heshtja llogaritet pajtueshmëri atëherë kur të mënjanohen këto alternativa. E, kjo është ajo që argumentohen me ixhmain e heshtur.

E dyta: Argumentimi me fakte të gjurmimit nga Pejgamberi s.a.v.s. Njëri prej atyre fakteve është hadithi i “**Dhul Jedejnit**”, i cili ka qenë duke u falur me Ebu Bekrin, Umerin dhe sehabet tjerë dhe me Pejgamberin s.a.v.s. Pejgamberi s.a.v.s. namazin katër rekatësh e shkurtton në dy rekate. Dhul Jedejni e pyet: O i Dërguar i Allahut, e kemi shkurtuar namazin, apo ke harruar?

Pejgamberin s.a.v.s. është përgjigjur: **As nuk kam harruar dhe as nuk e kam shkurtuar**, – pra, sipas mendimit tim.

Pastaj Pejgamberi s.a.v.s. e pyet Ebu Bekrin: A është e vërtetë çka po thotë ky?

I thotë: Po!¹³⁷

Po të kishte qenë heshtja e Ebu Bekrit dhe e të tjerëve, ose heshtja e mëpastajshme e Dhul Jedejnit, si pajtim, Pejgamberi s.a.v.s. nuk do t'i kishte pyetur dhe do të kishte mjaftuar ajo çka ka thënë Dhul Jedejni, pa pasur nevojë më për pyetje.

Rast tjetër. – Është transmetuar se Umeri r.a. është konsultuar me sehabet për pasurinë e tepërt tek ai prej pasurisë së luftës. Ato dhanë mendimin që të shtyhet për një afat ndarja e asaj pasurie dhe magazinimi deri në ndonjë nevojë. Ndërsa, Aliu r.a. ka heshtur për këtë çështje, derisa Umeri r.a. thotë: O baba i Hasanit, po ti çfarë mendimi ke? Aliu r.a. i thotë: Të sigurtën nuk e bëjmë të dyshimtë, e as diturinë tënde - injorancë. Unë mendoj që të ndahet menjëherë në mesin e muslimanëve. Po ashtu, është transmetuar se ai ka thënë që të ndahet pasuria tepërcë e luftës. Ky është argument se Umeri r.a. heshtjen e Aliut r.a. nuk e ka konsideruar dakordim, derisa edhe e ka pyetur. Ndërsa Aliu, Zoti e nderoftë atë, e ka shfrytëzuar të drejtën e tij duke dhënë mendimin që pasuria të ndahet, që ishte mendim i kundërt (opozitë) me të tjerët. Ka edhe gjurmë tjera, të cilat i ka përmendur autori i librit “Keshful esrarë” në volumnin II, fq. 949 e më tutje.

Këto gjurmë të përmendura janë replikuar kështu: sa i përket transmetimit të parë: Nuk ka qenë pyetja e Pejgamberit s.a.v.s. se nuk e ka llogaritur heshtjen e tyre dakordim, por ka parashtruar pyetje që të vërtetojë

a është e vërtetë ajo çka ka thënë “Dhuj Jedejni”. E, vërtetimi prej pyetjes së tij mund të jetë se ai heshtjen e ka konsideruar dakordim. A ka dashur të vërtetojë apo jo, tregon se Pejgamberin s.a.v.s. i ka plotësuar edhe dy rekate, e pastaj ka bërë sehvi sexhde.

Sa i përket transmetimit të dytë: është pyetur Aliu r.a. jo nga shkaku se Umeri r.a. nuk e ka konsideruar heshtjen dakordim, por pyetja është bërë gjatë kohës kur ende ka qenë debati dhe konsultimi. E, pyetja për të heshturin, në raste të tilla, nuk mund t’i bashkëngjitet pyetësit, sepse ai heshtjen nuk e ka llogaritur dakordim, nga shkaku se rasti i tillë vjen në pyetje atëherë kur përfundon dialogu.

E vërteta është se këto dy transmetime japin mundësi të shumta dhe mund të jenë bazë për këtë rast. Për këtë arsye, unë e kam përmendur pas argumentit logjik, i cili, në realitet, është bazë e fortë për t’iu kundërpërgjigjur ixhmait të heshtur, gjë që ka ndikuar te analitikët Shafiij që të përkufizohen dhe të mos i përmendin.

Sipas mendimit tim, vërtetuesit e ixhmait të heshtur nuk janë si forcues të opozitës logjike, të cilët e mohojnë atë, vetëm se në anën tjetër nuk mund të kuptohet ixhmai i sehaveve ndryshe, përpos edhe nëpërmjet ixhmait të heshtur. Po ashtu, ne shohim se që të dy medhhebet, edhe Hanefijt, edhe Shafiijt, thonë se është aprovuar ixhmai për dënimin e alkoolistit, siç është dënimi me tetëdhjetë të rëna te Hanefijtë dhe katërdhjetë të rëna te Shafiijt. E, kjo nuk mund të aprovohet ndryshe përpos nëpërmjet ixhmait të heshtur.

Mund të përafrohen dy mendimet duke i shikuar në tri aspekte:

E para: Heshtja në momentin kur kërkohet debati dhe sqarimi. Heshtja ndaj një mendimi, i cili është lansuar dhe është përhapur, tregon adresën e dakordimit.

E dyta: Kur të jetë diçka e pavlefshme, muslimanët nuk hashtin, për arsye se ata janë xheloz në fenë e tyre.

E treta: Patjetër duhet të ketë shenja të cilat tregojnë dakordimin dhe pajtueshmërinë, ashtu që heshtja të jetë sqarimi final dhe përfundimtar dhe kjo të jetë rruga që i mënjanon alternativat, të cilat i marrin si argument

mohuesit e ixhmait të heshtur, si f.v. Muxhtehidi ka përfunduar hulumtimin, ose ka heshtur, për shkak të devotshmërisë, ose ka bërë ixhtihad, por nuk ka arritur asnjë rezultat, atëherë ixhmai i heshtur llogaritet argument.

Duke pasur parasysh se është shumë vështirë të mënjanohen të gjitha këto mundësi, Imam Shafijû ka kushtëzuar deklarin e qartë nga të gjithë muxhtehidët. Ai thotë: Heshtja e heshtësit nuk është fjalë dhe as vepër e vepruesit, por merret si bazë çdo vepër dhe fjalim. Kjo tregon se nuk është ashtu siç mendojnë disa, që ta proklamojnë se institucioni i ixhmait është për të shumtën e ligjeve të posaçme.

Tema e katërt: Baza e Ixhmait

Baza e ixhmait. –Është argumenti në të cilin mbështeten muxhtehidët në atë çka janë dakorduar, mirëpo nuk janë dakorduar në domosdoshmërinë në të cilën duhet patjetër të bazohet.¹³⁸

Shumica absolute e dijetarëve thonë: Ixhmai patjetër duhet të ketë bazë dhe mbështetje në tekst Kur'anor, tekst të sunetit ose të analogjisë, nga shkaku se fetvaja pa bazë (mbështetje) është gabim, sepse në fe llogaritet mendim pa dituri (bazë). E, kjo është e ndaluar me thënien e Zotit të Lartmadhëruar: **“Dhe mos u ndal (mos merr vendim) me atë për çka nuk ke njohuri.”** Ndërsa, umeti është i garantuar si i pagabuar dhe se pjesëtarët e ixhmait nuk kanë pavarësi në vendosjen (aprovimin) e ligjeve, e për këtë arsye dakordimi (konzensusi) i tyre patjetër duhet të ketë mbështetje. Poqëse do të themelohej pa ndonjë mbështetje, atëherë do të vinte deri te aprovimi i ligjeve pas Pejgamberit s.a.v.s., e kjo do të ishte e pavlefshme. Përpos kësaj, llojllojshmëria e mendimeve dhe mënyrat e shumta deri te arritja e titujve të dijetarëve, zakonisht është pengesë për t'u dakorduar për diçka, përpos nëse ka ndonjë shkak, i cili obligon që ata, nëpërmjet të shkakut, të dakordohen dhe që i unifikon mendimet. E, baza (mbështetja) është ajo që i unifikon mendimet e tyre dhe nuk lejon që muxhtehidi t'i kalojë kufijt e ligjit. Baza apo mbështetja duhet të jetë ose ajo që bën të koncizohet teksti për çka është tekstualizuar për t'u ligjësuar, ose përpilimi i ligjit nga teksti, nëpërmjet analogjisë së tekstit, ose zbatimin e rregullave të sheriatit dhe shpirtit të saj dhe rregullat e përgjithshme të tij, ose argumentim me argumente të sheriatit, si f.v. me “istihsan” me “Istis-hab” ose “urfit” ose parimit të “Sedu Dhiarit” etj.

Siç tregon Amediju dhe Abdul Xhebari, disa dijetarë thonë: mbështetja nuk është kusht, por lejohet aprovimi i ixhmait nëpërmjet pajtueshmërisë së Allahut, e jo vendimit të tyre, ashtu që Allahu i Lartmadhëruar pajtohet me ixhmain se e ka zgjedhur të vërtetën, pa pasur bazë apo mbështetje, dhe i frymëzon e i orienton në të vërtetën.

Baza e këtij mospajtimi të këtyre dy mendimeve është në atë se: **“Frymëzimi”**¹³⁹ a konsiderohet argument në sheriatë apo jo?

Shumica absolute e dijetarëve thonë: Frymëzimi nuk konsiderohet argument, ndërsa,

Disa prej dijetarëve, si f.v. Fahu Raziu, Ibnu Salahu dhe Shiitët, thonë: Ixhmai patjetër duhet pasur argument. E frymëzimi është argument, por i argumentuar prej argumenteve.¹⁴⁰

Shihet qartë se frymëzimi në shariatë konsiderohet argument jo i rregullt, joparimor, nga shkaku se ligji i shariatit merret nga shpallësi qiellor; ekzistojnë ajete dhe hadithe të cilat flasin se është e ndaluar që në shariatë të flitet pa njohuri. Kjo vlen deri te rezultati përfundimtar se ixhmai lejohet që të jetë edhe pa bazë dhe pa mbështetje, e argumentimi i tyre bazohet në dy çështje:

E para: Ixhmai është argument në vetvete; edhe nëse aprovohet pa argument bazë të shariatit, do të bëhej ky argumentim argument, e atëherë nuk do të kishte vlerë natyra e ixhmail si argument.

E dyta: Ixhmai pa argument veç ka ndodhur, si f.v. Ixhmai i vlefshmërisë së shitblerjes së dakorduar pa argument. Po ashtu, pagesa e larjes në banjo publike, pa caktuar dhe pa e ditur kohën dhe shpenzimin e sasisë së ujit. Shitblerja e dakorduar është shitblerja, e cila realizohet në mes të dy palëve, pa akt kontraktues, ndryshe quhet shitblerje e marrje-dhënie.

Argumenti i parë replikohet me atë se: Shpallësi i shpalljes thotë vetëm atë që shpallet, ndërsa umeti duhet që të mos thotë asgjë pa argument. Ndërsa, ligji i thatë, apo i epshit, është ligj për të cilin vetë natyrshmëria e thotë se është vepër e pabesimtarëve dhe e atyre që bëjnë bid'ad.

Sa i përket çështjes që ata pretendojnë se atëherë ixhmai nuk do të kishte kurrfarë vlere, është mendim i pavlerë, sepse atëherë ixhmai dhe mbështetja në të do të ishin dy argumente të ndara. Ndërsa, bashkimi i dy argumenteve për një ligj është i lejuar dhe i vlefshëm dhe vlera e ixhmail atëherë do të ishte: anulimi i hulumtimit që të vazhdohet për të gjetur argumentin, në të cilin janë mbështetur, dhe të bërit haram nëse kundërshtohet ligji për të cilin ligj është realizuar ixhmai dhe rregull i këtij ligji është se është vendim i prerë. përpos kësaj duhet që pasi të bëhet mbështetja në argumentin e përmendur se nuk lejohet të themelohet ixhmai për të sjell argument. Kështu nuk thotë askush përderisa ata edhe vet ata

lejojnë që ixhmai të ketë mbështetje dhe që të mos ketë mbështetje. Në këtë mënyrë vjen deri te kundërshtimi në mes të aktvendimit dhe argumentimit.

Argumenti i dytë replikohet kështu: Thënia e Ixhmait se ndodh shitblerja e dakorduar pa argument me atë se nuk mund të pranojmë se veç ka ndodhur ixhmai, sepse Imam Shafiiu ka thënë: Shitblerja e dakorduar (marrje-dhënie) është shitblerje e pavlefshme. Por, edhe nëse e pranojmë se ixhmai ka ndodhur dhe shitblerja është e vlefshme, po ashtu edhe pagesa për banjë publike është e vlefshme; ata për këtë çështje patjetër duhet pasur argument që të jetë ixhmaë. Për këtë arsye, ixhmai dhe mossjellja e argumentit nuk tregon se nuk është aprovuar ixhmai, siç është e njohur.

Cili është lloji i argumentit, i cili meriton që në të të ketë mbështetje ixhmai?

Shumica absolute e dijetarëve, të cilët thonë se ixhmai patjetër duhet të ketë mbështetje, nuk janë dakorduar për llojin e mbështetjes së ixhmait:

Shumica thonë se: Lejohet që për mbështetje të jetë argumenti i prerë: Kur’ani dhe suneti mutevatir dhe lejohet të jetë argument jo i prerë: informacioni i vetëm dhe analogjia (Kijasi).

Dhahirijtë, Shiitët, Ibn Xherir et-Taberiu dhe dijetari Kashaniju muëtezil thonë: Mbështetje e ixhmait duhet të jetë vetëm argumenti i prerë dhe se ixhmai nuk mund të aprovohet me informacionin e vetëm dhe me analogjinë.¹⁴¹

Kështu e ka përshkruar Bezdaviju, mirëpo kam hasur se Dhahirijtë nuk e mohojnë, por e pranojnë që ixhmai të ketë mbështetje në informacionin e vetëm (Haberul vahid). Dijetari i njohur Ibnu Hazmi në librin “El-Ahkam” thotë: Pa tekst nuk ka ixhmaë. E, ai tekst ose duhet të jetë nga thënia e Pejgamberit s.a.v.s., i cili është i transmetuar, dhe patjetër duhet të jetë ruajtur prej veprave të Pejgamberit s.a.v.s., që gjithashtu duhet të jetë i ruajtur ose prej vendimeve në heshtje të Pejgamberit s.a.v.s., të cilat janë të

përcjellura dhe të ruajtura. Me këtë shihet se dijetarët janë të pajtimit se argumenti i prerë dhe i sigurt është bazë dhe mbështetje e ixhmait, ndërsa nuk janë të pajtimit për argumentim jo të sigurt.

Argumentet

Grupi i dytë, apo mospranuesit, argumentohen me sa vijon:

E para: Ixhmai është argument i prerë dhe i sigurt, ndërsa informacioni i vetëm (haber vahid) dhe analogjia janë jo të sigurt dhe nuk tregojnë njohuri të sigurt. Për këtë arsye, ata nuk mund të sjellin dhe të tregojnë çështje të sigurt, nga shkaku se jo e sigurta nuk mund të tregojë të sigurtën.

Replikohet me atë se konsiderimi i ixhmait si argument i sigurt dhe i prerë nuk do të thotë që edhe baza apo mbështetja të jetë e sigurt dhe e prerë, sepse ixhmai është argument i sigurt, si respekt dhe vlerë e këtij umeti, për të cilin tregojnë hadithet se umeti nuk dakordohet në gabim. Ai është argument i prerë dhe i sigurt në vetvete, e jo pse mbështetja e tij në diçka është e prerë dhe e sigurt. Po edhe nëse themi se Ixhmai nuk mund të jetë përpos prej argumentit të prerë, atëherë ixhmai nuk do të kishte pasur kuptim dhe do të kishte qenë joserioz, sepse atëherë nuk do të kishte treguar diçka që kërkohet. Ndërsa, kur ixhmai ka mbështetje në argumentin jo të sigurt, atëherë ligji do të kalonte në ligj jo të sigurt, për shkak se atij ligji i është bashkëngjitur ixhmai.

E dyta: Të gjithë janë të pajtimit se lejohet që muxhtehidi të kundërshtojë ligjin, i cili është marrë prej analogjisë. E, kur të rezultojë ixhmai prej analogjisë, atëherë muxhtehidi e ka të ndaluar të kundërshtojë, pasi që ai ligj ka kaluar prej ligjit, i cili ka qenë lejuar të kundërshtohet më parë prej muxhtehidi, në ligj i cili është i ndaluar të kundërshtohet prej muxhtehidi.

Kjo replikohet në atë se lejimi i kundërshtimit të analogjisë është i lejuar para aprovimit të ixhmait për ligjin e analoguar, ndërsa pas ligjësimit prej ixhmait nuk lejohet të kundërshtohet, për shkak se është forcuar ligji me ixhmaë.

E treta: Ixhmai nuk mund të aprovohet vetëm nëse atëherë dakordohen dijetarët e një gjenerate; dhe nuk ka gjenerate të që nuk është kundërshtuar ndonjë ligj prej analogjisë. E, kjo është pengesë që Ixhmai të ketë mbështetje në analogji. Kështu ka thënë Ibni Hazmi.

Sa i përket aprovimit të ixhmait prej analogjisë, ajo është e pavlefshme që nga fillimi, sepse ata nuk janë dakorduar në vlefshmërinë e Kijasit¹⁴² (analogjisë). E, si të dakordohen në atë që nuk janë dakorduar.

Në këtë replikohet me atë se Kijasi (analogjia) nuk ka ndodhur në kohën e sehaveve.

Pse janë paraqitur më pastaj kundërshtimet, kjo nuk do të thotë se ixhmai nuk mund të aprovohet. Kjo është përgjigje për ata që pengojnë dhe kundërshtojnë informacionin e vetëm dhe analogjinë. Disa prej tyre deklarojnë se nuk ka kundërshtim që edhe informacioni i vetëm (haber vahid) të jetë i vlefshëm për mbështetje të ixhmait. Me këtë bëhet edhe më e fortë kundërpërgjigja, nga shkak se thuhet: Informacioni i vetëm (haber vahid), edhe pse për të ka mosmarrëveshje në shkaqet e vërtetësisë së tij dhe pranimit të tij.

Kështu është çështja edhe me analogjinë.

Sa u përket argumenteve të shumicës absolute të dijetarëve, të cilët lejojnë që ixhmai të mbështetet në argument jo të sigurt, janë si vijon:¹⁴³

E para: Argumenti logjik. Ka njerëz të cilët dakordohen për ligje të pavlera, ligje këto që nuk kanë as mbështetje në argument të sigurt, e as në argument jo të sigurt. E, lejimi i aprovimit (themelimit) të ixhmait prej argumentit jo të sigurt është edhe më prioritar. Përpos kësaj, argumentet e argumentimit, të cilat i kemi përmendur, nuk bëjnë dallimin në mes ixhmait, i cili ka mbështetje në argument të sigurt, dhe ixhmait i cili ka mbështetje në argument jo të sigurt; përderisa përcaktimi i ixhmait vetëm me argument të sigurt nuk lejohet, pasi që nuk ka argument.

E dyta: Nga transmetimet. Është e vërtetë se praktikisht ka ndodhur aprovimi i ixhmait me argument jo të sigurt. Sehabet janë dakorduar se është obligim pastrimi (gusli) nga papastërtia (xhunub), në bazë të hadithit të Aishes r.a. “nëse preken dy organet seksuale”, e raste tjera të ngjashme.

Po ashtu, janë dakorduar që Ebu Bekri të jetë halife (imam) nëpërmjet rrugës së ixhtihadit dhe mendimit, duke i dhënë përparësi, pasi që ai kishte pasur përparësi të bëhej imam kur ishte i sëmurë Pejgamberit s.a.v.s.¹⁴⁴ Një pjesë e sehaveve (e tyre) kanë thënë: Pejgamberit s.a.v.s. ka qenë i kënaqur dhe i pajtimit të jetë udhëheqës në fenë tonë, e pse të mos jetë udhëheqës i çështjeve të jetës sonë. Po ashtu, janë dakorduar se është e ndaluar yndyra e derit, analog me ndalimin e mishit të tij. Janë dakorduar që alkoolisti të jetë i dënuar me tetëdhjetë shkopinj,¹⁴⁵ analog me dënimin e shpifësit të grave të ndershme.

Aliu r.a. ka thënë: Unë mendoj se ai i cili dehet, të ketë dënim, dhe ai, i cili shpif, të ketë këtë dënim, dhe e ka dënuar me tetëdhjetë të rëna.

Janë dakorduar që në të njëjtën kohë të mos bëhet martesë me dy gra, të cilat janë “meharim”, duke u mbështetur në hadithin: **“Nuk martohet gruaja dhe tezja ose halla e saj”**.

Janë dakorduar për të drejtën e trashëgimisë së gjyshes, duke u mbështetur në hadithin se Muhamedi s.a.v.s. ka lejuar që të ketë të drejtë në një të gjashtën e trashëgimisë.

Janë dakorduar se në të drejtën e trashëgimisë, vëllezërit nga babai janë të njëjtë me vëllezërit për nga nëna dhe babai, e që për mbështetje kanë pasur argumentin jo të sigurt.

Ka pasur edhe raste tjera të ngjashme, të cilat nuk kanë vlerë më të madhe se argumentet e sipërpërmendura.

Ngjashëm me analogjinë, si mbështetje, është edhe rregulli “meslehatul mursel”. Meslehatul mursel është atribut, i cili lidh dispozitën bazë me një dispozitë tjetër, e cila u sjell dobi njerëzve, ose e largon dënimin prej tyre, dhe për atë nuk ka ndonjë argument të caktuar për anulimin apo vendosjen e atij ligji.

Meslehatul mursel lejohet që të jetë mbështetje e ixhmait. *Shembull:* Vendimi i Ebu Bekri Sidikit për tubimin e Kur’anit, me çka është pajtuar edhe Umeri, i cili ka thënë se është domosdoshmëri, pasi që ishin vrarë lexues të shumtë në betejën e Jemanës. Kjo nga frika se mund të humbë Kur’ani me humbjen e lexuesve të Kur’anit. Në lidhje me këtë Umeri ka thënë: Për Zotin kjo është në interes të Islamit. Me Ebu Bekrin dhe Umerin janë pajtuar të gjithë sehabet në lidhje me këtë çështje

Shembull të ngjashëm: Umeri r.a. i ka lënë vakëf tokat e Sirisë dhe të Irakut pa ua ndarë luftëtarëve pasurinë e luftës. Mbështetja e tij në lidhje me këtë ka qenë që tokat t'u kthehen pronarëve të tyre, duke caktuar tatimin e llojit **“Haraxh”** për ta, që pastaj ai tatim (haraxh) të jetë burim i të ardhurave për muslimanët dhe që të forcohet arka qendrore Islame (buxheti Islam i Bejtul malit); në atë mënyrë që të ketë mundësi të shpenzohet ajo pasuri në interes të përgjithshëm të muslimanëve, pra, në investim për ushtrinë, punëtorët, administratën për jetimët, nevojtarët, për ujësjellës, rrugë, dhe rezerva shtetërore për nevoja urgjente dhe për çështje tjera të përgjithshme. Të gjithë sehabet janë pajtuar me këtë veprim të Umerit r.a.

Vërehet qartë se Ixhmai ka mbështetje në parimin e interesit të përgjithshëm **“Meslehas”** dhe mbetet argument, përderisa ekziston interesi i përgjithshëm.

Lejohet ixhmai në të kundërtën e atij ligji të mëhershëm, sikurse ka ndodhur me rastin e përcaktimit të çmimeve. Pastaj, më vonë shtatë Imamët kanë dhënë fetva¹⁴⁵ se lejohet përcaktimi i çmimit në treg. Këtë fetva e kanë dhënë për të ruajtur dhe siguruar pasurinë e qytetarit.

Ngjashëm me këtë është edhe dëshmia e të afërmit: sehabet e kanë lejuar, por më vonë dijetarët e katër medhhebeve nuk e kanë lejuar dhe nuk e kanë pranuar dëshminë e të afërmit dhe të bashkëshortit për bashkëshortën dhe këtë në bazë të interesit të përgjithshëm, për të siguruar të drejtat dhe pasurinë e qytetarit.

Mendimet e dijetarëve se a llogaritet Kijasi dhe interesi i përgjithshëm si mbështetje për ixhmain.?

Për të sqaruar këtë çështje duhet t'i sjell mendimet e dijetarëve të Usulit dhe duke ia bashkangjitur mendimet më të rëndësishme dhe më serioze.

A lejohet që analogjia të jetë mbështetje për Ixhmain?

Sa i përket çështjes se a llogaritet analogjia mbështetje e vlefshme për ixhmain, dijetarët kanë dhënë tri mendime të ndryshme:¹⁴⁷

Mendimi i parë: Mendimi i Shiitëve, i Davudit dijetarë Dhahirij dhe Ibni Xherir et-Taberijut.

Këta nuk e pranojnë, pra nuk e lejojnë që analogjia të jetë mbështetje për ixhmain, ngase mendimet e dijetarëve për analogjinë kanë kundërshtime të qarta, për shkak se nuk janë pajtuar në lidhje me përcaktimin e atributit, i cili është në harmoni me dispozitën. E, përderisa ekziston ky mospajtim, nuk mund të aprovohet ixhmai. Përpos kësaj, në vetë bazën e argumentimit të ixhmait ka mospajtime. E, si mund të jetë vetë bazë për aprovimin e ixhmait?! Ato që i kemi përmendur si ixhmaë të sehabëve, nuk kanë qenë ixhmaë që kanë pasur mbështetje në analogji apo ixhtihadë, por kanë pasur mbështetje në tekstet (citatet) e Kur'anit dhe të sunetit, siç është rasti: dakordimi për t'u mos u ndarë pasuria e luftës në tokat e Irakut. Kjo ka pasur mbështetje në tekstin Kur'anor:

مَا أَفَاءَ اللَّهُ عَلَى رَسُولِهِ مِنْ أَهْلِ الْقُرَىٰ فَلِلَّهِ

“Atë që Allahu i ka dhënë pejgamberit të vet, që të përfitojë nga pasuria e mbetur e luftës, është e rrugës së Allahut” (El-Hashr, 7).

Pra, kjo ka qenë bazë e ixhmait të tyre, e jo analogjia, e as interesi i përgjithshëm. Ngjashëm me këtë ixhmai i tyre në lidhje me të drejtën e trashëgimisë së gjyshes dhe të vëllezërve nga babai, nëse i vdekuri nuk ka vëllezër. Po ashtu, ndalesa e kurorëzimit në të njëjtën kohë me gruan dhe hallën, apo tezën e saj etj etj. Mbështetja ka qenë teksti, e jo analogjia. Sa i përket ixhmait për hilafetin e Ebu Bekri Sidikit, apo tubimit të Kur'anit, apo vrasjen e tradhtarëve të fesë dhe dërgimin e ekspeditave në Persi dhe në perandorinë Romake, përpilimin e regjistrave, vendosjen e kalendarit të hixhretit, kjo ka qenë pajtueshmëri për të praktikuar një çështje praktike që ka qenë në harmoni me kushtet e kohës së tyre. E vërteta është se ajo ka qenë praktikë që ka pasur të bëjë me kohën e tyre, e nuk ka qenë ixhmaë e një dispozite të shariatit, e cila duhet të vazhdojë në gjeneratat tjera.¹⁴⁸

Mendimi i dytë: Mendimi i shumicës së dijetarëve të Usulit

Këta e lejojnë në mënyrë absolute. Pra, është i vlefshëm ixhtihadi dhe analogjia si mbështetje për ixhmain. Kjo nga shkak se analogjia është argument i shariatit i bazuar në tekst, pra është bazë prej teksti, e baza prej tekstit nënkupton lidhje me tekstin dhe kur të aprovohet ixhmai, duke u bazuar në të njëkohësisht, është ixhmaë i mbështetur në tekst.

Mendimi i tretë: Mendimi mesatar dhe më i maturi

Nëse shkaku (arsyeja) e analogjisë është prej tekstit apo është i qartë dhe jo i fshehur, lejohet që të jetë i vlefshëm si mbështetje për ixhmain. Por, nëse shkaku është i fshehtë dhe që nuk është tekstualizuar, nuk lejohet që të jetë mbështetje për ixhmain. Ky mendim është i përafërt me mendimin e parë, ngase, nëse shkaku (arsyeja) është e tekstualizuar, do të thotë se ixhmai ka mbështetje në tekst, e për këtë nuk ka diskutim.

Sipas mendimit tim: Ixhmai është i vlefshëm nëse ka bazë në kijasë. Ky është mendimi i dytë i të gjithë dijetarëve të Ususlit, nga shkaku se argument për këtë kemi sehabet, ata praktikisht janë dakorduar për këtë. E, nuk ka argument më të fortë se vërtetimi praktik.

-Ata janë dakorduar se është e ndaluar yndyra e derrit, analog me mishin e tij. –Ata, po ashtu, janë dakorduar për vajin e susamit, shurupit dhe të pekmezit, nëse në të bie miu dhe ngordh; për këtë janë dakorduar duke e krahasuar me miun i cili bie në vaj.

- Po ashtu, në emërimin e Halid Ibn Velidit udhëheqës në vendin e fushëbetejës, në të cilën fushëbetejë, pas ixhtihadit, e kanë emëruar udhëheqës.

- Po ashtu, janë dakorduar për pagimin e dëmit të gjuetisë. Pagesa e dëmit të jetë përballë kafshës së gjuajtur.

- Po ashtu, dakordimi i shpenzimit për perkujdesje në vlerë të shpenzimit për të afërmit.

- Po ashtu, janë dakorduar për drejtësinë e Umetit dhe gjyqësisë; ka edhe shumë raste të ngjashme.

A lejohet që meslehatul mursel të jetë mbështetje për ixhmain?

E kanë lejuar që meslehatul murseli të jetë mbështetje për ixhmain, përderisa të ketë interes të përgjithshëm, lejohet të ndryshojë ixhmai dhe të aprovuarit të një ligji tjetër, i cili është në harmoni me interesin tjetër të përgjithshëm.

Argument i kësaj është se shtatë dijetarët e Medinës e kanë lejuar përcaktimin e çmimeve në treg.

Pastaj, dy Imamët e njohur Maliku dhe Ebu Hanifë kanë lejuar që t'i jepet zekati fisit Hashimij, pasi që ka ndryshuar Bejtul mali (arka qendrore Islame).

Po ashtu, dijetarët e Medhhebeve kanë ndaluar që të dëshmojë i afërti për të afërmin e tij dhe gruaja për bashkëshortin e saj dhe anasjelltas. E, kjo për shkak të interesit të përgjithshëm, që të sigurohet e garantohet jeta dhe pasuria e qytetarit. Kjo unanimisht ka qenë e lejuar në kohën e sehabeve.

Prej shembujve, ku sehabet janë mbështetur në meslehatul mursel, janë shembujt, të cilat i kemi përmendur, ku janë dakorduar sehabet që në vendet e çliruara të mos u ndahet luftëtarëve pasuria e luftës, por të vendoset sistemi i haraxhit, që të jetë burim i pashtershëm i bejtul malit (arkës qendrore Islame) dhe të krijohet fondi për gjykatësit (administratën), për ushtarët, për familjet e dëshmorëve, jetimët dhe nevojtarët, për urbanizëm, për ujësjellës, që të kenë dobi muslimanët e të gjitha kohëve njësoj.

Prej shembujve të ixhmait është edhe Ixhmai i sehabeve për tubimin e Kur'anit në një mus-haf siç treguam më herët.¹⁴⁹

Pastaj, shtimi i ezanit të tretë (duke pasur parasysh se edhe ikameti quhet ezan) në kohën e Uthmanit r.a. për t'i paralajmëruar njerëzit për namaz, të cilët kanë qenë larg xhamisë, që t'u mos i shpëtojë namazi. Mbështetja e tyre ka qenë interesi i përgjithshëm dhe mënjanimi i dëmit, sepse po të vazhdohej gjendja si më parë, pra si në kohën e Pejgamberit s.a.v.s., Ebu Bekrit dhe Umerit, do të kishte qenë e dëmshme për muslimanët (sepse qyteti zgjerohej).

Tema e pestë: Mundësia e ixhmait dhe themelimi i tij

- Nëse Ixhmai i ka plotësuar ruknet dhe kushtet e tij, siç treguam më parë, a mund të bëhet realitet?.

- Dhe pasi që praktikisht është e mundur, a mund të arrihet deri te ajo informatë? Dhe,

- Nëse është arritur informata, a ka ndodhur?

- E nëse veç ka ndodhur, a ekziston mundësia që të përcillet te ata, të cilët duhet ta argumentojnë të përcjellurën me njohuri të prerë?¹⁵⁰

Këto katër tema do t'i sqaroj edhe do t'i shtoj dy tema të tjera, e ato janë:

- Si e paramendojmë ixhmain në kohën e sotme? dhe,

- Ixhmai është i mundur të aprovohet në çdo gjeneratë!.

Kështu bëhen gjashtë tema, të cilat kanë Tema të tjera.

E para: Normalisht ixhmai është i mundur

Dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme në atë se si mund të themelohet ixhmai për një dispozitë, e cila nuk është e patjetërsueshme në fe. Disa kanë thënë, prej tyre Nidhami,¹⁵¹ disa Muëtezilë dhe disa shiit: **Zakonisht ixhmai është i pamundur të ndodhë.**¹⁵²

Ndërsa, shumica absolute e dijetarëve kanë thënë: **Është e mundur, pasi që normalisht mund të ndodhë dhe nuk është absurditet.**

Argumentimet: Dijetarët të cilët mendojnë se nuk është e mundur, pra mendimi i parë, argumentohet me sa vijon:

1. Dakordimi i të gjithë muxhtehidëve është i pamundur, siç është i pamundur që në të njëjtën kohë të hahet i njëjti ushqim dhe të flitet i njëjti fjalim.

Është replikuar me atë se dakordimi është i pamundur nëse janë të barabarta mundësitë, si f.v. ushqimi i njëjtë i caktuar me të folurit të njëjtë të caktuar. Ndryshueshmëria me të është e lejuar, pasi që ekziston ndryshimi në apetit dhe llojllojshmërisë së natyrshmërisë, këtu shkak i fton të gjithë njerëzit në atë mënyrë, mirëpo kur të peshojë mundësia e njërit ndaj tjetrit, nëpërmjet ndonjë argumenti ose shenje të qartë prej Ligjvënësit, nuk ka kurrfarë pengese që të mos ndodhë dakordimi. Kjo konsiderohet shkak i cili apelon për dakordim, nga shkak i dispozitës, e cila rezulton prej argumentit, nuk është pengesë që të bëhet dakordimi për atë ligj.

Nga kjo shihet se ka dallim në mes të asaj që është rezultat i nevojës fizike apo ndjenjës shpirtërore dhe çështjeve ideore (mendore) apo çështjeve materiale.

2. Normal, shpërndarja e dijetarëve lindje-perëndim është pengesë që t'u transmetohet të gjithë atyre dispozita për të cilën duhet dakorduar.¹⁵³ Nëse kjo është barrierë, atëherë edhe nuk mund të vijë deri te dakordimi.

Është replikuar me atë se në fillim të Islamit përcjellja e dispozitës të muxhtehidët ka qenë shumë e lehtë, sepse ata kanë qenë të paktë dhe të

përkufizuar në një vend; zakonisht nuk ka qenë kjo pengesë që ata të dakordohen.

Ndërsa, më vonë edhe pse ata janë shtuar, prapëseprapë ka qenë e mundur që t'u përcillet dispozita, sepse ata kanë qenë serioz në kërkimin e argumenteve dhe në zbulimin e dispozitave, gjë që ka qenë e lehtë të bëhet përcjellja e dispozitave dhe marrja e mendimeve të tyre. Ndërkaq, në kohën e sotme është edhe më e fuqishme që të mënjanohet ky dyshim, pasi që ekzistojnë mjete tjera të informimit e të ngjashme, si shtypi e gazetaria, të cilat lehtësojnë për të qarkulluar sa më lehtë në tërë rruzullin tokësor.

3. Dakordimi i muxhtehidëve për një dispozitë ose mund të jetë për një argument të prerë, që nuk lejon alternativë të interpretimit, ose të një argumenti jo të prerë.

Nëse është në pyetje e parapra që ixhmai të jetë argument i prere, nuk ka çka paramendohet ixhmai, ngase zakonisht e mendojnë se ai argument i tillë nuk mund të jetë i fshehur për ne. E, përderisa ai argument nuk na është përcjellur, tregon se nuk ekziston; po edhe nëse na përcillet, atëherë vetë ai argument është argument i dispozitës, e në atë rast nuk ka nevojë për Ixhmaë.

Nëse dakordimi ka të bëjë prej argumentit të pasigurt, gjithashtu zakonisht nuk mund të paramendohet ixhmai, nga shkak se ekzistojnë muxhtehidë të shumtë, ndryshon mentaliteteve i tyre, ndryshojn vizionet e tyre, ndryshojn përgatitjet e tyre në të pranuarit e të së vërtetës për shkak të përgatitjeve dhe mentaliteve të ndryshme për të pranuar të vërtetën dhe për shkak të kokëfortësisë në qëndrimin e mendimeve të tyre.

E gjitha kjo çka u tha, zakonisht është e pamundur që të dakordohen për një ligj dhe nuk mund të realizohet ixhmai. Ibn Hazmi thotë: Me bindje të thellë është vërtetuar se njerëzit ndryshojnë në qëllimet e tyre, në zgjedhjet e tyre, në mendimet e tyre dhe në natyrshmërinë e tyre, të cilat ndikojnë të zgjedhin atë që ata e dëshirojnë. E, kjo tregon se është e pamundur që të gjithë ata të dakordohen për të bërë obligues një ligj të njëjtë; pra, kjo për shkak të ndryshimit të apetiteve dhe ndryshimeve të tyre.

Sa i përket anës së parë, është replikuar me këtë argument: Dakordimi (ixhmai) bëhet për argument të sigurt, dhe është e natyrshme se

është e pamundur që të mos përcillet argumenti i sigurt vetëm nëse ekziston ndonjë nevojë, e pas aprovimit të ixhmait nuk ekziston nevoja të përcillet; sepse ixhmai është bërë i mjaftueshëm për të argumentuar një dispozitë, ngaqë është edhe më i fuqishëm.

Sa i përket anës tjetër të argumentit të tyre, është replikuar kështu: se dakordimi i tyre është për argument të pasigurt, e kjo nuk është pengesë që një grup i madh i njerëzve mund të dakordohet për një dispozitë, nga shkaku se ndonjëherë është i qartë, transparent, saqë mendimet nuk ndryshojnë dhe nuk paraqiten vizione të kundërta, por që ai grup i madh mund të dakordohet për diçka të dyshimtë dhe të pavlefshme me argument të sigurt dhe të prerë. Si f.v. dakordimi i krishterëve për trinitetin dhe dakordimi i tyre me jehuditë për të mos pranuar Pejgamberin s.a.v.s. pejgamber dhe po ashtu dakordimi i filozofëve për krijimin e botës e të ngjashme. Atëherë pra: dakordimi për argumentin e pasigurt, të cilin nuk e kundërshton argumenti i prerë, zakonisht ka përparësi që të ndodhë.¹⁵⁴

Përfundim: Të gjitha argumentet e mohuesve janë të pavlefshme para realitetit. Praktikisht veç ka ndodhur ixhmai me dispozitat të cilat nuk janë në fe si çështje të domosdoshme. E, ky është argumenti më i fuqishëm se logjikisht është e mundur të ndodhë. Ndodhia është argument, bile edhe më shumë se argument. Këtë e sqaron dijetari Amedij, duke sjellë shembuj: Aprovimi i ixhmait të sehaveve për t'i luftuar penguesit e zekatit, po ashtu ixhmai i tyre për të tubuar Kur'anin në mus'haf dhe për ndalimin e kamatës në gjashtë llojet e tij.

Kjo pra... Ixhmai i dy Haremeve sa i përket çështjes se ixhmai mund të aprovohet, ka bërë një dallim. Ai ka thënë se:

Ixhmai në çështjet e përgjithshme të fesë, të cilat janë të ndërlidhura me besimin, është i mundur.

Ndërsa, sa i përket çështjeve të menduara individualisht, zakonisht, as që mund të paramendohet që të ndodhë ixhmai, nga shkaku se individët (dijetarët) janë të shpërndarë në vende të ndryshme dhe mungojnë rrethanat dhe faktorët për t'i bashkuar që të jenë të dakorduar për një çështje.

Unë nuk shoh se ky dallim është i drejtë, nga shkaku se: çështjet e përgjithshme janë të njohura në fe me argumente të sigurta prej Kur'anit dhe

sunetit. Ndërsa, përpos kësaj është hapësira e mendimeve të ndryshme dhe ideve të kundërta.¹⁵⁵

E dyta: Publikimi dhe njohja e ixhmait

Zakonisht, nëse supozojmë se ixhmai ka ndodhur, se ekziston mundësia të publikohet dhe si kuptohet se ka ndodhur.

Disa dijetarë, e prej tyre Ahmed bin Hambeli (sipas një rivaeti prej tij) thotë: Nuk mund të kuptohet se ka ndodhur.

Ahmedi ka thënë: Kush thotë se ka ndodhur ixhmai, ai ka gënjyer, se është e mundur se kanë kundërshtuar, mirëpo ai nuk e di, sepse nuk është informuar për mendimin e kundërt. Por, ai le të thotë: Nuk di se ndokush ka kundërshtuar.¹⁵⁶

Argumenti i tyre është se ata bazohen në rrugën e sigurt të informimit. Ata thonë:

Ose mund të jetë njohuria konkrete, si f.v. ndjenja e urisë, e etjes, lodhjes, dhembjes,

Ose shijes. Pa kurrfarë dyshimi se kjo nuk është rrugë e njohurisë së ixhmait.

Ose: mund të jetë njohuria e mendjes, pra arritja e njohurisë nëpërmjet rrugës së logjikës. Edhe kjo rrugë nuk është e vlefshme për ixhmain, pasi që më nuk ka hapësirë të mendjes. Njohuria e çështjes se filani e tha këtë apo nuk e tha këtë, nuk është prej çështjeve të mendjes. Për këtë janë pajtuar të gjithë.

Ose: mund të jetë rrugë e ditorisë, pra rrugë e mendjeve. Po ashtu, edhe ndjenjat nuk janë çështje për ta kuptuar ixhmain, nga shkak se njohja e ixhmait bëhet duke dëgjuar thënien e muxhtehidit. E dëgjimi i ixhmait është shumë i vështirë (i pamundur), sepse duhet të dëgjohet çdo muxhtehid, pasi të arrij ditori, dhe të titullohet se është muxhtehid, si dhe që ta vërtetojë me personalitetin e tij. Dhe njohuria për muxhtehidët e umetit lindje-perëndim gjatë tërë jetës, nuk është e lehtë për asnjë njeri. Por, edhe nëse supozojmë se mund të arrihet kjo, duhet të dihet ai personalitet nga të gjithë

muxhtehidët se atë mendim që e jep, ai është mendim i bindjes së thellë të tij dhe se mendimi i tij peshon në atë çështje, e nuk është se vetëm për shkak të devotshmërisë së tij e pranon atë mendim apo dakordohet për atë mendim; po ashtu, duhet të dihet se të gjithë muxhtehidët vazhdojnë t'i përmbahen mendimit të tyre, deri sa të aprovohet ixhmai, duke u përmbushur prej të gjithë votuesve, pa hasur që ndonjëri është kthyer nga fetvaja e tij dhe ka marrë qëndrim tjetër.¹⁵⁷

Ebu Muslim el-Esfaniju thotë: Është e vërtetë se publikimi i ixhmait është i pamundur përpos ixhmait të sehabeve, të cilët kanë qenë si një trup. Ata kanë qenë dijetarë në një vend. Përderisa sot, pasi që Islami është përhapur në të gjitha anët dhe numri i dijetarëve është i shumtë, nuk mund që ata të dinë për çështjen e parashtruar. Ky është edhe mendimi i Ibni Tejmijes, dhe që e ka zgjedh Imam Ahmedin dhe Dhahirijët.

Shumica e dijetarëve mendojnë se: Është e mundur që të arrihet deri te informimi për ixhmain, ashtu që udhëheqësi t'i tubojë në një vend të caktuar, ose t'i dërgojë shkresa secilit prej tyre, që secili të japë mendimin e vet. Ose: që t'u bëjë ftesë, siç është rasti sot, kur shtetet Islame janë të ndara, dhe dijetarët janë shtetas të qeverive të atyre shteteve. Mendimet e tyre mund t'i paraqesin zyrtarisht. Imam Gazaliu thotë: Nëse përcaktohet numri i komisionit dhe i votuesve, ashtu siç mund të dihet mendimi i njërit prej tyre, mund të dihet edhe mendimi i dy personave, dhjetë personave dhe i njëzetëve.

Nëse kësaj ia shtojmë edhe atë që në të kaluarën ka qenë e mundur të dihet mendimi i muxhtehidëve. Ne veç kemi kuptuar mendimin e Shafijëve se nuk lejohet ekzekutimi i muslimanit për vrasjen e jomuslimanit në shtetin Islam. Ndërsa, Hanefijtë kanë gjykuar të kundërtën.¹⁵⁸ Ky është argument praktik, e nuk ka argument më të fuqishëm se argumenti praktik.

Disa dijetarë të Usulit kanë përmendur edhe një argument tjetër: Në kohën e sehabeve r.a. ka qenë e mundur të kuptohet qëndrimi i secilit, sepse kanë qenë të përqendruar në Hixhaz. Mirëpo, pas çlirimit të vendeve të ndryshme, kush ka shkuar në ato vende, ka qenë i ditur vendi i tij. Nëse supozojmë aprovimin e ixhmait prej joshabeve, atëherë edhe ai ixhmai është argument.¹⁵⁹

E treta: Aprovimi i ixhmait në praktikë

Nëse kemi arritur në pikën se ixhmai mund të aprovohet, mendimi i të gjithë muxhtehidëve është bërë i njohur, publikim i tij është bërë dhe informata ka arritur te të gjithë, atëherë parashtrohet pyetja: **A ka ndodhur ixhmai në praktikë?**

Shumica absolute e dijetarëve deklarojnë se kanë ndodhur ixhmae të sehavebe, por edhe prej të tjerëve.¹⁶⁰ *Shembull:*

Ixhmai se i takon gjyshes një e gjashta.

Ixhmai se është e ndaluar shitblerja e ushqimit pa qenë prezent.

Ixhmai për ndalimin e yndyrës së derrit, analog me mishin e derrit.

Ixhmai për detyrimin e dëmshpërblimit për uzurpuesin në masë të njëjtë, ose në kundërvlerë.

Ixhmai për shpallje të pavlefshme martesën e besimtares me pabesimtarin.

Ixhmai për shpalljen e kurorëzimit të vlefshëm, nëse nuk është caktuar mehri.¹⁶¹

Ixhmai se është e ndaluar mbajtja në kurorë në të njëjtën kohë gruan me tezen e saj, ose gruan me hallën e saj.

Ixhmai se është obligim “Ideti” për gruan, nëse vdes burri i saj.

Të gjitha këto kanë mbështetje në tekste të sheriatit.¹⁶² Për këtë nuk ka nevojë ndonjë analizë.

Përderisa sa i përket çështjeve të pastërta të Ixhmait, nuk mund të pretendohet me lehtësi për aprovim ixhmai, edhe pse ka shumë çështje e shumë mendime, për të cilat nuk dihet se ka mospajtime prej sehavebe, e as prej të tjerëve. Te shumica absolute e dijetarëve, kjo bën pjesë në ixhmain jo të sigurt. Përderisa sa i përket asaj se nuk ka pasur kundërshtim nga askush, ky është pretendim, i cili duhet të arsyetohet, vërtetohet dhe të sillet në tavolinë në mënyrë të sigurt. Ose duhet të thuhet: Ixhmai, për të cilin thonë, është themeluar në kohën e sehavebe, ka qenë një dispozitë e cila është rezultuar si rezultat nga konsultimi i një xhemati, e jo si rezultat i një mendimi personal. Duke u bazuar në këtë, shihet se definicioni i ixhmait, të cilin e kanë definuar shumica absolute e dijetarëve është: Dakordimi i të gjithë muxhtehidëve të Umetit të Muhamedit s.a.v.s. për një dispozitë të sheriatit, e nuk është të vërtetohet kjo me argument të sigurt, ku nuk mund

të ketë dyshime. E, posaçërisht pas epokës së sehabeve, nuk mund të aprovohet apo themelohet ixhmai. Por ka pasur ligjësime personale e jo të rezultuara prej konsultimeve. Për këtë arsye, kam thënë: Ixhmai për të cilin pretendojnë ata se është ixhmaë, që nëse kundërshtohet, kundërshtuesi nuk llogaritet i humbur, mëkatar e as pabesimtar. Esfehaniju thotë: Protokoluesi e di se nuk ka ndonjë dobi prej ixhmailt, përpos nëse e has të shkruar në ndonjë letër apo në ndonjë libër.

Ixhmai mund të pasqyrohet edhe në ligjësimin e dy kontraktuesve të një shoqërie aksionare. Janë dakorduar dijetarët për lejimin e tij, mirëpo kjo nuk është shkruar me ndonjë tekst të veçantë. Çdo gjë që ka të bëjë me këtë çështje është se njerëzit kanë vepruar në këtë mënyrë në kohën e Pejgamberit s.a.v.s., pastaj dijetarët e kanë pranuar dhe nuk ka kundërshtuar askush.

Nga kjo kuptojmë shprehjen e mëparshme të Ahmedit: “Kush thotë se ka ixhmaë, ai ka gënjyer, se ndoshta nuk janë dakorduar të gjithë njerëzit. Por, ai duhet të thotë: Nuk dimë se ndonjëri ka kundërshtuar,¹⁶³ pasi që nuk na është bërë njoftimi”. Thënia e këtij në këtë mënyrë nuk është se e ka mohuar ekzistimin e argumentit të ixhmailt, siç e kanë menduar disa, sepse ai nuk e ka mohuar ixhmain e sehabeve, por ka vepruar me atë ixhmaë; por këtë e ka thënë si kundërpërgjigje ndaj atyre që e transmetojnë ixhmain dhe thonë se ky është ixhmai, edhe pse nuk janë dakorduar të tjerët ta transmetojnë dhe ta publikojnë si ixhmaë.¹⁶⁴ Nëse ai mbetet i vetmuar, duke përcjellur ixhmain, është argument se ai është duke gënjyer, sepse ai ka thënë se është ixhmaë pa qenë ixhmaë dhe pa qenë i publikuar si ixhmaë.

Në librin “Risale” Ebu Jusufi nuk e ka pranuar pretendimin e Evzaijut se është aprovuar ixhmai për Lejimin e bashkëpjesëmarrjen në kuaj¹⁶⁵ dhe moslejimin e bashkëpjesëmarrjes në llojin e kuajve “Berdhunë”.¹⁶⁶ Kështu ka thënë edhe Imam Shafijju: Ajo çështje për të cilën nuk dihet se ka kundërshtuar ndokush, nuk thuhet se është ixhmaë. Ai, po ashtu, ka thënë: As unë nuk deklaroj dhe asnjë dijetarë nuk deklaron. Kjo është një çështje për të cilën të gjithë janë dakorduar, deri atëherë kur nuk takon më kurrë tjetër dijetarë, por ai duhet të deklarojë: Të parët kanë thënë si p.sh.: Namazi i drekës përbëhet prej katër rekateve; alkooli është i ndaluar e çështje të tjera të ngjashme. Ndërsa, nëse ndonjëri pyet: A është kjo ixhmaë?. Ai dijetar le të thotë: Po, falënderojmë Allahun, se në përgjithësi sa i përket farzeve nuk

dimë se ndokush ka dëgjuar se nuk janë farze. Ky është ixhmai për të cilin nëse deklaroj: Janë dakorduar njerëzit, asnjë rreth nesh nuk mund ta hasësh që ndonjëri të thotë: Jo ky nuk është ixhmai. Kush thotë se ixhmai është aprovuar në çështje të tilla, atij i besohet, sepse është rrugë e drejtë e aprovimit të ixhmait në çështjet parësore shkencore, por jo edhe në çështje sekondare, pra në çështjet joparësore. Përderisa për çështjet për të cilat thuhet se është aprovuar ixhmai, por që në kohën tënde për atë çështje veç ka pasur mospajtime, dhe që në të gjitha gjeneratat është thënë se ka pasur mospajtime nuk lejohet që të thuhet se është aprovuar ixhmaë?¹⁶⁷

Shihet qartë se në këtë mënyrë Shafiiju e përkufizon Ixhmain në Ixhmaë për të cilin nuk ka pasur mospajtime në një rreth shumë të ngushtë të çështjeve, pra në farze dhe baza të fesë, e jo në çështje të tjera. Po ashtu, me shprehjen e tij dhe me shprehjen e Imam Ahmedit shihet se: Mosdija se nuk ka kundërshtues të çështjes, nuk llogaritet se nuk ka kundërshtues.

Ibn Kajimi thotë: Ixhmai i cili është shpeshtuar, është ixhmai për të cilin nuk dihet se kanë kundërshtuar ata të cilët, pasi që e kanë pasur të parashtruar çështjen, janë dakorduar për dispozitën e asaj çështje, e nuk është e ditur se sigurisht në mënyrë të prerë se prej të gjithë muxhtehidëve ka ndonjë i cili ka kundërshtuar vendimin për atë dispozitë.

Për këtë arsye, nëse paraqitet një hadith i Pejgamberit s.a.v.s., duhet që të merret vendim i kundërt prej vendimit të mëparmë. Kjo është sikurse të kalohet prej ixhmait të paragjykuar në bazë të hadithit. Ibn Hazmi thotë: Ta dini se ai, i cili pretendon për këtë rast se ixhmai është përfundimtar në atë çështje dhe është dispozitë e prerë, është më injoranti në lëmin e dakordimit dhe mosdakordimit të njerëzve. Na mjafton Allahu: nuk ka mbrojtës më të mirë se Ai. Është gënjeshtër e atij i cili thotë për atë çështje, që nuk dihet se ka papajtueshmëri, është ixhmaë. Kërkojmë që Allahu i Lartmadhëruar të jetë i pajtuar me ne.¹⁶⁸

E katërta: Informimi i njerëzve për institucionin e Ixhmait

Nëse Ixhmai është aprovuar, a mund të bëhet apo nuk mund të bëhet informimi? Kjo për ata të cilët duhet të argumentohen me ixhmaë si argument i prerë?

Shiitët dhe Nidhamijtë thonë: Nëse presupozojë se ixhmai është aprovuar, si t'u përcillet kjo informatë atyre që vijnë pas ixhmait, që ata ta marrin si argument.

Këta mohojnë një gjë të tillë. Argumentet e tyre janë me sa vijon:

Mënyra e transmetimit të ixhmai bëhet:

ose mund të jetë nëpërmjet rrugës shumë të besueshme, nga një grup njerëzish,

ose nëpërmjet rrugës së besueshme, por vetëm nga një njeri.

Sa i përket rrugës së parë (mutevahir) është absurde (sepse “tevatur” do të thotë se është e pamundur që një grup i madh njerëzish të pajtohen që të gjithë për një gënjeshtër). Patjetër, lindje e perëndim duhet që të gjithë muxhtehidët të prezantojnë, të dëgjohen mendimet e tyre, e pastaj t'i informojnë në mënyrë të besueshme të tjerët që vijnë pas tyre, e pastaj ajo informatë, për atë vendim, të përcillet gjeneratë pas gjenerate që të arrij te ata, të cilët duhet të argumentojnë me atë vendim. Shihet qartë se kjo është e pamundur.

Sa i përket rrugës së një informacioni, një informacion është i pavlefshëm në përcjelljen e ixhmait, nga shkak se një informacion nuk ngërthen në vete siguri, bindje dhe dituri të plotë, kur dihet se argumentimi i ixhmait është argumentim i sigurt. E, siguria e tij e humb vlerën kur të përcillet me argumentin e një informacioni, i cili është argument jo i sigurt. Kështu, konvertohet në dispozitë të pasigurt vetëm në bazë të mbështetjes së ixhmait në argument të pasigurt.

Shihet qartë se nuk ka ndonjë rrugë e cila tregon siguri dhe garancion për plotësimin apo përmbushjen e rrugës së ixhmait, nga shkak se Ixhmai është argument i sigurt, andaj edhe rruga e tij duhet të jetë e sigurt.¹⁶⁹

Sa i përket pjesës së argumentit, kundërpërgjigjia është se: udhëheqësi mund t'i tubojë të gjithë muxhtehidët, posaçërisht siç ka qenë në

kohën e sehavebe, ku numri i tyre ka qenë shumë i vogël dhe kanë qenë të përqendruar në një vend. Kështu, pra, ka qenë e mundur që të plotësohen mendimet e tyre në mënyrë të besueshme, gjeneratë pas gjenerate, dhe kështu ka mundur të depërtojë deri te ata, të cilët kanë dashur të argumentojnë me atë ixhmai. Kështu na është përcjellur neve ixhmai që Ebu Bekri të emërohet “Halife” dhe po ashtu edhe ixhmae të shumë çështjeve tjera.¹⁷⁰

Sa i përket pjesës së dytë të argumentimit, Mavrudiju, Imam Haremejni, Ahmediu dhe Ibn Haxhibi janë kundërpërgjigjur kështu: Analog me transmetimin e sunetit nuk është kusht edhe në transmetimin e ixhmait.¹⁷¹ Që të dyja, edhe suneti, edhe ixhmai, janë argumente me të cilat duhet të veprohet. E, nuk mund të veçohet cilësia e besueshmërisë së një grupi të njerëzve për ta transmetuar Ixhmain. Këtë mendim e ka përkrahur edhe Ibn Bedran, dijetar Hanbelij dhe shumica e Hanefijëve.¹⁷²

Një pjesë e dijetarëve thonë: Numri i transmetuesve është kusht, nga shkaku se ixhmai është argument i prerë, me të gjykohet për librin e Allahut dhe sunetin mutevatir, ndërsa informacioni i vetëm (haberul vahid) nuk është argument i prerë; e si mund të vërtetohet argumentin e prerë.¹⁷³

Me një fjalë, Ahmediu tregon se esenca e mospajtueshmërisë në këtë çështje kthehet në mospajtueshmërinë e mëhershme. E, mospajtueshmëria ka qenë në atë se: Mbështetja e ixhmait a është e njëjtë, pra argument i pasigurt, sikurse analogjia dhe informacioni i vetëm (haberul vahid).?

Kush e ka pranuar analogjinë dhe informacionin e vetëm, ai e pranon edhe bazën e ixhmait. E,

Kush nuk i ka pranuar, ai nuk e pranon informacionin e vetëm si transmetues të ixhmait.

Mua më duket se përpos ixhmait të sehavebe nuk ka transmetim të ixhmait në mënyrë të besueshme nga një numër i madh transmetuesish (tevatur), ku qëndrimet i shoh se janë shumë të përafërta ndërsa mospajtueshmëria rritet te ixhmai i josehavebe, pra ixhmai i gjeneratave tjera përpos gjeneratës së parë.

E pesta: Si e paramendojnë modernistët institucionin e ixhmait?

Deklarimet e dijetarëve modernë bëjnë të ditur se ixhmai në formën si e paraqesin dijetarët e hershëm të Usulit në realitet është inekzistent, por në të vërtetë është një pasqyrim teorik, e jo edhe praktik, sa i përket çështjeve të ixhtihadit praktik paramendues, përderisa sa i përket dispozitave të prera është realitet dhe e qartë, siç e ka deklaruar edhe Imam Shafiju.

Ky është edhe mendimi im.

Profesori ynë, Shehj Ebu Zehra thotë:¹⁷⁴ Sa më përket mua, argumentimi në tërësi me ixhmain ka qenë në kohën e sehabeve r.a., të cilët nuk kanë qenë të shpërndarë në rajone. Atëherë ka qenë i mundur ixhmai, e më vonë gjenerata e tabiinëve është shpërndarë. E, në atë kohë ka qenë i vështirë ixhmai, edhe pse nuk ka qenë i pamundur (absurd). Për këtë arsye, vetëm se përpak nuk pajtohen dijetarët për një çështje prej çështjeve që sehabet janë dakorduar:

Disa thonë se është aprovuar ixhmai në ato çështje,

Të tjerët refuzojnë se është aprovuar.

Nuk është larg realitetit ai i cili thotë: Nuk dihet se është aprovuar ixhmai tjetër, përpos ixhmait të sehabeve. Në këtë pajtohen që të gjithë dhe e pranojnë këtë mendim. Imam Ahmed bin Hanbeli, për ndonjë çështje që mendon se është aprovuar ixhmai, ka thënë: “Nuk dimë se ka kundërshtuar ndokush”.

Mendimi im vetëm përpak se përputhet në tërësi me mendimin e Imam Ahmedit.¹⁷⁵

Dijetari Shehj Hudariju sferën e ixhmait e ka ngushtuar edhe më shumë. Ai e ka përkufizuar me ixhmain vetëm në kohën e dy halifeve dhe atë në kohën e Ebu Bekrit dhe Umerit në Medinë. Ai ka thënë: Gjenerata e parë ndahet prej dy epokave dalluese nga njëra-tjetra:

E para është epoka e dy shejhave, pra epoka e Ebu Bekrit dhe e Umerit në Medinë. Muslimanët në këtë kohë që të gjithë kanë qenë unik dhe dijetarët kanë qenë të identifikuar. Prijësi i tyre ka qenë parlamentar, prijësi i tyre nuk ka dhënë fetva pa u konsultuar me to, kështu që është e mundur që të kuptohet mendimi i të gjithëve dhe të pasqyrohet lehtë ixhmai i tyre.

Atëherë parashtrohet pyetja: A është se me të vërtetë janë dakorduar në të njëjtin mendim (fetva), nëse u është paraqitur një çështje, nëse ajo çështje ka qenë prej çështjeve të ixhtihadit?. Përgjigjia në këtë është se gjatë kësaj epoke ka pasur shumë çështje në të cilat nuk ka pasur mospajtime. Kjo është ajo që mund të gjykohet për atë kohë, përderisa sa i përket pretendimit se të gjithë ata kanë dhënë mendime dhe mendimet e tyre kanë qenë përputhëse dhe të vërtetohet se nuk ka pasur kundërshtime në ato mendime, kjo është çështje që duhet të analizohet dhe të sillen argumente për ta vërtetuar.

Përderisa, pas kësaj kohe, koha në të cilën është zgjeruar shteti Islam dhe fukahatë janë shpërndarë në rajone të ndryshme dhe janë profesionalizuar fukaha të tjerë prej tyre, që numri i saktë i tyre nuk është i identifikuar, por është i shumtë, dhe që kanë ndikuar kriza politike, mospajtimet politike dhe apetitet e llojllojshme, nuk mendojmë se ka mundur të aprovohet ixhmai, sepse vështirë se mund të pranohet një gjë e tillë, edhe pse mund të pranojmë faktin se edhe në këtë kohë ka pasur çështje të shumta për të cilat nuk dihet se ndokush i ka kundërshtuar ato.

Profesor Halafi thotë:¹⁷⁶ Si definicion prioritar e shoh ixhmain me definicionin dhe kushtet, të cilat i kemi sqaruar; zakonisht nuk mund të aprovohet ixhmai, nëse u lihet në kompetencë vetëm individëve të umetit Islam dhe popujve të vendeve islame. Por, mund të aprovohet ixhmai nëse u lihet në kompetencë qeverive Islame, që ajo qeveri të ketë të drejtë ta kundërshtojë. Çdo qeveri mund t'i caktojë kushtet që duhet t'i ketë muxhtehidi të informojë personin, i cili ka arritur gradën e ixhtihadit, dhe të certifikojë personin, i cili i ka plotësuar ato kushte. Në këtë mënyrë, çdo qeveri mund t'i identifikojë muxhtehidët e vet dhe të dijë mendimet e tyre për çdo ngjarje. Nëse çdo qeveri merr vendimin e muxhtehidëve të vet për një çështje dhe bëhet unifikimi i mendimeve të të gjithë muxhtehidëve të të gjitha qeverive Islame për një vendim të njëjtë për atë çështje, kjo quhet ixhmaë. Atëherë, ligjërisht bëhet vaxhib që të zbatohet ai vendim nga të gjithë muslimanët.

Pastaj, profesor Halafi e ka mohuar se mund të ndodhë ixhmai në praktikë dhe ka thënë: Kush kthehet në ngjarjet, për të cilat kanë gjykuar sehabet, dhe e konsideron se ka qenë ixhmaë, në të vërtetë e kupton se nuk ka qenë ixhmaë në kuptimin e fjalës. Ajo çka është gjykuar ka qenë dakordim i udhëheqësve dhe i inteligjencës, e cila ka qenë prezent për një

çështje që është paraqitur. Në të vërtetë, ka qenë një vendim, i cili ka rezultuar si rezultat i konsultimit të një xhemati¹⁷⁷ e jo si rezultat i një individi.

Tregohet se kur Ebu Bekrit i janë paraqitur dy të ngatërruar për një çështje dhe nuk ka gjetur zgjedhje në librin e Allahut, as në sunetin e të dërguarit të Allahut, i ka tubuar më të mirët, më të specializuarit dhe është konsultuar me ta; nëse janë unifikuar për një vendim, ai vendim është fuqizuar. Kështu ka vepruar edhe Umeri r.a. Nuk ka dyshim se më të mirët dhe më inteligjentët, të cilët i ka tubuar Ebu Bekri, në kohën kur u është paraqitur çështja për të zgjidhur një konflikt, nuk kanë qenë që të gjithë më të mirët dhe më të specializuarit (e asaj kohe), sepse një numër i madh i tyre ka qenë në Meke, një numër tjetër në Siri, Jemen dhe në fushëbeteja.

E, ajo çka thuhet se kur ka pasur çështje konflikti, Ebu Bekri Sidiki e ka shtyrë afatin e zgjedhjes së çështjes deri sa është bërë unifikimi i mendimeve të të gjithë muxhtehidëve shabe nga të gjitha anët. Nuk është e saktë, por e vërteta është se ai ka marrë vendim në bazë të mendimit të atyre që kanë qenë prezentë, sepse ato kanë qenë xhematë. Mendimi i xhematit është më i drejtë se sa mendimi i individit. Në të njëjtën mënyrë ka vepruar edhe Umeri. Dijetarët këtë e kanë quajtur ixhmaë, por në fakt është ligjësim prej një xhemati, e jo prej një individi. Kjo mënyrë haset vetëm te shabet dhe në disa pjesë të kohës së Umevijinëve në Spanjë, atëherë kur, në shekullin e dytë të hixhretit, dijetarët kanë diskutuar për të ligjësuar ndonjë vendim. Në shumë libra hasim se dijetarët në Spanjë e kanë zbatuar sistemin parlamentar.

Përderisa, pas kohës së shabeve, dhe pas epokës së dinastisë Emevite në Spanjë, nuk ka aprovim të ixhmait dhe nuk ka ndodhur ixhmai i shumicës së muxhtehidëve për të ligjësuar ndonjë ligj dhe nuk ka rezultuar ndonjë ligj prej ndonjë xhemati, por, në mënyrë të pavarur, secili muxhtehid, me angazhimin e tij individualisht në shtëpinë, në vendin e tij, jep mendim privat.

Kështu, ligjësimi është bërë në mënyrë private, e jo në formë parlamentare. Mund të ndodhë pajtimi i mendimeve, por edhe mospajtimi i tyre. Të paktën që mund të thotë fekihi është që të deklarojë: Sa i përket dispozitës së kësaj çështjeje, nuk di se ndokush ka kundërshtuar.

E gjashta: Institucioni i ixhmait mund të aprovohet në çdo gjeneratë

Profesor Bedrani¹⁷⁸ mendon se ka lloj të ixhmait i cili mund të aprovohet në secilën gjeneratë, e ai është: Dakordimi i udhëheqësve të umetit për dispozitën e një çështjeje, e cila dispozitë nuk është e tekstualizuar as në Kur'an, as në sunet, gjë që sipas mendimit tim nuk është asgjë tjetër përpos një fushë e pajtueshmërisë së Umetit për çështje të kësaj bote, të cilat çështje ndryshojnë me ndryshimin e kohërave dhe vendeve, si f.v.: Ixhmai për emërimin e umetit, ose shpallja luftë armikut, ose caktimi i çmimit më të lartë të tokave bujqësore, nëse ato prona janë interes kombëtar.

Ky lloj i ixhmait nuk është specifikë e një gjenerate prej gjeneratave, por është specifikë e të gjitha gjeneratave, nga shkaku se mjetet e njerëzve për interesin e tyre të kësaj bote ndryshojnë me ndryshimin e kohëve dhe vendeve. Kërkohet prej umetit që të kërkojë prej udhëheqësve se cilave çështje t'u jepet prioritet, duke zbatuar thënien e Zotit të Lartmadhëruar: **“Dhe konsultohu me ta për çështje.” (Ali Imran,159)** dhe thënien tjetër të Zotit të Lartmadhëruar: **“Dhe çështja e tyre është se ata konsultohen mes vete.” (Esh-Shura, 38).** Aprovim i këtij lloji të ixhmait nuk varet me dakordimin e të gjithë prijësve të umetit. Këtë e themi duke u bazuar në atë që është transmetuar nga Ibni Xheriri, Ebu Bekri, Raziu dhe prej Ahmed bin Hanbelit në një prej dy transmetimeve të tij se: Është bërë besatimi (emërimi) i Ebu Bekrit nga ixhmai i umetit, edhe pse Aliu r.a. ka kundërshtuar. Umeri r.a. është konsultuar me rrethin e tij që të evakuohej ushtria, pasi që ishte përhapur kolera në vendet e çliruara të Sirisë. Ebu Bekri dhe Umeri, sa i përket çështjeve administrative dhe gjyqësorit, janë konsultuar me profesionistët e asaj fushe në të cilën paraqitej çështja.

Sipas mendimit tim, e vërteta është se për këto çështje politike e të ngjashme, nuk ka nevojë për ixhmain, sepse nuk janë të llojit për të dispozituar një ligj për të cilën po flasim

Pas ixhmait të mëhershëm a mund të aprovohet institucioni tjetër i ixhmait?

Kjo është tema e fundit e analizës së ixhmait, e kjo temë është: Nëse një gjeneratë dakordohet për një dispozitë (ligj), a mund të aprovohet një ixhmaë tjetër, i cili është krejtësisht i kundërt me ixhmain e mëparshëm?.

Për këtë çështje dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme.

Shevkaniju¹⁷⁹ dhe të tjerët transmetojnë analizën e këtyre mospajtimeve me sa vijon:

a. Mosdakordimi në dispozitë: Ixhmai i dytë mund të jetë i njëjtë me të dakorduarve të ixhmait të parë, ose mund të jetë prej gjenerate tjetër.

Sa i përket rastit të parë, si f.v.: dijetarët e një gjenerate dakordohen për një dispozitë, mirëpo më vonë paraqitet diçka që të dakordohen për diçka krejt ndryshe nga e para. A lejohet apo nuk lejohet të kthehen nga mendimi i parë i tyre. Mospajtimi në lidhje me këtë është i njëjtë me mospajtimin të cilin e kemi cekur më parë te kushtet e skadimit të afatit të një gjenerate të ixhmait dhe aprovimi i ixhmait të një gjenerate tjetër.¹⁸⁰

Shumica absolute e dijetarëve, të cilët e kushtëzojnë skadimin e gjeneratës së të dakorduarve, mendojnë se: Ixhmai i dytë nuk lejohet që të aprovohet dhe është i pavlefshëm, nga shkaku se ixhmai i parë veç është aprovuar. E, pasi që veç është aprovuar, është bërë argument i prerë dhe i garantuar dhe nuk lejohet të anashkalohet.

Disa prej dijetarëve, të cilët e kanë kushtëzuar skadimin e gjeneratës, e lejojnë aprovimin e ixhmait të dytë, nga shkaku se, sipas mendimit të tyre, ixhmai i parë ende nuk është fuqizuar si argument i prerë dhe i garantuar, i cili nuk lejohet të anashkalohet, nga shkaku se nuk ka skaduar gjenerata.

Sa i përket rastit të dytë, është kur të aprovohet ixhmai i dytë, por jo prej të dakorduarëve të ixhmait të parë. Siç shihet qartë, nuk mund të ndodhë pa skaduar afati i ixhmait të gjeneratës së parë. Edhe për këtë dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme.

Shumica absolute e dijetarëve mendojnë se nuk lejohet të ndodhë kjo, nga shkaku se vjen deri te ndeshja e dy njësive të ixhmait për të njëjtën dispozitë. E, kjo nuk është e drejtë, nga shkaku se njëra prej tyre është në të drejtë, ndërsa e dyta në të padrejtë. E drejta është një, e jo e shumënumërt. Imam Gazaliu thotë: Ajo çka është unifikuar nëpërmjet ixhtihadit, nuk mund të kundërshtohet pastaj jo vetëm pse ai ixhmaë është i drejtë, por nga shkaku se është i drejtë për të cilin është dakorduar i gjithë Umeti. Umeti është dakorduar se për çdo çështje që është dakorduar umeti, nuk lejohet të kundërshtohet, e nuk është një e drejtë të cilën e mendon vetëm ndonjë individ. Me këtë, Gazaliu mendon se nëse ndodh ixhmai i dytë, atëherë vërtetohet se Umeti është dakorduar më herët për diçka të padrejtë dhe të gabuar. E, kjo nuk lejohet të ndodhë, pasi që janë transmetuar shumë hadithe, të cilat tregojnë për pagabueshmërinë e umetit. Për këtë, natyra e ixhmait, si argument, nënkupton moslejimin e aprovimit të një ixhmai tjetër, i cili është në kundërshtim me ixhmain e parë.

Disa dijetarë, e prej tyre Abdullah el Basriu dhe Raziu mendojnë se: Lejohet që të aprovohet ixhmai tjetër, pasi që mund të ndodhë që të tjerëve t'u paraqitet ndonjë argument, i cili patjetër duhet të merret parasysh që të dispozitohet dispozita në kundërshtim me dispozitën e parë. Kështu që ixhmai i parë është argument, i cili nuk pengon që të aprovohet ixhmai i dytë në kundërshtim me të. Mund të paramendohet ixhmai si argument deri në një afat, e ai afat është deri te aprovimi i ixhmait tjetër. E, kjo nuk do të thotë ndeshja e ixhmait me veten e tij.

Këtë mendim e kanë preferuar disa profesorë të mi të nderuar, nga shkaku se motivi është se këtu ixhmai i dytë e shfuqizon të parin. E, shfuqizimi është i lejuar për argumentin, i cili argumentohet nëpërmjet ixhtihadit pas ndërprerjes së shpalljes, që do të thotë se dispozita e së cilës nuk llogaritet domosdoshmëri në fe. Domosdoshmëria në fe është rruga e cila nuk ka nevojë për analizë dhe ixhtihadë, pra është dispozitë nga teksti i kristalizuar, ose që është transmetuar besueshmërisht, ashtu që nuk vë pikë dyshimi në dispozitimin e ixhmait.

Sa i përket kundërshtimit në mes të ixhmait të parë me të dytin, kjo është çështje presupozuese, e çështjet presupozuese janë çështje të analistëve. Pastaj, vazhdimi i zbatimit të ixhmait të parë pas paraqitjes së

argumentit të kundërt, nuk e pranon logjika e shëndoshë, sepse në ligjet e sheriatit në rend të parë është Kur'ani, pastaj suneti. Këtë e kanë deklaruar të gjithë muxhtehidët. Që të gjithë kanë deklaruar: Nëse hadithi është autentik, ai është edhe mendimi (drejtimi) i im. Kur t'u sillet juve hadithi, atëherë fjalën time përplaseni për muri.

Sipas parashikimeve të mia, pas aprovimit të ixhmait paraqitja e argumentit të ri është e paarritshme. Kjo është vetëm çështje teorike, e jo praktike. Drejtimi i shumicës absolute të dijetarëve është i drejtë, nga se ata besojnë në faktin se është e pamundur që umeti të sjellë argument të drejtë, e pastaj dikush tjetër t'ua tërheqë vërejtjen.

Shumica absolute e dijetarëve deklarojnë: Vërtet, Zoti i Lartmadhëruar e ka siguruar umetin që të mos harrojë një çështje prej çështjeve. Po mos të ishte kjo kështu, atëherë ixhmai do të dilte nga korniza që të jetë argument i prerë (i sigurt).¹⁸¹

b. Mosdakordimi në interpretimin e tekstit. Nëse një ixhmaë nuk dakordohet me ixhmain tjetër jo në dispozitë, por në interpretimin e një teksti të njohur për dy gjenerata, gjenerata e ixhmait të parë dhe ixhmait të dytë, në këtë rast lejohet që ixhmai i dytë të interpretojë tekstin ndryshe nga ixhmai i parë, mirëpo me dy kushte:¹⁸²

Kushti i parë: Që interpretimi të mos e kundërshtojë dhe të mos e zhvleftësojë interpretimin e ixhmait të parë, i cili ka dispozituar atë ligj, si f.v.: Fjalinë dykuptimëshe ta interpretojë vetëm në njërën prej dy kuptimeve. Nuk lejohet që gjenerata e mëvonshme të interpretojë kuptimin e kundërt nga gjenerata e parë. Esneviu thotë: Nëse një gjeneratë e përmend apo argumentohet me interpretimin e një hadithi, e gjenerata tjetër e përmend një argument tjetër, por pa e nënvlerësuar të parin, është e lejuar.

Kushti i dytë: Që gjenerata e dytë të mos dispozitojë për të zhvleftësuar interpretimin e gjeneratës së parë, sepse kjo do të na shpinte në gabueshmërinë e umetit, për çka ixhmai është aprovuar se umeti është i pagabuar.

Shfuqizimi i ixhmait

Më herët në fusnotë kam treguar se ixhmai as nuk shfuqizon e as nuk shfuqizohet. Kështu kanë deklaruar dijetarët e Usulit.¹⁸³ Kjo nga shkaku se shfuqizimi ka qenë prezent vetëm në kohën e zbritjes së shpalljes. Pra, vetëm në kohën e Pejgamberit s.a.v.s., e pas tij nuk ka shfuqizim të ligjeve. Në këtë formë shihet specifika e qëndrueshmërisë së ligjeve të sheriatit dhe se ato janë të përgjithmonshme.

Ai i cili presupozon shfuqizimin e Ixhmait ka për qëllim vazhdimin për dispozitë fillestare të sheriatit.

Kështu, pra, tekstet Kur'anore dhe të sunetit nuk mund të shfuqizohen me ixhmaë, nga shkaku se nëse ixhmai është argument i siguruar dhe i prerë, ixhmai nuk mund të aprovohet në kundërshtim të tij.

Përderisa, sa i përket shfuqizimit me ixhmaë të kategorisë së të drejtës së zekatit për “përfitim të zemrave”, i cili është tekst Kur'anor, në kohën e Umerit r.a., kjo nuk është e vërtetuar, nga shkaku se nuk është arritur ixhmai për një vendim të tillë nga të gjithë muxhtehidët. Po ashtu, edhe për atë se afati i shfuqizimit ka përfunduar me vdekjen e Pejgamberit s.a.v.s. Nuk ka shfuqizim ligjesh pas përfundimit të shpalljes. Atë që e ka kuptuar Umeri, e ka kuptuar në atë mënyrë qëllimin e tekstit, pasi që në atë kohë (të shpalljes) ka qenë koha e përvetësimit të zemrave dhe është zbatuar ai ligj (vendim). Po të paraqiteshin të njëjtat rrethana në kohë të sotme, prapë do të zbatoheshin i njëjti ligj. Kështu kanë deklaruar shumica e muxhtehidëve, e kështu ka vepruar edhe Umer ibn ul Azizi dhe të tjerët. Atëherë kur nuk është nevoja për përfitim të zemrave, për shkak të forcimit të Islamit dhe myslimanëve, dhe arrihet superfuqia, siç ka qenë çështja në kohën e Umerit, nuk i jepet zekati kategorisë së “përfitimit të zemrave”. Kjo si shenjë se Islami nuk ka nevojë për të dhe pasi që zemrat e muslimanëve janë të përforcuara.¹⁸⁴

Po ashtu, nuk shfuqizohet ligji i ixhmait prej një ixhmai tjetër, nga shkaku se kur të aprovohet, ligji i ixhmait gradohet në shkallën e ligjit të sigurt dhe nuk lejohet të kundërshtohet dhe nuk mund të anashkalohet nga ndonjë ixhmaë tjetër. Kështu kanë deklaruar shumica absolute e dijetarëve të Usulit. Po ashtu, pasi që ixhmai i parë është i sigurt, ixhmai i dytë nuk guxon të prekë në argumentin e sigurt. Është i pamundur anashkalimi i ixhmait. Ajo çka është e pamundur të arrihet deri te e pamundura, edhe ajo është e pamundur. Nëse Ixhmai i parë është i pasigurt, e ixhmai i dytë e kundërshton, atëherë del në pah se ixhmai i parë nuk ka qenë argument dhe

prapë, në fakt, nuk ka qenë shfuqizim dhe se nuk mund të jetë në mes të dy argumenteve, atij të pasigurt (ixhmait të parë) dhe atij të sigurt (ixhmait të dytë).

E kam sqaruar më parë se nëse mbështetja (baza) e ixhmait është argumenti i meslehatul murselit, nëse paraqitet mesleha (interes i përgjithshëm) tjetër, lejohet që ixhmai i mëvonshëm të shfuqizojë ixhmain e mëhershëm.¹⁸⁵

Tema e gjashtë: Kushtet e Ixhmait

Sa i përket kushteve të ixhmait, nuk ka nevojë që ta zgjas shumë temën,¹⁸⁶ sepse ato mund të kuptohen gjatë paraqitjes së analizës së ixhmait. U pa qartë se kusht është që ixhmai të jetë i ndërtuar mbi bazën e Kur'anit, sunetit dhe Kijasit. Që të gjithë muxhtehidët të dakordohen në të njëjtën kohë për dispozitën, dhe atë, ose deklarativisht, ose në formë mbështetje, me shenja të cilat tregojnë dakordimin.

- Nuk kushtëzohet skadimi i gjeneratës (pra vdekja e të dakorduarve).

- Nuk kushtëzohet të jetë një numër i caktuar (tevatur).

- Nuk merret parasysh mendimi i njerëzve të rëndomtë dhe as mendimi i një profesionisti të një lëmi tjetër, e jo lëmisë përkatëse. Kjo nga shkak se mendimi i tyre është i paargumentuar, se natyrshmëria e tyre nuk ka aftësi për të argumentuar. E, mendimi pa argument është i pabazë dhe i gabueshëm. Ixhmaë i drejtë është ixhmai, në të cilin dakordohen profesionistët e një lëmi, të cilët janë të specializuar dhe janë ekspertë të atij lëmi të asaj kohe.

- Nuk lejohet që të pasohet mendimi i shumicës së dijetarëve, sepse mendimi i tyre nuk është argument.

- Nuk kushtëzohet që për çështjen e parashtruar të mos ketë pasur mospajtime në të kaluarën, sepse e kaluara ka qenë koha e hulumtimit dhe e analizave. Këtij mendimi i kam dhënë prioritet pak më herët.

Duke ia shtuar kushteve, që i përmendëm, të cilat janë kushtet e dakordimit të muxhtehidëve, kushtet e ixhmait mund të jenë me sa vijon:¹⁸⁷

1. Që dakordimi të jetë prej muxhtehidëve, të cilët janë të drejtë dhe janë të larguar prej bid'ateve. Kjo nga shkak se tekstet, të cilat tregojnë për argumentimin e ixhmait, e tregojnë një gjë të tillë. Sa i përket atributit të drejtësisë, dihet se dispozita e Ixhmait (që është ligj i detyruar) vendoset sikurse merret vendimi në bazë të dëshmisë, e dëshmitarit i merret për bazë dëshmia, nëse është i drejtë. Kjo shihet qartë në Kur'anin fisnik, ku Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَأَشْهَدُوا ذَوِي عَدْلٍ مِّنكُمْ

“Dhe le të dëshmojnë dy dëshmitarë të drejtë prej jush.” (et-Talak, 2)

2. Largimi prej bid'ateve. Nga shkaku se nëse bid'ati konsiderohet pabesim, atëherë bid'atqiu është pabesimtar. Mirëpo, edhe nëse nuk cilësohet pabesimtar, por që e praktikon, atëherë cilësia e drejtësisë zhvishet prej tij për shkak të fanatizmit të padrejtë, i cili nuk ka mbështetje në argument. Për këtë arsye, mendimi i tij nuk merret për bazë në ixhmain e umetit. Për këtë arsye, nuk merret parasysh mospajtimi i Rafidijëve që dy shejhat të emërohen Halife, e as mospajtimi i Havarixhëve në emërimin e Aliut Halife.

3. Pasi që ixhmai ka të bëjë me dispozitat, të cilat mund t'i shpjegojnë të specializuarit dhe të diturit, kushtëzohet edhe ixhtihadi i muxhtehidit, si f.v. shpjegimi i detajeve dhe të dispozitave të namazit, kurorëzimit, shkurorëzimit, i shitblerjes. Pra, merret parasysh mendimi dhe pajtimi i dijetarëve, e nuk merret parasysh mospajtimi i të tjerëve.

4. Prej kushteve për të cilat nuk janë pajtuar dijetarët është edhe cilësia që muxhtehidët të jenë vetëm prej shabeve. Këtë kusht nuk e kanë pranuar shumica absolute e dijetarëve.

5. Prej kushteve për të cilën nuk janë pajtuar dijetarët është edhe cilësia; që muxhtehidët të jenë prej farefisit të Pejgamberit s.a.v.s. dhe rrethet e tij të ngushtë (utres). Këtë kusht e parashohin Zejdijët dhe Imamijët.

6. Prej kushteve për të cilën nuk janë pajtuar dijetarët që ixhmai të jetë vetëm prej banorëve të Medinës. Këtë kusht e parasheh Imam Maliku.

7. Prej kushteve për të cilën nuk janë pajtuar dijetarët është skadimi i gjeneratës së muxhtehidëve të cilët janë dakorduar. Këtë kusht e parasheh Imam Ahmedi dhe të tjerët që janë pajtuar me të.

8. Prej kushteve për të cilën nuk janë pajtuar dijetarët është që për atë çështje për të cilën janë dakorduar muxhtehidët, të mos ketë pasur mendim ndryshe prej dijetarëve të gjeneratës së parë (selefit). Këtë kusht e parasheh Shafiiu dhe në përgjithësi mhadithinët, ndërsa shumica e Usulijinëve nuk e parashohin këtë kushtë.

Si e pasqyrojnë orientalistët ixhmain?

Orientalistët, kur flasin për ixhmain, përgënjeshtrojnë, ato japin kuptime iluzioniste. Qëllimi i tyre është shtrembërimi i fakteve, përgënjeshtrimi i ideve Islame dhe mashtrimin e njerëzve se dijetarët Islam kanë mundësi t'i ndryshojnë ligjet e sheriatit, ashtu siç veprojnë priftërinjtë në krishterizëm.

Një orientalist i quajtur Gold Cihir thotë: “Pa kurrfarë dyshimi shihet se ixhmai ka kompetencë dhe fuqi që ta bëjë Islamin që të reformohet dhe të zhvillohet”. Ai mendon se ixhmai ka rol të madh dhe ka pozitën më të lartë. Ai dhe të tjerët iluzionojnë se çdo ixhmaë aprovohet pa shikuar tekstet (Kur'an dhe sunet) dhe e kanë ngritur në nivel më të lartë se tekstet dhe se njerëzit kanë mundësi të shpikin besëtytni, ligje dhe çështje të tjera, në bazë të ideve të tyre, e pastaj të unifikohen në ato ide. Ata thonë: Duke falënderuar ixhmain, ajo çka ka qenë risi në fillim dhe të pranuar të shfuqizohen më pastaj. Shembull: Ndërmjetësimi me pejgamberë, në praktikë është bërë pjesë e sunetit. Pagabueshmëria e umetit, e cila është ligjësuar prej vet Ixhmait, Kjo në të vërtetë është shtrembërim i teksteve të qarta të Kur'anit. Ose: edhe bindja se pejgamberi është i pagabueshëm, ka bërë që ixhmai të lajthitë nga tekstet e qarta të Kur'anit. Ata thonë: Ixhmai nuk është angazhuar vetëm për çështjet të cilat nuk kanë qenë prezente apo të iniciuara më herët, por edhe i ka ndryshuar rrënjësisht besimet bazore të qarta. Nga ky aspekt, shumica e muslimanëve dhe jomuslimanëve, ixhmain e konsiderojnë prej mjeteve të reformimit, me Islamin mund të bëjnë çka të dojnë dhe si të dojnë, me kusht që të jenë të unifikuar dhe se muxhtehidët kanë të drejtë të vendosin ligj në bazë të mendimeve të tyre, për shkak se janë të graduar në dituri. Ky është opinionin e orientalistëve evropian. Ky opinion është i padrejtë; këtë e dokumentojmë me sa vijon:

1. Islami zhvillimor nuk bazohet në ixhmaë. Ixhmai nuk mund t'i modifikojë, e as t'i ndryshojë bazat, parimet dhe ligjet bazë të Islamit. Roli i tij është përforsimi i ligjeve dhe paraqitjen e ligjeve që të depërtojnë në mendje, atëherë kur çështjet janë të pasqaruara dhe kur argumentet kanë një dozë dyshimi, ose janë të paqarta, ose janë në formë globale. Muxhtehidët nuk kanë të drejtë të vendosin ligje, bile as vet i Dërguari i Allahut s.a.v.s. nuk ka të drejtë të japë ndonjë mendim, ose të vendosë ndonjë ligj pa zbritur shpallja, e të mos flasim për umetin. Ixhmai bazohet në Kur'an dhe sunet.

2. Ixhmaë nuk është ixhmai i njerëzve të rëndomtë, siç mendojnë orientalistët, por është dakordim i muxhtehidëve të specializuar për lëminë paraprake.

3. Ixhmai nuk është opozitë e Kur'anit dhe sunetit, siç e kanë kuptuar ata, dhe nuk është organ i ligjësimi të ligjeve të reja, siç deklarojnë ata, por ixhmai bazohet në argumentet e Kur'anit dhe sunetit, pra mbështetet në tekstet e tyre.

4. Nuk kanë të drejtë muslimanët që bidatin ta bëjnë sunet, si f.v. ndërmjetësimi në peygamberë. Për këtë çështje muslimanët nuk janë dakorduar asnjëherë

5. Pagabueshmëria e peygamberit nuk është deklaruar vetëm prej ixhmait, por është vendosur prej tekstit të kristalizuar të Kur'anit:

وَمَا يَنْطِقُ عَنِ الْهَوَىٰ ﴿٣﴾ إِنْ هُوَ إِلَّا وَحْيٌ يُوحَىٰ ﴿٤﴾

“Dhe nuk flet nga mendja e vet, por është shpallje, e cila i shpallet.”
(en-Nexhm : 3,4)

6. Ixhmai nuk përmban çështjet e Akides dhe ligjet shkencore, pavarësisht se me këto çështje merren Shiitët Imamij.¹⁸⁸

Të vepruarit me minimumin

Sa i përket parimit, i cili është i përhapur nga Imam Shafiiju “Të vepruarit me minimumin” në dispozitimin e ligjit, pasi që minimumi është pjesë e maksimumit, dhe ekziston argument tjetër, kjo nuk është ixhmaë, siç mendon Ibn Haxhibi. Por, ixhmaë është ixhmai i çështjes në tërësi, fillim e mbarim. Shembull:

“DIJA” e pasuesit të librit. Dijetarët në lidhje me këtë kanë dhënë tre mendime:

- Disa mendojnë se është sa një e treta e “DIJES” së muslimanit.
- Malikijtë mendojnë se është një e dyta.
- Hanefijtë mendojnë se është “DIJE” e plotë sa “DIJA” e muslimanit.
- Shafiijtë e preferojnë mendimin e parë, pra që “DIJA” të jetë sa një e treta, nga shkak se në një të tretën bëjnë pjesë edhe dy mendimet tjera.

Përderisa pas dakordimit dhe ixhmait, secili ka dhënë mendimin ndryshe nga të tjerët. Paralel me të shumtën bëhet obligative edhe e pakta. Përderisa në parim, pas ixhmait nuk është obligative të shtohet diçka, sepse baza fillestare tregon se nuk është obligative; mirëpo të mosvepruarit me një të tretën është mosveprim me ixhmain, pra nuk mbetet asgjë tjetër përpos të veprohet me bazën dhe nuk është obligative, por mustehab është të vepruarit me bazën (me minimumin).¹⁸⁹

Tema e shtatë: Shembuj nga Ixhmai

Përkundër asaj që kam përmendur prej mendimeve të dijetarëve të mëhershëm dhe të sotmit për realitetin e ixhmait, unë vazhdimisht deklaroj se ixhmai faktikisht në shumë raste është realitet në vepra. Nuk ka argument më të fuqishëm se gjendja faktike, të cilën Ibn Hazmi në librin e tij **“Kategoritë e Ixhmait”** ka përmendur se ixhmai është aprovuar në 58 temadhe atë prej fikhut të posaçëm, të përgjithshëm dhe në besim. Në hyrje të librit të tij ai thotë: “Ixhmai është parim prej parimeve të fesë së pastër dhe bazë në të cilën duhet mbështetur; konsiderohet pabesimtar ai, i cili e refuzon, pasi që të paraqitet argumenti, se ai vendim është vendim ixhmai”. Dobia e të gjitha këtyre çështjeve është shumë e rëndësishme. Pastaj, ai vazhdon duke thënë: Këto forma të ixhmait, që përpos këtyre formave nuk ka të tjera dhe kurrë nuk mund të ketë argument të ixhmait përpos në këto forma. Njerëzit kanë thënë se është ixhmaë edhe për rastet kur nuk ka pasur ixhmaë.

- Disa e konsiderojnë mendimin e shumicës ixhmaë.
- Disa e konsiderojnë ixhmaë edhe çështjen për të cilën nuk dihet se ndokush ka kundërshtuar, edhe pse nuk ka thënë prerazi se nuk ka pasur kundërshtime.
- Disa e konsiderojnë ixhmaë mendimin e ndonjë sehabiu se ndonjëri prej sehaveve ka kundërshtuar, edhe pse atë mendim e ka kundërshtuar ndonjë tabiin, ose ndonjë prej tyre.
- Disa e konsiderojnë ixhmaë mendimin e ndonjë sehabiu, e që nuk dihet a e ka kundërshtuar ndonjë sehabë tjetër, dhe që ai mendim nuk është titulluar dhe nuk është përhapur si mendim unanim i ixhmait.
- Disa, mendimin e banorëve të Medinës, e konsiderojnë ixhmaë.
- Disa, mendimin e banorëve të Kufës, e konsiderojnë ixhmaë.
- Disa e konsiderojnë dakordimin e një apo dy apo shumë mendimeve të gjeneratës së dytë, sepse kjo gjeneratë ka qenë gjeneratë e ixhmait.

Të gjitha këto mendime janë të papranuara, por ne do të diskutojmë ndonjëherë tjetër. Tani për tani mjafton t'i konsiderojmë të papranueshme, nga shkakut se shohim se ato vet nuk i kanë pranuar shumë çështje, të cilat i kanë quajtur se janë ixhmaë.

- Disa thonë se ixhmaë është dakordimi i sehaveve, Zoti i pastë mëshiruar.

- Disa thonë, ixhmai i çdo gjenerate është ixhmaë i drejtë, nëse asaj çështje nuk i ka paraprirë kundërshtimi. Ky mendim është i drejtë, pasi që ixhmai në këtë formë e ka sqaruar dhe e ka nënkuptuar, për këtë janë argumentuar dhe çdo gjë tjetër, që ia kanë bashkangjitur, nuk e kanë pranuar.

Duke sqaruar cilësinë e ixhmait në vazhdim Ibn Hazmi thotë:¹⁹⁰ Cilësi e ixhmait është ajo që pasi të sigurohet se në mes të dijetarëve nuk ka pasur kurrfarë mospajtimi. Këtë e kuptojmë nëpërmjet të lajmeve të konfirmuara dhe të sigurta, në të cilat nuk ka fije dyshimi. Shembull: Muslimanët kanë kaluar në Hixhaz dhe në Jemen dhe e kanë çliruar Irakun, Horasanin, Egjiptin dhe Sirinë. Dinastia umevite ka sunduar një periudhë të gjatë, pastaj ka ardhur dinastia Abasite. Në histori ka ndodhur beteja e Hurres dhe Sefinit e shumë lajme tjera që dihen se janë të sigurta, dhe domosdo të pranueshme.

Me fjalën “dijetar” nënkuptojmë ai i cili është njohës i fetvave të sehaveve, tabiinëve, etbei tabiinëve dhe dijetarët e rajoneve e të specializuarit e hadithit dhe çdokush që i pason, Zoti i pastë mëshiruar të gjithë.

Në këtë libër bën pjesë institucioni i ixhmait të plotë për të cilin nuk ka pasur anjëherë mospajtim. Në librin “Kritika e kategorive të ixhmait të Ibni Hazmit”, Ibn Tejmiye e ka kritikuar këtë pjesë të fundit duke thënë: Ka kushtëzuar (Ibn Hazmi) atë që e kanë kushtëzuar shumica e dijetarëve të Tevhidit dhe të fikhut, siç kemi cekur më parë: që të ketë njohuri për të cilën nuk ka mospajtime; që njohuria për ixhmain të jetë e garantuar dhe e siguruar”. Njohurinë e ixhmait ai e llogarit prej njohurive të domosdoshme (njohuri që më pastaj nuk ka nevojë për diskutime dhe hulumtime), siç është rasti edhe hadithet mutevatir, të shumica e dijetarëve. Është e njohur se shumica e institucioneve të ixhmait, të cilat i ka përmendur, nuk janë të kësaj cilësie, duke pasur parasysh se ai i ka regjistruar ashtu si është çështja

me institucionet e ixhmait, për të cilat veç dihet se ka pasur mospajtime, dhe institucione të ixhmait që edhe vet i ka kundërshtuar, ai e zgjedh të kundërshtuarën, pa e ditur se është kundërshtuar ai institucion i ixhmait.¹⁹¹

Unë kam zgjedhur disa institucione të ixhmait nga shumica e temave, të cilat i ka përmendur Ibn Hazmi, që të ngulitet në mendjet e njerëzve se ixhmai veç ka ndodhur dhe është realitet, duke pasur parasysh se Ibn Hazmi nuk pranon ixhmaë, përpos nëse ai ixhmaë ka bazë në tekst, në Kur'an apo në sunet. Në librin **“Feraid”** ai ka përmendur 110 raste të ixhmait.

1. Libri për pastërtinë

Dijetarët janë dakorduar se: uji i qetë (i palëvizshëm), nëse është në sasi të madhe dhe poqëse me lëvizjen e mesit të tij nuk lëviz skaji i tij dhe nuk ka kurrfarë indikacioni në mes tyre, nuk mund ta njollosë (ta bëjë të papastër) asgjë përpos nëse është diçka që ia ndryshon ngjyrën, shijen ose erën.¹⁹²

2. Libri i namazit

Dijetarët janë dakorduar se pesë kohët e namazit janë farz. Po ashtu, janë dakorduar se nuk ka lirim prej namazit dhe nuk lejohet që me qëllim dhe pa arsye të bëhet vonimi nga orari i tij për të mbërriturin dhe të mençurin dhe se namazi falet varësisht prej mundësisë: ulur, shtrirë me shenja dhe në çfarëdo forme që të jetë e mundur.¹⁹³

3. Libri për të vdekurin

Dijetarët janë dakorduar se është detyrë e domosdoshme (farz) që të bëhet varrimi i trupit të muslimanit të vdekur.¹⁹⁴

4. Libri i zekatit.

Dijetarët janë dakorduar se: Kush e jep zekatin për veten e tij, me urdhrin e Imamit (udhëheqësit), dhe e jep me qëllim se është zekat, dhe e jep në kategoritë e caktuara, i pranohet.¹⁹⁵

5. Libri i agjërimit

Dijetarët janë dakorduar se ngrënia, e cila është ushqim i trupit, dhe ushqimi dhe pija depërtojnë në fyt, po ashtu edhe kontaktimi seksual janë të ndaluara që nga lindja e diellit deri në perëndim të tij.¹⁹⁶

6. Libri i iëtikafit

Dijetarët janë dakorduar se kush del nga xhamia duke qenë i vetizoluar (iëtikaf) pa kurrfarë nevojë, arsye apo domosdoshmërie, iëtikafi është i pavlefshëm.¹⁹⁷

7. Libri i haxhit

Dijetarët janë dakorduar se haxhiu është i detyruar të largohet nga kapela, këpucët, palltoja, këmisha dhe pantallonat e qepura, të cilat quhen rroba, por duhet të ketë vetëm mbështjellës.¹⁹⁸

8. Libri i gjykimeve

Dijetarët janë dakorduar se çdo gjykatës, i cili gjykon për të tjerët, por jo për prindërit e tij, e as për robin e tij, dhe për çdokë prej të cilit pranohet dënimi për të, pra, prej fëmijëve të tij apo nipave e mbesave, apo vëllezërve e motrave, apo kujdestarëve të tij, apo prej dashamirëve të tij, por edhe prej armiqve të tij, nëse ka gjykuar drejt, gjykimi i tij është i vlefshëm dhe pranohet.¹⁹⁹

9. Libri i aktakuzave dhe i dëshmimeve.

Dijetarët janë pajtuar se mëkatet e mëdha dhe mëkatet e vogla, të cilat bëhen haptazi dhe me krenari, dhe vazhdimësia në mëkate të mëdha, janë shkak të mospranimit të dëshmisë.²⁰⁰

10. Libri i bankrotimit.

Dijetarët janë dakorduar se çdokush, i cili i ka borxh pasuri apo diçka tjetër dikujt, nëse ekziston mundësia, e ka për obligim t'ia kthejë borxhin e çka t'i mbetet për jetesë, për vete dhe për familje, le t'i mbetet.²⁰¹

11. Libri i imunitetit.

Dijetarët janë dakorduar se çdokush, i cili është i moshërritur, i lirë, i mençur, i drejtë në fenë e tij, i drejtë në veprimtari ka imunitet, dhe çdo kontratë që e lidh, është e vlefshme dhe e plotfuqishme.²⁰²

12. Libri i uzurpimeve.

Dijetarët janë pajtuar se ai, i cili uzurpon çfarëdo qoftë, e që nuk është e fëmijëve të tij, dhe gjendet ashtu siç ka qenë, pa iu ndryshuar cilësia, as vlera, dhe që gjendet në dorën e uzurpatorit, e jo nga dikush tjetër, kthehet ashtu siç ka qenë te pronari i tij.²⁰³

13. Libri i bujqësisë

Dijetarët janë pajtuar se për ujitjen e tokës, për punimin e tokës, kur të përmendet 50%, 33 %, ose 20 % ose çfarëdo përqindje tjetër, ashtu llogaritet prej të gjithëve deri në afatin e caktuar në mënyrë të barabartë, pa kurrfarë dallimi.²⁰⁴

14. Libri i hipotekës

Dijetarët janë pajtuar se nëse hipotekuesi dëshiron ta marrë sendin e hipotekuar pa kurrfarë kompensimi, përpos nëse është fjala për lirimin e robit, atij nuk i lejohej.²⁰⁵

15. Imponimi.

Dijetarët janë pajtuar se i detyruari me dhunë që të thotë fjalën e pabesimit, përderisa ai zemrën e ka të mbushur plot iman, Zoti nuk e merr në përgjigje fare. Kjo, nëse e frikësojnë me vrasje. Ndërsa nuk janë dakorduar në atë se e merr dispozitimin si pabesimtar.²⁰⁶

16. Deponimi

Dijetarët janë pajtuar se kush tregton me sendin e deponuar, e shpenzon ose e keqpërdor, duke e huazuar apo edhe në formë tjetër, ai dënohet deri sa ta kthejë sendin e deponuar.²⁰⁷

17. Autorizimi

Dijetarët janë dakorduar se nëse i autorizuari vepron në bazë të autorizimit prej moshërritjes deri sa të lajmërohet dhe ai është i aftë kur zhvleftësohet nga autorizimi, ose pasi që të vdesë autorizuesi, dhe ai nuk i tejkalon kufijtë e autorizimit, është i plotfuqishëm për autorizuesin dhe për trashëgimtarët e autorizuesit.²⁰⁸

18. Zëvendësimi

Dijetarët janë dakorduar se kush e zëvendëson dikë për një të drejtë, ai ka obligim për atë send dhe i lejohej atij ta shesë atë send, para se ta

pronësojë ai njeri që është prezent, dhe pajtohet për atë zëvendësim, por edhe i zëvendësuar pajtohet dhe secili prej tyre e di vlerën e atij sendi sa i takon, lejohet që zëvendësemëruesi të kërkojë nga zëvendësuesi t'ia kërkojë atë të drejtë, dhe ai zëvendësim është zëvendësim i drejtë.²⁰⁹

19. Garantuesi

Dijetarët janë dakorduar se dënimi i cili nuk lejohet asnjëherë dhe që nuk lejohet për asnjë njeri, nuk lejohet.²¹⁰

20. Libri i kurorëzimeve

Dijetarët janë dakorduar se: gjatë kohës së idetit, paraqitja e fejesës haptazi është e ndaluar. Po ashtu është i ndaluar kontaktimi me gruan në anus dhe në kohën e menstruacionit. Kushtëzimi i burrit që mos ta dëmtojë gruan fizikisht dhe materialisht është kusht i drejtë dhe kurorëzimi i tillë është i pranuar dhe nuk e dëmton.²¹¹

21. “Iljai”

Dijetarët janë dakorduar se kontaktimi martesor në organin femëror, para se të kalojnë katër muaj, është valid dhe me të hidhet poshtë “Iljai”.²¹²

22. Shkurorëzimi dhe prishja e kurorëzimit (hul'i)

Dijetarët janë dakorduar se atëherë kur muslimani i moshërritur, i mençur, i cili nuk është as i dehur, as i imponuar, as i hidhëruar, as “mahxhurë” e as i sëmurë, e shkurorëzon gruan me të cilën është kurorëzuar me kurorëzim të drejtë atëherë kur e shpreh shkurorëzimin me vullnet të lirë.²¹³

23. Shkurorëzimi me të drejtë kthimi

Dijetarët janë dakorduar në atë se: nëse burri e shkurorëzon gruan me të cilën është kurorëzuar me kurorë valide, është shkurorëzim sunet dhe gruaja patjetër duhet të kalojë idetin nga ai shkurorëzim; dhe e shkurorëzon njëherë, pastaj edhe njëherë, e ai e kthen atë, dëshiroi ajo apo refuzoi, pa kujdestar dhe pa dhuratë kurore përderisa ajo të jetë në idet (afat të pritjes) dhe ata dy e trashëgojnë njëri-tjetrin deri sa të kalojë afati i pritjes (ideti).²¹⁴

24. Libri i shtiblerjeve

Dijetarët janë dakorduar se: nëse njeriu shet sendin e pronësuar, e që nuk ka të drejtë ta pronësojë, dhe shitësi nuk është gjykatës, as i drejtë, për veten e tij, ose për tjetrin, ose është i interesuar që ta pronësojë atë send nga pronari i cili veç s'ka hequr dorë pronari nga ai send nga pronari, ajo shitblerje është jolegale.²¹⁵

25. Ortakëria

Dijetarët janë dakorduar se: nëse njëri ortak shet sendin me çmim të tregut ose blen një send, që nuk ka të meta, me palën e cila pajtohet me atë tregti, ajo tregti është legale, valide dhe e lejuar për të gjithë (edhe për ortakëri).²¹⁶

26. Pllenimi i tokës.

Dijetarët janë dakorduar me atë se kush e pronëson një pjesë të tokës së pashfrytëzuar dhe e bën të plleshme dhe se ajo tokë nuk është minierë, Imami nuk ka të drejtë ta largojë nga ajo pjesë toke dhe as t'ia japë dikujt tjetër.²¹⁷

27. Dhuratat

Dijetarët janë dakorduar në atë se: kush ka vetëm djem e jo vajza, ose vetëm vajza e jo djem, dhe u jep që të gjithë djemve, eventualisht vajzave, dhe nuk ka bërë dallim në mes tyre, ai veprim është valid.²¹⁸

28. Libri i trashëgimisë

Dijetarët janë dakorduar se babai trashëgon, po ashtu edhe gjyshi trashëgon, nëse është nga ana e babait dhe e baballarëve, dhe i vdekuri nuk lë pas vetes nënë, edhe nëse është e lozës së epërme. Kjo, nëse babai nuk është gjallë.²¹⁹

29. Libri i testamentit dhe i testamentlënësve

Dijetarët janë dakorduar se Testamenti lejohet vetëm atëherë kur të kryhen borxhet. E, nëse pas borxheve tepron diçka, testamenti lejohet, e nëse nuk tepron, nuk lejohet. Po ashtu, janë dakorduar se babai i mençur dhe

i cili nuk është mahxhurë(i bankrotuar), ka të drejtë të lërë testament për fëmijën dhe bijtë e tij të vegjël, të cilët nuk e kanë arritur moshën e pjekurisë, po ashtu edhe për ata me aftësi të kufizuara dhe të paafte, siç janë çmenduria, shizofrenia, pra për muslimanët e lirë të drejtë, që në disa aspekte kanë aftësi, e në disa jo.²²⁰

30. Pasuria e luftës, lufta në rrugën e Allahut dhe udhëtimi

Dijetarët janë dakorduar se është farz për të lirët, moshërriturit, që t'i dëbojnë pabesimtarët nga vendet Islame, nga fshatrat Islame, nga kështjellat Islame dhe nga shtëpitë Islame, nëse i kanë okupuar ato vende islame.²²¹

31. Udhëheqësia, lufta kundër renegatëve, mbrojtja e vetvetes dhe kriminaliteti

Dijetarët janë dakorduar se hajni kriminel, i cili ka për qëllim vrasje, vjedhje dhe çnjerëzim, vrasja e tij është obligative. Janë dakorduar se Hilafeti është farz dhe patjetër duhet të funksionojë hilafeti. Këtë mendim e kanë kundërshtuar vetëm havarixhët, të cilët kemi treguar se kush e kundërshton ixhmain pas bindjes se është ixhmaë dhe pas njohurive se është bërë ixhmaë, konsiderohet pabesimtar.²²²

32. Libri i dënimeve.

Dijetarët janë dakorduar se ai i cili bën prostitucion, pi alkool, shpif dhe vret, ekzekutimi i tij është obligativ.²²³

33. Pijet.

Dijetarët janë dakorduar se lëngu i rrushit, i cili nuk është zier, nëse vlon dhe hidhet në vaj, e shndërrohet në pije dehëse(deh), atëherë edhe e shumta, edhe e pakta, qoftë edhe një pikë, është e ndaluar. Për raste të domosdoshme për shërim dhe nëse është i detyruar, lejohet ta përdorë. Ai i cili pi duke ditur se është haram ai është mëkatar, e ai i cili thotë se nuk është e ndaluar, ai është pabesimtar.²²⁴

34. Dënimet e gjaqeve.

Dijetarët janë dakorduar se vrasja e minoritetit jomysliman në vendin Islam është e ndaluar. Po ashtu, janë dakorduar se syri i njeriut të moshërritur, të mençur, është i shëndoshë dhe nuk ka sy më të mirë se tjetri, i hiqet syri i shëndoshë i muslimanit të moshërritur të mençur, syri i majtë për të majtin, syri i djathtë për të djathtin.²²⁵

35. Dijet (shpagimet)

Dijetarët janë dakorduar se shpagim për të vrarin gabim, për muslimanin e lirë është njëqind deve, as më shumë, as më pak, ndërsa për muslimanen e lirë pesëdhjetë deve. Kjo është nëse i vrari, ose e vrara, janë prej të njëjtës farefisni, ose vrasja nuk është në Qabe dhe as në muajt e shenjtë.²²⁶

36. Gjuetia, Kurbanat dhe akiki

Dijetarët janë dakorduar se: kush dërgon qenin e dresuar kundruall gjahut dhe gjahun e gjen të gjallë, ai e pren dhe e përmend emrin e Allahut, e atëherë i lejohet ngrënia e atij mishi. Po ashtu, dijetarët janë dakorduar se derri mashkull apo femër, i vogël apo i madh, është i ndaluar, si mishi, si yndyra e tij, si koka e tij, si truri i tij, si pjesët e tij, si lëkura e tij: që të gjitha janë të ndaluara.²²⁷

37. Vrapimi dhe shenjtimi

Dijetarët janë dakorduar se lejohet garimi me kuaj, deve dhe garim vrapimi.²²⁸

38. Përbetimet dhe betimet

Dijetarët janë dakorduar se ai i cili përbetohet me një emër prej emrave të bukur të Allahut të Lartmadhëruar, e pastaj thotë: nëse do Allahu, ose vetëm nëse do Allahu e të ngjashme dhe këtë e bënë menjëherë pas përbetimit dhe ka pasur për qëllim që pas përbetimit të thotë nëse do Allahu, i tilli nuk kompenson asgjë për thyerje të atij përbetimi. Po ashtu, nuk kompenson asgjë, nëse i përbetohen atij qoftë me qëllim apo pa qëllim.²²⁹

39. Tema e Ixhmait dhe besimit.

Kush kundërshton ixhmain, konsiderohet pabesimtar. Dijetarët janë dakorduar se Allahu i Lartmadhëruar është Një, pa ortak, Krijues i çdo

çështjeje dhe gjithçkaje dhe se Allahu i Lartmadhëruar është Një, nuk ka tjetër pos Tij. Pastaj Allahu ka krijuar gjithçka siç ka dëshiruar dhe se njeriu (shpirti i njeriut) është i krijuar, fronti është i krijuar, bota është e krijuar, peygamberët janë realitet dhe se kanë qenë shumë peygamberë, disa janë përmendur në Kur'an, e disa nuk janë të përmendur, dhe se Muhamedi, i biri i Allahut i fisit Kurejshij, hashimij, është i dërguar i Allahut s.a.v.s. për të gjithë xhinët dhe njerëzit deri në ditën e gjykimit.

Dhe, feja Islame është fe e vetme e Allahut në fytyrën e tokës, është shfuqizues i të gjitha feve të mëparme dhe asnjë fe tjetër nuk mund ta shfuqizojë; kush e refuzon dhe e kundërshton, pasi që të njoftohet për të, ai është pabesimtar dhe digjet përgjithmonë në xhehenem.

Dijetarët janë dakorduar se askush nuk mund të lejojë një të lejuar, e as të ndalojë një të ndaluar, e as të obligojë diçka, pos me argument nga Kur'ani ose nga suneti, ose nga ixhmai, ose Kijasi, duke krahasuar (analizuar).²³⁰

Fusnota:

1. “El Mustesfa lil Gazalij” vëll. i I fq. 112-114.
2. Këto transmetime do t’i sqarojmë më vonë.
3. “Fevatihu Rahmut Sherh”, “Muslimu Thubut” vëll. i II fq. 212.
4. Hadith Hasen, e transmeton Ahmedi në Musnedin e tij, nga Hafsa r.a. Po ashtu e transmeton Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Nesaiju (“Xhamiul Usul” vëll. i VII fq. 186).
5. “El Ihkam lil Amidi” vëll. i I fq. 101.
 “Et-Telviyh alet-Tevdijh” vëll. i II fq. 41.
 “Keshful Esrarë” vëll. i I fq. 946.
 “Muslimu Thubut” vëll. i II fq. 166.
 “Irshadul Fuhul” fq. 63.
6. “El Mustesfa” vëll. i I fq. 110.
 “Et-Tekrirë vet-Tehbirë” vëll. i II fq. 80.
 “Fevatihu Rahmutë” vëll. i II fq. 211.
 “Sherhul Udad” vëll. i II fq. 29.
 “Sherhul mehalij ala xhem’i xhevamiu” vëll. i II fq. 152.
 “El-Ihkam lil Amidi” vëll. i I fq. 101.
 “Mer’etil Usul” vëll. i II fq. 252.
 “El minhaxh meal Esnevi” vëll. i II fq. 222.
 “Irshadul Fuhul” fq. 63.
 “El Med’hal ila medhheb Ahmed” fq. 128.
 “Gajetul vusul” fq. 107.
7. Transmetuesin do ta tregojmë më vonë.
8. “Muhaderatë fi Usuli Fikh” fq. 4.
9. “Keshful Esrarë” vëll. i II fq. 947.
 “Mer’etil Usulë” vëll. i II fq. 257.
10. “Mer’etil Usul” fq. 261.
